

# KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit,

## VENDOSIM KËTË KUSHTETUTË:

### PJESA E PARË

#### PARIME THEMELORE

##### Neni 1

1. Shqipëria është Republikë parlamentare.
2. Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm.
3. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.

##### Neni 2

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.
2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.
3. Për ruajtjen e paqes dhe të interesave kombëtarë, Republika e Shqipërisë mund të marrë pjesë në një sistem sigurimi kolektiv, në bazë të një ligji të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

##### Neni 3

Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë.

## Neni 4

1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.
2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.
3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

**VGJK 36/2007:** Përsa pretendohet nga kërkuesi për cenim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata Kushtetuese e gjen me vend t'i referohet jurisprudencës së vet, në të cilën ajo ka argumentuar se deri në çfarë mase siguria juridike, të drejtat e fituara, pritshmëria legjitime dhe besimi i qytetarëve tek shteti, që bazohen tek parimi i shtetit të së drejtës, do të përbëjnë mbështetje të fuqishme në funksion të ngritjes dhe të argumentimit të kërkesës për antikushtetutshmërinë e një norme ligjore.<sup>14</sup> Siguria juridike parakupton, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar, nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme. Ligjvënisi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi.

**VGJK 3/2006:** Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e kërkesës e çmon të nevojshme të rikonfirmojë qëndrimin e saj, lidhur me raportin midis normës kushtetuese dhe normës ligjore dhe zbatimin drejtpërsëdrejti të dispozitave të Kushtetutës, sikundër përcaktohet në nenin 4 të saj. Teoria normativiste e së drejtës ka në thelb të saj idenë se marrëdhëniet midis normave juridike bazohen mbi raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barazvlefshme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie, dhe në secilin prej këtyre niveleve, qëndron një normë ose grup normash duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike. Kushtetuta, si akt themelor i një shteti, parashikon organet dhe kushtet në të cilat duhet të nxirren aktet normative duke synuar qëndrueshmërinë e tyre. Kushtetuta, mbi bazën e të cilës miratohen të gjitha aktet e tjera normative, mund të ndërmarrë si mision të saj edhe përcaktimin e përmbajtjes së ligjeve që duhet të miratohen në të ardhmen nga ligjvënisi. Kështu, konsiderohet si karakteristikë e kushtetutave të shkruara, përcaktimi konkret i disa parimeve kryesore ose përjashtimi absolut i disa rrethanave që konsiderohen si të papranueshme për të. Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shterruese. Megjithëse disa çështje lidhur me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithësesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit. Pra, Kushtetuta, nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës shoqërore politike të një vendi, por vetëm të parimeve dhe kritereve bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Shpesh, Kushtetuta qëllimisht le hapësira rregullimi nga ligjvënisi i zakonshëm, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e kulturore nga partitë politike ose qeveria. Por, Kushtetuta, përveç kësaj mund të parashikojë hollësisht dhe shprehimisht rastet, për të cilat nuk mund t'i lerë hapësira rregullimi ligjvënisit të zakonshëm. Nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese rithekson se për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke i dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur kushtetuta le hapësira me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënisit të zakonshëm, atëherë, nuk është e nevojshme referimi tek kjo dispozitë, pra e zbatimit të drejtpërdrejt të saj. Nëse ndodhemi para kësaj situatë, është e pritshme që aktet normative që do të dalin për këtë qëllim të respektojnë hierarkinë e akteve normative.

**VGJK 29/2005:** Gjykata Kushtetuese çmon se merr rëndësi të veçantë analiza që i duhet bërë hierarkisë së normave juridike. Kuptimi normativist bazohet në hierarkinë juridike dhe në supremacinë e normës kushtetuese ndaj akteve më të ulta, që në doktrinën kushtetuese njihet si parimi i epërsisë (*supremacisë*) të Kushtetutës. Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, që përbën një parim tjetër të rëndësishëm, atë të kushtetutshmërisë funksionale. Mbështetur në këto parime, veprimtaria dhe funksionet e të gjitha organeve shtetërore bazohen në Kushtetutë. Janë veprimtaria normëvënëse e organeve të autorizuara nga Kushtetuta si edhe natyra e përmbajtja e ligjeve dhe akteve nënligjore që ato nxjerrin, të cilat përcaktojnë edhe pozitën e këtyre akteve në hierarkinë e normave juridike. Nga kjo, buron kërkesa dhe parimi, sipas të cilit, aktet juridike më të ulta duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. ...Pra, Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke i krijuar hapësirë ligjvënisit për të vepruar më shumë ose më pak, me përjashtim të rasteve kur vetë Kushtetuta parashikon ndryshe. Parë nga ky këndvështrim, është Kushtetuta që autorizon ligjvënësin, që duke respektuar konceptet dhe parimet kushtetuese, të caktojë kufijtë e hapësirës rregulluese nëpërmjet nxjerrjes së normave juridike.

## Neni 5

Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

## Neni 6

Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.

## Neni 7

Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

---

**VGJK 24/2006:** Rëndësi të drejtpërdrejtë në gjykimin e çështjes ka dhe parimi kushtetues i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës. Ky parim ndihmon që pushteti të shpërndahet në disa mbajtës, me funksione e detyra të ndryshme, të mirëpërcaktuara nga Kushtetuta, si dhe mundëson bashkëveprimin midis tyre, me qëllim unitetin në veprimin shtetëror. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke e njohur dhe sanksionuar përqëndrimin e pushtetit ligjvënës në duart e Kuvendit të Shqipërisë ka lejuar, si raste përjashtimore, nxjerrjen e akteve me fuqinë e ligjit edhe nga organe të tjera kushtetuese. Një nga përjashtimet është ai i parashikuar nga neni 101 i Kushtetutës, që i njehtë drejtën Këshillit të Ministrave të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit. Përdorimi i këtij instrumenti ligjvënës mbetet në vlerësimin e Këshillit të Ministrave, por çmohet se përdorimi i tij gjërësisht dhe jo në kushtet e parashikuara nga Kushtetuta, do të cenonte pavarësinë e pushtetit legjislativ dhe karakterin demokratik të shtetit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra. Përjashtime të tilla janë të njohura edhe nga kushtetutat e shteteve të tjera demokratike ku konstatohet se është lejuar transferimi i ndonjë kompetence që i përket pushtetit legjislativ, drejt ekzekutivit.

**VGJK 11/2004:** Gjykata Kushtetuese vlerëson se çështja në shqyrtim kërkon një interpretim më të zgjeruar në aspektin e kuptimit që i jepet termit “torturë” sipas akteve ndërkombëtare dhe në veçanti jurisprudencës së pasur që vihet re në këtë drejtim. Neni 1 i Konventës kundër torturës dhe dënimeve e trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, i ka dhënë një kuptim sqarues dhe orientues këtij termi. Kjo dispozitë përfshin disa elementë të rëndësishëm që duhen vlerësuar në rastet kur ndodhemi përpara konsumimit të kësaj vepre penale. Meqenëse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë orientohet pikërisht nga kjo dispozitë e Konventës, çështja objekt shqyrtimi mbetet për t’u analizuar nga Gjykata Kushtetuese si në drejtim të personave që nuk duhet t’i nënshtrohen torturës, ashtu edhe të subjekteve që janë përgjegjës për kryerjen e kësaj vepre penale. Paragrafi i parë i nenit 1 të Konventës së sipërcituar nënkupton se vepra penale e torturës drejtohet kryesisht ndaj personave të privuar nga liria, ose ndaj personave që përballen me organet shtetërore. Subjektet që kryejnë këtë veprë penale ajo i fokuson kryesisht në personat zyrtarë ose në personat që nxiten prej tyre. Nga mënyra e formulimit të veprës penale të torturës në dispozitat e Kodit Penal, rrethi i subjekteve që mund të përgjigjen penalisht për këtë veprë merr një kuptim më të gjerë. Madje, në literaturën juridike, është pranuar se subjekti i kësaj vepre penale është subjekt i përgjithshëm ose i posaçëm, civil a ushtarak. Pikërisht, një trajtim i tillë i çështjes sipas kërkesit, prek konceptin që i japin veprës penale të torturës aktet ndërkombëtare. Duke e analizuar çështjen në shqyrtim nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se për të konkluduar mbi pajtueshmërinë ose jo të dispozitave të Kodit Penal me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara duhet të interpretohet neni 1 i Konventës kundër torturës në kuptimin e tij të gjerë në harmoni edhe me paragrafin e dytë të tij. Sipas këtij paragrafi, kuptimi i dhënë në paragrafin e parë të nenit 1 të Konventës nuk mund të çenojë asnjë instrument ndërkombëtar ose asnjë ligj kombëtar që të përmbajë dispozita të një karakteri më të gjerë. E drejta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut sanksionon si rregull vetëm një minimum bazë të lirive dhe të drejtave, ndërkohë që shtetet palë në konventat ndërkombëtare mund të ngrihen mbi këto minimume dhe të implementojnë ligje kombëtare që përmbajnë ose mund të përmbajnë dispozita të një karakteri më të gjerë. Pra, kjo dispozitë e Konventës nuk vendos kufizime për shtetet palë, përkundrazi, e lë në diskrecionin e tyre që të vendosin në legjislationin e brendshëm rregulla të një spektri më të gjerë. Tortura dhe çdo trajtim çnjerëzor e degradues janë të ndaluara sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare penale. Ndalimi i torturës dhe trajtimeve poshtëruese e degraduese gjen pasqyrim të plotë në shumicën e traktateve ndërkombëtare. Detyrimi për të mos iu nënshtuar torturës apo keqtrajtimit është një rregull i së drejtës ndërkombëtare zakonore dhe se ndalimi i torturës përbën një normë të pakundërshtueshme. Ndalimi i torturës në kuadrin e sanksionimit të të drejtave të tjera të njeriut në aktet ndërkombëtare përbëjnë një garanci për qytetarët jo vetëm ndaj abuzimeve shtetërore, por edhe ndaj abuzimeve të individëve. Aktet ndërkombëtare dhe jurisprudenca e zhvilluar në këtë drejtim e kanë lidhur të drejtën për të mos ju nënshtuar torturës dhe keqtrajtimit, me detyrimin e shtetit për të siguruar mbrojtje nëpërmjet masave legjislative, ose masave të tjera kundër torturës apo keqtrajtimit nga individët. Qëllimi i dispozitave që ndalojnë përdorimin e torturës është mbrojtja e dinjitetit dhe integritetit fizik e mendor të individit. Ndaj është detyrë e çdo shteti palë në këto marrëveshje ndërkombëtare të ofrojë për këdo mbrojtje nëpërmjet legjislationit dhe masave të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme kundër veprimeve të ndaluara nga aktet ndërkombëtare, “...pavarësisht nëse shkaktohen nga njerëz që veprojnë në kapacitet zyrtar, jashtë kapacitetit të tillë zyrtar ose në kapacitet privat”. Krahas këtij trajtimi doktrinar dhe evolutiv që vihet re në jurisprudencën ndërkombëtare argumenta tepër të rëndësishme për të konkluduar për zgjidhjen e çështjes konkrete gjenden edhe në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në çështjen *A kundër Mbretërisë së*

*Bashkuar, ajo konkludon se “detyrimi i shteteve anëtare nga neni 1 i Konventës për t’i siguruar kujt do që është nën juridiksionin e tij të drejtat dhe liritë e shprehura në Konventë e kombinuar së bashku me nenin 3 të saj, i kërkon shteteve anëtare të marrin masa të përcaktuara për të siguruar se individët nën juridiksionin e tyre nuk janë subjekt i torturës apo keqtrajtimit çnjerëzor degradues duke përfshirë edhe keqtrajtimet e kryera nga individët privatë”.* Pikërisht bazuar mbi një konkluzion të tillë, dështimi që mund të vihet re në ligjet e brendshme të shteteve të ndryshme për të siguruar një mbrojtje adekuate përbën shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nisur nga kjo analizë me karakter interpretues, bazuar edhe në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese konkludon se për sa kohë që ndalimi i torturës dhe keqtrajtimi është përcaktuar si një e drejtë njerëzore dhe përderisa të drejtat e njeriut janë konsideruar si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, çdo njeri ka të drejtë për të mos iu nënshtruar torturës apo keqtrajtimeve, pavarësisht se ai është në duart e një zyrtari publik apo të një individit. Detyrimi i shteteve palë në marrëveshjet ndërkombëtare për të respektuar e siguruar ndalimin e torturës dhe keqtrajtimit konsiston jo vetëm në detyrimin e shtetit për të mbrojtur shtetasit e tij nga kryerja e torturës apo keqtrajtimit nga zyrtarët publik, por edhe në detyrimin për të marrë masa për t’i mbrojtur njerëzit ndaj akteve të torturës apo keqtrajtimit të kryer edhe nga individë.

**VGJK 41/2007:** Gjykata Kushtetuese vlerëson se njohja me ligj e të drejtës së ankimit në gjykatat e sistemit gjyqësor për mosshqyrtimin brenda afateve nga organi administrativ nuk përbën cenim të parimit kushtetues të garantimit të pavarësisë së gjykatave. Kontrolli gjyqësor mbi administratën publike bazohet në parimet kushtetuese të balancimit të pushteteve (neni 7) dhe të shtetit të së drejtës (neni 4) dhe është sanksionuar si parim procedural edhe në Kodet e Procedurave Administrative e Civile. Pikërisht në nenet 324, 328 e 331 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar e drejta për të ngritur padi në gjykatë edhe në rastin e mosshqyrtimit të kërkesës nga ana e administratës publike brenda afateve ligjore. Në këtë mënyrë, ligjvënësi për të garantuar një mbrojtje më të mirë të interesave të kërkuësve për dhënien e statusit të dëshmorit, vendos autoritetin administrativ nën kontrollin gjyqësor.

## Neni 8

1. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj.
2. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet.
3. Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.

## Neni 9

1. Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike.
2. Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe ato me karakter të fshehtë janë të ndaluara sipas ligjit.
3. Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike.

## Neni 10

1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare.
2. Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike.
3. Shteti njeh barazinë e bashkësive fetare.
4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjelltë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve.

5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend.

6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

#### Neni 11

1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

2. Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj.

3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.

#### Neni 12

1. Forcat e armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues.

2. Forcat e armatosura ruajnë asnjësinë në çështjet politike dhe i nënshtrohen kontrollit civil.

3. Asnjë forcë e huaj ushtarake nuk mund të vendoset dhe as të kalojë në territorin shqiptar, si dhe asnjë forcë ushtarake shqiptare nuk mund të dërgohet jashtë, përveçse me një ligj të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

#### Neni 13

Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.

---

**VGJK 29/2006:** ... Gjykata Kushtetuese vlerëson të nevojshme t'i japë përgjigje kërtimeve të parashtruara nga palët në proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave nëpërmjet kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike përkatëse, të analizuar në raport me Kartën Europiane të Automisë Vendore, si dhe të kryejë **interpretimin përfundimtar të nenit 13** të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të dispozitave të tjera të saj, që sanksionojnë çështjet që lidhen me parimin e decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore. Thelbi i nenit 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë janë parimi i decentralizimit të pushtetit dhe i autonomisë vendore. Në të vërtetë, ai që decentralizohet është ushtrimi i pushtetit në formë ndarjeje të kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Sistemi ynë normativ nuk është i decentralizuar, por hierarkik sipas strukturës së parashkuar në nenin 116 të Kushtetutës. Në një sistem të tillë normativ bëhet pikërisht detajimi kushtetues i ndarjes së kompetencave në nivelin vendor. Normat juridike vendore nuk mund të kenë natyrë primare, për arsye se qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë kontrohet në sistemin e një shteti unitar. Për shkak të unitarizimit të shtetit shqiptar, sistemi ynë nuk bazohet në parimin e devolucionit, që nënkupton dhënie kompetencash nga pushteti qendror njësisë vendore. Qeverisja vendore nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre, nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë. Parimi i decentralizimit të pushtetit është parim thelbësor mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore. Ai ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të qeverisjes vendore si dhe raporti që ajo ka me pushtetin qendror varen nga kuptimi kushtetues dhe ligjor që u jepet decentralizimit të pushtetit, autonomisë vendore dhe vetëqeverisjes. Decentralizimi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të decentralizimit qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit "ushtrimi i përgjegjësisë publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t'i takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve." Decentralizimi ka përmasat e veta, politike, administrative dhe financiare, të cilat ndërveprojnë midis

tyre dhe përfaqësojnë në thelb tre komponentët e pushtetit. Decentralizmi është *politik* dhe përfshin transferimin e autoritetit politik në nivelin vendor nëpërmjet një sistemi përfaqësimi të bazuar në zgjedhjet politike vendore. Nëpërmjet decentralizmit *administrativ* transferohet përgjegjësia për çështjet e administrimit të disa funksioneve publike qendrore të njësitë vendore, ndërsa decentralizmi financiar i referohet zhvendosjes së pushtetit financiar pranë nivelit vendor, me qëllim pajisjen e tij me autoritet më të madh në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përshtatur atë koncept decentralizmi që i referohet ristrukturimit ose riorganizimit të pushtetit dhe që bën të mundur krijimin dhe funksionimin sipas parimit të subsidiaritetit të një sistemi bashkëpërgjegjësie të institucioneve të qeverisjes në nivel qendror dhe vendor. Ky koncept i përgjigjet më mirë nevojës për një autonomi substanciale të qeverisjes vendore, aftësisë së kësaj të fundit për të lehtësuar pushtetin qendror si edhe dobisë për zgjidhjen e problemeve vendore. Autonomia është një regjim i tillë juridik, në të cilin organet e njësisve vendore veprojnë në pavarësi për zgjidhjen e atyre çështjeve që Kushtetuta dhe ligjet ua kanë lënë atyre në kompetencë. Aspektin e vet më të dukshëm, autonomia e pushtetit vendor e shpreh në ndarjen e kompetencave, e cila ka të bëjë me iniciativën që kanë ose duhet të kenë, në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit, organet e qeverisjes vendore për të vendosur vetë për problemet që hyjnë në juridiksionin e tyre. Për këtë çështje, nga një vështrim krahasues në legjislacionin bashkëkohor konstatohen dy prirje. Nga njëra anë, përkrahet ideja e parashikimit të kompetencave të qeverisjes vendore me ligj të veçantë, ashtu siç aplikohet edhe mundësia që këto kompetenca të sanksionohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Parashikimi në ligj i kompetencave për pushtetin vendor nuk përjashton mundësinë, përkundrazi përforcon mendimin, se ato mund të ndryshohen, të kufizohen ose të hiqen nga pushteti qendror në çdo kohë, sidomos kur shfaqet mosmarrëveshje midis pushtetit qendror dhe atij vendor ose edhe në raste të ndryshimit të raportit të forcave politike. Kështu, në një sistem të qeverisjes vendore që bazohet në *devolucionin* (kalimin e kompetencave) dhe *dekocentrimin* (shpërqendrimin e autoritetit) njësitë vendore nuk vetëqeverisen, por vetë-administrohen. Në sistemin e vetë-administrimit, zgjidhja e çështjeve vendore është deleguar nga qendra dhe ato shihen si çështje publike të përgjithshme që lindin në terren vendor. Dhënia me ligj e kompetencave nga parlamenti, (për rrjedhojë, edhe modifikimi i tyre) ose delegimi i kompetencave të pushtetit qendror njësisve vendore (logjikisht, edhe tërheqja e tyre) shpesh në sistemin, ku njësitë lokale vet-administrohen; pra, ato zgjidhin çështjet e tyre në mënyrë autonome vetëm brenda kufijve të përcaktuar nga ligji. Vetë-administrimi në këtë formë nuk është gjë tjetër veçse çlirim dhe lehtësim barre i pushtetit qendror. Kjo mënyrë organizimi nuk mund të quhet vetëqeverisje. Në një sistem vetëqeverisës, parimi i subsidiaritetit kërkohet që problemi të vështrohet në drejtim të anasjelltë, si çështje vendore që ka ndikim në interesin e përgjithshëm. Kjo do të thotë se ndërsa vetë-administrimi ndërtohet nga lart, vetëqeverisja ndërtohet nga poshtë. Pra, vetëqeverisja vendore është institucion, me anë të të cilit sanksionohet e drejta e vetëqeverisjes së shtetasve, si e drejtë politike e tyre. Njësitë vendore vetëqeverisëse nuk mund të pengohen dhe as të reduktohen, në hapësirën juridiksionale të tyre, nga organet qendrore të pushtetit, pasi ato kanë fushën e tyre të veprimtarisë të parashikuar nga Kushtetuta. Për shkak të karakterit që ka në ndarjen dhe balancimin e pushtetit vetëqeverisja vendore përbën një bazë thelbësore për rendin demokratik dhe shtetin e së drejtës. Nga kjo pikëpamje, përcaktimi i kompetencave drejtpërdrejt në Kushtetutë paraqet rëndësi të veçantë, sepse një zgjidhje e këtillë do ta bënte të pafuqishme prirjen qeverisëse, për t'i ndryshuar ligjet në çdo kohë. Sigurisht, një zgjidhje e tillë e garanton qëndrueshmërinë e kompetencave të pushtetit vendor dhe e bën të pafuqishëm presionin politik të qeverisë që mund të ushtrohet në çdo kohë. Pikërisht një model të tillë ka zgjedhur Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Vetëqeverisja vendore paraqitet me një status kushtetues dhe pavarësia e saj është e garantuar nëpërmjet saj. Kjo pavarësi qëndron në të drejtën që kanë shtetasit për të formuar organet përfaqësuese dhe për të ushtruar funksionin e vetëqeverisjes (referendumeve) [nenet 108/4; 109, 110 të Kushtetutës; në pavarësinë organizative të institucioneve vendore (neni 113); në ushtrimin e punëve brenda juridiksionit të tyre, pa ndërhyrjen e organeve qendrore të pushtetit (neni 113); në ekzistencën e mjeteve financiare dhe të mjeteve të tjera, me të cilat ajo disponon në mënyrë të pavarur (nenet 111, 113/b,c,ç); në ekzistencën e administratës së pavarur pa përzjerjen e organeve qendrore (neni 113/d); në ekzistencën e normave për funksionimin e vetëqeverisjes vendore dhe mbrojtjes kushtetuese të të drejtave vetëqeverisëse, (nenet 113/, pika 2, 3) etj.]. Kompetencat e sanksionuara si edhe parimet, mbi bazën e të cilëve mund të kalohen me ligj kompetenca të tjera njësisve të qeverisjes vendore, janë elementë të rëndësishëm që kanë gjetur pasqyrim në Kushtetutë, gjë që përbën një veçori karakteristike të saj. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar një sistem të politikës dhe të administrimit vendor autonom që është diametralisht i kundërt me atë të sistemit shtetëror njëpartiak. Duke ngritur një sistem të tillë, është synuar tu vihen pengesa prirjeve të centralizmit burokratik të shtetit. Natyrisht, kompetencat e dhëna nga ligjvënësi organeve të qeverisjes vendore mund të modifikohen ose të tërhiqen nga ai, sipas vlerësimit politik të tij, por Kushtetuta parashikon rezervën e saj për kompetencat themelore të caktuara në Pjesën e Gjashtë, të cilat nuk mund të preken nga ligjvënësi, pasi çdo cenim i tyre kontrollon nga Gjykata Kushtetuese. Pra, megjithëse karakteristika e qeverisjes vendore, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është kombinimi i *regjimit konstitucional* me *devolucionin parlamentar*, është pikërisht ekzistenca e kompetencave kushtetuese për pushtetin vendor që e ngre këtë të fundit në shkallën e njësisë vetëqeverisëse, duke mos e kuptuar atë si njësi thjesht vet-administruese. Gjithashtu, Kushtetuta nënkupton edhe respektimin e dy kriterëve të rëndësishme, *ekskluzivitetin* e kompetencës, - sipas të cilit, në çështjet lokale nuk mund të përzihet shteti dhe *komplementaritetin*, - kur njësitë vendore janë në pamundësi të zgjidhin çështjet e tyre, pushteti qendror angazhohet qoftë nëpërmjet ndihmës materiale-financiare, qoftë nëpërmjet delegimit të kompetencave të administratës shtetërore. Të gjitha këto përfundime që rrjedhin nga dispozitat kushtetuese janë shprehje e autonomisë vendore. Në këtë kuptim, autonomia është vetëqeverisje, dhe, nga ana tjetër vetëqeverisja paraqet autonomi kushtetuese. Mbështetur në analizën doktrinare që iu bë parimit të decentralizmit të pushtetit e të autonomisë vendore, bazuar edhe në standarde demokratike që sanksionon Karta Europiane e Autonomisë Vendore, Gjykata Kushtetuese vlerëson të domosdoshme të zgjidhë mosmarrëveshjen ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, e cila shprehet si mosmarrëveshje kompetence dhe që rezulton të jetë e pranishme në ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Kjo mosmarrëveshje ka lindur për shkak të ushtrimit të kompetencave në fushën e planifikimit urban, si dhe të kontrollit mbi territorin në mënyrë të dubluar nga organe të të dy pushteteve, veprime të cilat kanë pasur si pasojë mosfunksionimin normal të veprimtarisë shtetërore. Është pikërisht kjo ndarje kompetencash që i heq mundësinë juridike Bashkisë, si njësi bazë e qeverisjes vendore, për të vendosur për probleme dhe çështje që janë në kompetencë të saj, në bazë të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, por që me ligje të veçanta i janë dhënë pushtetit qendror. Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim pikërisht këtë mënyrë të ndarjes së kompetencave nga ligjvënësi, duke e trajtuar problemin jo si vullnet ose dëshirë të pushtetit qendror për tu transferuar kompetenca organeve të qeverisjes vendore, por si detyrim të tij për të mos cenuar me ligj ato parime kushtetuese që qëndrojnë në themelin e dy shtyllave të qeverisjes vendore, të decentralizmit të pushtetit dhe të autonomisë vendore. ... Duke iu referuar rregullave të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të

theksojë se orientimet kryesore që ajo përcjell tek shtetet anëtare, nënshkruese të saj për një kuptim të drejtë të parimeve të demokracisë e të decentralizimit të pushtetit, kërkojnë “ekzistencën e bashkësive vendore të pajisura me organe vendimore të formuara në mënyrë demokratike dhe që gëzojnë një autonomi të gjerë për sa u përket kompetencave, mënyrave të ushtrimit të këtyre të fundit dhe mjeteve të nevojshme për përmbushjen e misionit të tyre.” Kompetencat, me të cilat ligji pajis organet e qeverisjes vendore, duhet të jenë të tilla që një pjesë e mirë e çështjeve publike të rregullohen sipas parimit të subsidiaritetit. E drejta ligjore për të rregulluar dhe menaxhuar çështje të caktuara publike duhet të ushtrohet nga organe që qëndrojnë sa më afër qytetarëve dhe të shoqërohet edhe me mjete efektive për konkretizimin e tyre. Në realitet, shumë çështje kanë implikime si vendore ashtu edhe kombëtare dhe përgjegjësia për to ndryshon në hapësirë dhe në kohë dhe, për më tepër, kjo përgjegjësi mund të ndahet edhe ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Gjithsesi, kufizimi i veprimtarisë së autoriteteve vendore vetëm në çështje që nuk kanë implikime të gjera, mbart rrezikun për t’i shndërruar ato në autoritete me një rol të parëndësishëm. Nga ana tjetër, është e nevojshme që pushtetit qendror t’i rezervohen disa funksione të rëndësishme me rëndësi kombëtare e strategjike. Përcaktimi i interesit të komunitetit lidhet edhe me nevojën e ekzistencës së kufijve për vetë pushtetin vendor, i cili nuk duhet të tejkalojë kompetencat e tij duke vendosur për çështje që i përkasin një vendimmarrje të pastër politike ose për çështje që kanë pasoja ekonomike për të gjithë vendin dhe jo vetëm për komunitetin vendor përkatës. Qëllimi i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore është që shtetet palë të krijojnë kuadrin e nevojshëm që autoritetet vendore të kenë një diapazon të gjerë përgjegjësisish, të mundshme për tu realizuar në nivel vendor. Kur fushat e veprimtarisë kanë implikime në nivel vendor, është e rëndësishme që në konceptimin e autoriteteve vendore që veprojnë për të zhvilluar mirëqenien e përgjithshme të banorëve të tyre, ato të kenë të drejtën për të ushtruar iniciativën në këto çështje. Prandaj, sipas paragrafit 3 të nenit 4 të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, ushtrimi i përgjegjësisive duhet të shkojë drejt decentralizimit. Ky parim kërkon që, përveç rasteve kur natyra dhe përmasa e problemit është e tillë që i takon një zone shumë të madhe territoriale dhe me interesa të rëndësishme ekonomike, zgjidhja i duhet besuar qeverisë vendore..... Sipas nenit 8 të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, mbikëqyrja e autoriteteve vendore duhet të synojë vetëm garantimin e pajtueshmërisë me ligjin, duke përjashtuar çdo kontroll për dobishmërinë e veprimeve që përfshihen në sferën e përgjegjësisive të autoriteteve vendore. Për këtë, respektimi i parimit të subsidiaritetit dhe të përpjesëtueshmërisë mbeten aspektet thelbësore të çdo mbikëqyrje administrative të autoriteteve të niveleve më të larta. Gjithashtu, neni 11 i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore u garanton organeve të qeverisjes vendore, kur çmojnë se u janë cenuar ushtrimi i lirë i kompetencave të tyre dhe parimi i autonomisë vendore, të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës që të vendosë nëse një veprim ose mosveprim, vendim ose akt tjetër administrativ është në përputhje me ligjin. Gjykata Kushtetuese vlerëson se tek e drejta e prefektit për të pezulluar aktet e organeve të qeverisjes vendore dhe për t’i dërguar ato për shqyrtim në gjykatë, gjen zbatim parimi i kontrollit administrativ të veprimeve të bashkësive vendore që synon të sigurojë respektimin e parimit të ligjshmërisë dhe të parimeve kushtetuese. Mbi këtë bazë, megjithëse kontrolli mbi ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit vendor ushtrohet nëpërmjet pezullimit të tyre për paligjshmëri nga përfaqësuesi i pushtetit qendror, nuk është KRRTRSH-ja organi shtetëror që i jep zgjidhje përfundimtare çështjes, por është pushteti gjyqësor. Sipas nenit 10 të këtij ligji, organeve të qeverisjes vendore nuk u garantohej mbikëqyrje ligjore në respektim të parimit të kontrollit dhe balancimit të pushteteve, për arsye se e drejta për shfuqizim të akteve juridike drejtpërsëdrejti nga një organ i pushtetit qendror do t’i vendoste ato nën kontrollin hierarkik të tyre. Mbështetur në këto argumente, Gjykata Kushtetuese çmon se rregulli i parashikuar nga kjo dispozitë ligjore, i analizuar në frymën e parimit kushtetues të decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore, rregull që nuk respekton parimin e përpjesëtueshmërisë midis ndërhyrjes së autoritetit kontrollues dhe rëndësisë së interesave që ai kërkon të mbrojë, bie në kundërshtim me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore. Mbi bazën e këtij argumentimi, Gjykata Kushtetuese nxjerr përfundimin se papajtueshmëria kushtetuese e nenit 10, të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, për arsye të të njëjtit rregullim ligjor, sjell të njëjtën pasojë edhe për nenin 6 të ligjit nr.8408, datë 25.09.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”.... Sipas Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, autoritetet vendore duhet të kenë diapazon të gjerë përgjegjësisish, të cilat janë të mundshme për t’u realizuar në nivelin vendor. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, parimi i decentralizimit të pushtetit duhet të përmbajë, në thelbin e vet, përcaktimin e misionit parësor që i ngarkohet pushtetit vendor në administrimin e territorit nën juridiksionin e vet, ku përfshihen edhe çështjet e planifikimit, menaxhimit urban dhe të kontrollit të territorit. Duke i dhënë Policisë Ndërtimore kompetenca për të ndërhyrë pa vendim gjyqësor në veprimtarinë e autoriteteve vendore në fushën e veprave të ndërtimit dhe të planifikimit urban, dispozitat ligjore të sipërpërmendura tejkalojnë standardet kushtetuese dhe normat ndërkombëtare. Mbështetur në të dhënat e kësaj analize, Gjykata Kushtetuese konkludon se ligjvënësi, nëpërmjet rregullimeve ligjore, duhet të orientojë Policinë Ndërtimore drejt një organi shtetëror të pavarur nga pushteti qendror, që do të duhet të ketë, si detyrë kryesore, kontrollin e zbatimit të standardeve teknike mbi territorin, nën autoritetin e qeverisjes vendore.

---

## Neni 14

1. Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja.
2. Flamuri kombëtar është i kuq me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes.
3. Stema e Republikës së Shqipërisë paraqet një shqyt me fushë të kuqe me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes. Në krye të shqytit, me ngjyrë të artë, është vendosur përkrenarja e Skënderbeut.
4. Himni kombëtar është “Rreth Flamurit të Përbashkuar”.
5. Festa Kombëtare e Republikës së Shqipërisë është Dita e Flamurit, 28 Nëntori.
6. Kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë është Tirana.

7. Forma dhe përmasat e simboleve kombëtare, përmbajtja e tekstit të himnit kombëtar, si dhe përdorimi i tyre rregullohen me ligj.

## PJESA E DYTË

### TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT

#### KREU I

#### PARIME TË PËRGJITHSHME

##### Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

---

**VGJK 26/2005:** Doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se **siguria juridike** është ndër elementët thelbësore të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. "Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohet materialisht". Duke afirmuar parimin e sigurisë juridike dhe të elementeve kryesore përbërës të saj, Gjykata Kushtetuese ve në dukje se ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënie ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjithë elementet e tij thelbësorë, ky interes natyreshëm do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike.

---

##### Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.

2. Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

##### Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.



## 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**VGJK 24/2007:** ... Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton disa nga të drejtat themelore të njeriut, por ajo nuk ndalon që shtetet palë të parashikojnë edhe më shumë të drejta e liri për individët, ndërsa Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 17 të saj e ka pranuar përbajtjen e Konventës Evropiane si minimumin e këtyre kufizimeve, pa penguar që legjislacioni vendas t'u japë më shumë të drejta e liri si dhe një dimension më të madh realizimit të mbrojtjes së individit.

**VGJK 29/2005:** Çështja e standardeve pozitive është një koncept që përgjithësisht lejohet nga Kushtetuta, por ky nuk mund të ketë shtrirje të pakufizuar, aq më pak për kategorinë e funksionarëve publikë. Neni 17 i Kushtetutës si dhe qëndrimet e mbajtura nga jurisprudenca gjyqësore pranojnë teorinë e standardit pozitiv kur bëhet fjalë për të drejtat themelore të individit, por jo ndaj zyrtarëve të lartë të shtetit. Shkarkimi nga detyra i gjyqtarit është një procedurë *impeachment*, e cila zbatohet për zyrtarë që ushtrojnë aspekte të sovranitetit shtetëror dhe, si e tillë, ajo nuk mund të barazohet me procedurën që ndiqet për individët e thjeshtë. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një aspekt të të drejtave të çdo individit, por "*kjo nuk është e drejtë absolute. Ajo mund të jetë subjekt i kufizimeve të ligjshme.*" Sidoqoftë, në këtë drejtim, Kushtetuta ka bërë një hap më tej se Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke e shoqëruar masën e shkarkimit të gjyqtarit me garancitë e ankimit në Gjykatën e Lartë. Shtrirja e këtij koncepti edhe për masat e tjera disiplinore bie në kundërshtim me Kushtetutën. Nga ky kuptim, neni 147, pika 6 i Kushtetutës, duke qenë i konceptuar si një dispozitë me karakter përjashtimor, nuk mund të interpretohet në mënyrë zgjeruese.

**VGJK 39/2007:** Për Gjykatën Kushtetuese paraqet rëndësi të veçantë çështja nëse dispozita ligjore, objekt kontrolli, mbështetet ose jo në kriteret kushtetuese të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për të justifikuar në pikëpamje të Kushtetutës, preken e të drejtave dhe lirive themelore të individit, është e domosdoshme të përmbushen disa kushte siç janë ato që kufizimi të realizohet me ligj, të jetë bërë për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, si dhe të mos cenojë thelbin e të drejtave dhe të lirive themelore. Pra, kjo dispozitë kushtetuese kërkon vlerësimin e domosdoshmërisë së ndërhyrjes ligjore të shtetit, në varësi të natyrës së të drejtës, të karakterit të interesit publik që duhet të mbrohet, të rrethanave konkrete që e diktojnë një ndërhyrje në minimum dhe sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut. Sistemi bankar zë vend të rëndësishëm në strukturat ekonomike të një vendi. Ai është një ndër aktorët kryesorë të ekonomisë së tregut, stabiliteti i të cilit është i lidhur drejtpërdrejt me stabilitetin makroekonomik të vendit. Në një sistem të tillë, bankat funksionojnë si ndërmjetës financiar duke mbledhur dhe grumbulluar mjetet e lira financiare të publikut, në formën e depozitave, për t'i përdorur këto fonde për të ushqyer sistemin e kreditimit. Dhënia e garancive ligjore për kthimin e sigurt të kredive bankare i shërben konsolidimit të sistemit bankar, si dhe ndikon drejtpërdrejt në mbrojtjen e depozitave financiare të qytetarëve apo subjekteve të tjerë. Nisur nga ky rol dhe nga atributet që i janë veshur këtij sistemi, parashikimi në ligji i lëshimit të urdhrimit ekzekutiv, sipas kërkesës së subjektit bankar, me qëllim shlyerjen e shpejtë të kredisë pas skadimit të afateve kontraktore, ka patur për qëllim të sigurojë ekuilibrin e nevojshëm ndërmjet interesit publik nga njëra anë, që synon qëndrueshmërinë e sistemit bankar dhe garantimin e kursimeve të depozituesve, si dhe respektimit të të drejtave të individit për një mbrojtje të plotë ligjore, nga ana tjetër. Duke sanksionuar me ligj aktet e dhënies së kredisë bankare në cilësinë e titullit ekzekutiv, i kërkueshëm në mënyrë të drejtpërdrejt nga huadhënësi, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ligjvënësi ka ndjekur një qëllim të përligjur dhe të justifikuar, në këndvështrimin e konceptit kushtetues "*interes publik.*"

**VGJK 41/2007:** Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë në mënyrë më të hollësishme të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai nuk mund të prekë ato të drejta, kufijtë e të cilave në Kushtetutë janë parashikuar shprehimisht si të pakapërcyeshme ose të kufizueshme vetëm në raste specifike. Të drejtat e tjera kushtetuese ai mund t'i kufizojë vetëm në kushtet e nenit 17 të Kushtetutës, pra, për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e të drejtës. Përsa i përket masave të tjera që merr ligjvënësi, qofshin edhe ato me efekte negative për subjektet e ligjit, nuk mund të pranohet se kufizimi i tyre sjell në çdo rast cenimin e parimit kushtetues të mbrojtjes së të drejtave të fituara. **E drejta për shpërblim financiar mujor të familjarëve të dëshmorit nuk është një e drejtë themelore** e parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë apo Konventat Ndërkombëtare dhe as një e drejtë që derivon nga ligje që janë zbatim i të drejtave themelore të qytetarëve. Ajo nuk rrjedh as nga e drejta e sigurimeve shoqërore dhe rrjedhimisht, kushtet e dhënies e të ndryshimit të saj nuk mund të barazohen me të drejtën e përfitimit të pensioneve si një e drejtë themelore, parashikuar në nenin 52 të Kushtetutës. Shpërblimi financiar mujor i familjarëve të dëshmorit ka karakter simbolik dhe është pjesë e nderimit dhe e respektit që shteti bën për veprën e dëshmorit, prandaj masa e tij si dhe rrethi i subjekteve që përfitojnë vlerësohen nga ligjvënësi. Gjykata Kushtetuese çmon se ligjvënësi, sipas vlerësimit e kompetencave të veta, ka vlerësuar që nderimi dhe respekti për dëshmorët do të bëhet nëpërmjet organizimit të ceremonive përkujtimore nga organet shtetërore dhe duke ngritur e mirëmbajtur varrezat, lapidaret, etj.. Organet shtetërore kanë detyrë gjithashtu të ruajnë e mirëmbajnë në muze dokumentet e dëshmorëve dhe t'u japin përparësi familjarëve të dëshmorëve për strehim e punësim. Në kuadrin e këtij nderimi e respekti, ligjvënësi cakton, për një rreth të kufizuar të familjarëve të dëshmorit, një shpërblim simbolik. Rregullimi i mësipërm edhe për shpërblimin simbolik, i sanksionuar me ligj, nuk mund të vlerësohet si cenim i parimit të sigurisë juridike jo vetëm se nuk cenon një të drejtë themelore, por nuk ka të bëjë as me të drejta që të jenë një zbatim i të drejtave themelore. Në lidhje me këtë, edhe Rezoluta e miratuar nga OKB-ja, nr. 2200 XXII, Dhjetor 1966 "Pakti ndërkombëtar lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore", të cilës i referohet kërkuesi, merr në mbrojtje të drejtat themelore të njeriut dhe jo çdo të drejtë kur thekson se "nuk mund të pranohet asnjë kufizim ose shkelje e të

drejtave themelore të njeriut që janë njohur ose janë në fuqi në çdo vend në bazë të ligjeve, konventave, rregulloreve ose zakoneve”.

**VGJK 9/2003:** Dispozitat objekt kërkesë kushtëzojnë të drejtën e ankimit me pagimin paraprak të vlerësimit tatimor, gjë që përbën kufizim të kësaj të drejte. Si çdo e drejtë subjektive, edhe e drejta e ankimit, nuk e përjashton mundësinë që ligjvënësi të vendosë kufizime në ushtrimin e saj për të mbrojtur një interes publik ose të drejtat e të tjerëve. Por, kufizimet mund të vendosen duke u përbushur kushtet garanci për mbrojtjen e të drejtave që parashikon neni 17 dhe pikërisht që kufizimi duhet të bëhet me ligj, të jetë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë, të mos çënojë thelbin e të drejtës dhe të mos tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, për shkaqet që ka parashtruar kërkuesi Gjykata Kushtetuese nuk arrin në përfundimin se dispozitat objekt kërkesë janë antikushtetuese

- Nga përmbajtja e dispozitave në shqyrtim rezulton, se ligjvënësi synon ta detyrojë subjektin e tatuar që krahas me kërkesën për rishqyrtim në organet më të larta tatimore të paguajë vlerësimin tatimor që i detyrohet shtetit. Kjo pagesë paraprake bëhet në përputhje me politikën shtetërore të grumbullimit të të ardhurave të ligjshme me qëllim që shteti të përbushë funksionet e veta ndaj shoqërisë në përgjithësi e shtetasve në veçanti, pra është në interes publik.

## Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.

---

**VGJK 33/2007:** Kjo dispozitë kushtetuese, para së gjithash, sanksionon një detyrim negativ, sipas të cilit shteti duhet të mos ndërhyjë, me qëllim që askush të mos diskriminohet padrejtësisht për shkak të “gjendjes sociale” të tij. Në aspektin konceptual “diskriminim për shkak gjendje sociale” do të thotë se individët mund të diferencohen dhe trajtohen në mënyrë të pabarabartë bazuar në përbërjen sociale, që nuk ka lidhje me meritat e tyre. Është e vërtetë që në mënyrën si është shkruar kjo dispozitë kushtetuese, togfjalëshi “gjendje sociale” si arsye diskriminimi, shfaqet si shkak më vete nga shkaqet e tjera që kushtetutëbërësi shprehimisht i ka përcaktuar (raca, feja, gjinia, etj.), por Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë dhënë argumente se cili është “shkaku social” që ka krijuar trajtim të diferencuar ndërmjet kategorisë së punëmarrësve dhe punëdhënësve. Pala kërkuese ka pretenduar se, nëse punëdhënësi e zgjidh kontratën, duke respektuar nenet 141, 143 dhe 144 (procedurën dhe afatin e njoftimit) të Kodit të Punës, mund të fshehë shkakun e vërtetë të zgjidhjes së kontratës së punës. Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet jurisprudencës së saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke u shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtim i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”. Në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se nuk jemi para subjekteve në kushte objektivisht të njëjta, në disa aspekte. Barazia e tyre qëndron vetëm në të drejtat e njëjta për të lidhur kontratën e punës e për ta zgjidhur atë për ato arsye që parashikon ajo dhe ligji. Por, ato ndodhen në kushte të pabarabarta për aspekte të tjera. Nga njëra anë qëndron punëdhënësi që sipas Kodit të Punës ka një sërë detyrimesh për të përbushur kur gjendet para respektimit të një marrëdhënie kontraktuale pune, dhe nga ana tjetër qëndron punëmarrësi që përsëri duhet të përbushë një sërë detyrimesh po në këtë kuadër.

**VGJK 26/2005:** Nga shqyrtimi i çështjes del se në rastin e dhënë, ndryshimi i ligjit të favorshëm ndaj një grupi të caktuar të popullsisë, nuk justifikohet me ndonjë interes publik të qenësishëm. Është e vërtetë që dispozita e ndryshuar favorizon pronarët e banesave, por nga ana tjetër ajo diskriminon një grup tjetër (dhe pse të vogël në numër), duke ia cenuar të drejtën minimale për të jetuar, atë të pasjes të një strehe. T’u mohosh të drejtën shtesës së qiramarrësve për t’u bërë pronarë, t’u ndërpresësh kontratën e qirasë pa garantuar strehë tjetër, janë veprime që nuk mund të përlligjen me interesin publik. Parimi i sigurisë juridike nuk mund të eliminojë çdo pasojë negative që mund t’i vijë individit nga rregullimi i ri. Kjo për shkak se siguria juridike është e pandashme nga parimi i shtetit social. Por, në rastin në shqyrtim fjala nuk është për pasoja çfarëdo por për pasoja thelbësore, sepse dispozita e re realizon një ndryshim konceptual mbi raportet e shtetit me qiramarrësit e banesave pronë private, ndryshim që sjell pasoja shumë të rëndësishme. Me raportet e vendosura me dispozitat e mëparshme shteti kishte obligimin e zgjidhjes së strehimit të kësaj shtrese duke i bërë pronarë (ashtu si pjesën më të madhe të shtetasve të tjerë), me dispozitën e re të kontestuar, ai (shteti), i tkurr tej mase këto obligime, duke marrë përsipër kryesisht, vetëm sigurimin e strehimit. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se dispozita e re (pika 1 e nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”), nuk është rezultat i një interesi publik apo i kërkesave të shtetit social. Përderisa në rastin konkret, pa as një shkak të përlligjur është prekur parimi i sigurisë juridike kjo dispozitë është antikushtetuese e duhet të shfuqizohet.

**VGJK 36/2007:** Përsa i përket pretendimit për kufizim të statusit të akademikëve të futur me ligjin e ri, Gjykata Kushtetuese vlerëson se titulli “*akademik*” nuk u hiqet mbajtësve të tij, sepse sipas nenit 7 të këtij ligji, shpërblimin (dhe jo pagën) për këtë titull akademikët e rregullt e përfitojnë edhe pas moshës 75 vjeç. Sa i takon pretendimit të kërkuesit për përjashtim të anëtarëve të jashtëm nga statusi i akademikut, status që gëzohej prej tyre sipas ligjit të shfuqizuar, Gjykata Kushtetuese çmon se përfshirja ose jo e kësaj kategorie anëtarësh me karakter honorifik në strukturën e Akademisë nuk merr dimensionin e një të drejte të cenuar. Në fushën e të drejtave që mbron parimi i të drejtave të fituara përfshihen kryesisht të drejtat themelore të individit, mbrojtja e të cilave shtrihet ndaj të gjitha fushave primare të marrëdhënieve ligjore civile. Ndryshimi i rregullimeve ligjore të një fushe të caktuar marrëdhëniesh, si atribut i pushtetit ligjvënës dhe si çështje që i takon gjykimit diskrecionar të këtij të fundit, duhet të mbajë parasysh respektimin e këtij parimi për ato të drejta mbi të cilat shtrihet dhe mbron ky parim. Mirëpo, të drejtat që kërkuesi i konsideron të cenuara nga ligji objekt shqyrtimi nuk përfshihen në të drejtat që mbron parimi i të drejtave të fituara, prandaj Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

---

## Neni 19

1. Kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Shtetësia shqiptare fitohet edhe për shkaqe të tjera të parashikuara me ligj.
2. Shtetasi shqiptar nuk mund ta humbasë shtetësinë, përveçse kur ai heq dorë prej saj.

## Neni 20

1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre.
2. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t’i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.

## KREU II

### LIRITË DHE TË DREJTAT VETJAKE<sup>1</sup>

## Neni 21

Jeta e personit mbrohet me ligj.

## Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
-

2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.
3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.
4. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.

---

**VGJK 16/2004: Liria e shprehjes** përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë e qeverisjes. Nëpërmjet tyre, pushteti shtetëror, bëhet më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është gjithashtu bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtave dhe lirive të tjera themelore. Për këtë arsye, zbatimi në praktikë i kësaj të drejte kërkon në çdo rast një kuptim dhe interpretim mjaft të gjerë. Sipas nenit 10 të KEDrNj, liria e shprehjes përfshin në vetvete edhe të drejtën e informimit, si një e drejtë themelore për të marrë dhe për të dhënë informacion, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike. Një deklaram i përafërt me këtë bëhet edhe në nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën 217 A (III), datë 10.12.2948.

---

## Neni 23

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

---

**VGJK 16/2004:** E drejta e informimit, ndër elementet e saj kryesorë ka lirinë personale për të marrë informacion, lirinë personale për të dhënë informacion dhe lirinë e shtypit, ose thënë ndryshe, të drejtën e medias për të marrë e dhënë informacion. Kjo e fundit trajtohet gjithnjë si e drejtë më vete, për shkak të rolit të veçantë që luan media në një shoqëri të lirë e demokratike. Pozicioni i "privilegjuar" i medias në shtetin demokratik garantohet për shkak se është pikërisht ajo, që e bën pushtetin shtetëror më të prekshëm për njerëzit, më të kontrollueshëm dhe më transparent. Media ndikon që individët e angazhuar në të tre pushtetet, si persona të zgjedhur apo zyrtarë, të kenë disa cilësi të reja. Ata janë më afër me median, më të komunikueshëm me njerëzit, më të kujdesshëm në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre si dhe në jetën e angazhimet e tjera shtetërore e private. Media është gjithashtu një bazë e rëndësishme për të kontrolluar dhe gjykuar se si funksionarët e veshur me pushtet, ushtrojnë autoritetin publik dhe si i menaxhojnë fondet publike. Garantimi i lirisë së medias, ndër të tjera, zvogëlon mundësinë e manipulimeve me pushtetin publik si dhe nxit identifikimin e rasteve korruptive. Arma e saj më e fuqishme është kritika e vazhdueshme ndaj dukurive negative që rrezikojnë demokracinë si formë e qeverisjes. Në dallim nga KEDrNj, Kushtetuta jonë garanton lirinë e shprehjes në kuptim të ngushtë dhe të drejtën e informimit në dy dipozita të veçanta, respektivisht në nenet 22 dhe 23 të saj. Liria e shprehjes dhe e drejta e informimit, përveç garancisë subjektive si të drejta kushtetuese themelore, janë të lidhura objektivisht edhe me parimin e ndërtimit të një shteti demokratik, të deklaruar në preambulën e Kushtetutës sonë. Zbatimi i këtij parimi të rëndësishëm nënkupton, edhe garantimin e lirisë së shprehjes, lirinë e shtypit dhe të drejtën e informimit si të domosdoshme për një rend të lirë e kushtetues. Mbi bazën e dispozitave respektive kushtetuese, liria e shprehjes dhe e drejta e informimit gjejnë rregullim më të detajuar në disa ligje të veçanta të miratuara në periudhën vijuese (pas aprovimit të Kushtetutës) nga Kuvendi, mes të cilave mund të përmendet ligji nr.8503, datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"; ligji nr.8517, datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"; ligji nr.8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror", etj. Në tërësinë e tij, legjislacioni shqiptar synon të garantojë një nivel bashkëkohor të së drejtës së informimit.

---

## Neni 24

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.

2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve.

3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

## Neni 25

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

---

**VGJK 2/2004:** Gjykata Kushtetuese vlerëson se çështja në shqyrtim kërkon një interpretim më të zgjeruar në aspektin e kuptimit që i jepet termit "torturë" sipas akteve ndërkombëtare dhe në veçanti jurisprudence së pasur që vihet re në këtë drejtim. Neni 1 i Konventës kundër torturës dhe dënimeve e trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, i ka dhënë një kuptim sqarues dhe orientues këtij termi. Kjo dispozitë përfshin disa elementë të rëndësishëm që duhen vlerësuar në rastet kur ndodhë para konsumimit të kësaj vepre penale. Meqenëse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë orientohet pikërisht nga kjo dispozitë e Konventës, çështja objekt shqyrtimi mbetet për t'u analizuar nga Gjykata Kushtetuese si në drejtim të personave që nuk duhet t'i nënshtrohen torturës, ashtu edhe të subjekteve që janë përgjegjës për kryerjen e kësaj vepre penale. Paragrafi i parë i nenit 1 të Konventës së sipërcituar nënkupton se vepra penale e torturës drejtohet kryesisht ndaj personave të privuar nga liria, ose ndaj personave që përballen me organet shtetërore. Subjektet që kryejnë këtë veprë penale ajo i fokuson kryesisht në personat zyrtarë ose në personat që nxiten prej tyre. Nga mënyra e formulimit të veprës penale të torturës në dispozitat e Kodit Penal, rrethi i subjekteve që mund të përgjigjen penalisht për këtë veprë merr një kuptim më të gjerë. Madje, në literaturën juridike, është pranuar se subjekti i kësaj vepre penale është subjekt i përgjithshëm ose i posaçëm, civil a ushtarak. Pikërisht, një trajtim i tillë i çështjes sipas kërkesit, prek konceptin që i japin veprës penale të torturës aktet ndërkombëtare. Duke e analizuar çështjen në shqyrtim nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se për të konkluduar mbi pajtueshmërinë ose jo të dispozitave të Kodit Penal me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara duhet të interpretohet neni 1 i Konventës kundër torturës në kuptimin e tij të gjerë në harmoni edhe me paragrafin e dytë të tij. Sipas këtij paragrafi, kuptimi i dhënë në paragrafin e parë të nenit 1 të Konventës nuk mund të çenojë asnjë instrument ndërkombëtar ose asnjë ligj kombëtar që të përmbajë dispozita të një karakteri më të gjerë. E drejta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut sanksionon si rregull vetëm një minimum bazë të lirisë dhe të drejtave, ndërkohë që shtetet palë në konventat ndërkombëtare mund të ngrihen mbi këto minimume dhe të implementojnë ligje kombëtare që përmbajnë ose mund të përmbajnë dispozita të një karakteri më të gjerë. Pra, kjo dispozitë e Konventës nuk vendos kufizime për shtetet palë, përkundrazi, e lë në diskrecionin e tyre që të vendosin në legjislationin e brendshëm rregulla të një spektri më të gjerë. Tortura dhe çdo trajtim çnjerëzor e degradues janë të ndaluara sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare penale. Ndalimi i torturës dhe trajtimeve poshtëruese e degraduese gjen pasqyrim të plotë në shumicën e traktateve ndërkombëtare. Detyrimi për të mos iu nënshtrohet torturës apo keqtrajtimit është një rregull i së drejtës ndërkombëtare zakonore dhe se ndalimi i torturës përbën një normë të pakundërshtueshme. Ndalimi i torturës në kuadrin e sanksionimit të të drejtave të tjera të njeriut në aktet ndërkombëtare përbëjnë një garanci për qytetarët jo vetëm ndaj abuzimeve shtetërore, por edhe ndaj abuzimeve të individëve. Aktet ndërkombëtare dhe jurisprudenca e zhvilluar në këtë drejtim e kanë lidhur të drejtën për të mos iu nënshtrohet torturës dhe keqtrajtimit, me detyrimin e shtetit për të siguruar mbrojtje nëpërmjet masave legjislative, ose masave të tjera kundër torturës apo keqtrajtimit nga individët. Qëllimi i dispozitave që ndalojnë përdorimin e torturës është mbrojtja e dinjitetit dhe integritetit fizik e mendor të individit. Ndaj është detyrë e çdo shteti palë në këto marrëveshje ndërkombëtare të ofrojë për këdo mbrojtje nëpërmjet legjislationit dhe masave të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme kundër veprimeve të ndaluara nga aktet ndërkombëtare, "...pavarësisht nëse shkaktohen nga njerëz që veprojnë në kapacitet zyrtar, jashtë kapacitetit të tillë zyrtar ose në kapacitet privat". Krahas këtij trajtimi doktrinar dhe evolutiv që vihet re në jurisprudencën ndërkombëtare argumenta tepër të rëndësishme për të konkluduar për zgjidhjen e çështjes konkrete gjenden edhe në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në çështjen *A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ajo konkludon se "detyrimi i shteteve anëtare nga neni 1 i Konventës për t'i siguruar kujtdo që është nën juridiksionin e tij të drejtat dhe liritë e shprehura në Konventë e kombinuar së bashku me nenin 3 të saj, i kërkon shteteve anëtare të marrin masa të përcaktuara për të siguruar se individët nën juridiksionin e tyre nuk janë subjekt i torturës apo keqtrajtimit çnjerëzor degradues duke përfshirë edhe keqtrajtimet e kryera nga individët privatë". Pikërisht bazuar mbi një konkluzion të tillë, dështimi që mund të vihet re në ligjet e brendshme të shteteve të ndryshme për të siguruar një mbrojtje adekuate përbën shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nisur nga kjo analizë me karakter interpretues, bazuar edhe në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese konkludon se për sa kohë që ndalimi i torturës dhe keqtrajtimit është përcaktuar si një e drejtë njerëzore dhe përderisa të drejtat e njeriut janë konsideruar si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, çdonjeri ka të drejtë për të mos iu nënshtrohet torturës apo keqtrajtimit, pavarësisht se ai është në duart e një zyrtari publik apo të një individit. Detyrimi i shteteve palë në marrëveshjet ndërkombëtare për të respektuar e siguruar ndalimin e torturës dhe keqtrajtimit konsiston jo vetëm në detyrimin e shtetit për të mbrojtur shtetasit e tij nga kryerja e torturës apo keqtrajtimit nga zyrtarët publik, por edhe në detyrimin për të marrë masa për t'i mbrojtur njerëzit ndaj akteve të torturës apo keqtrajtimit të kryer edhe nga individë.

## Neni 26

Askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve.

## Neni 27

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.
2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:
  - a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
  - b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;
  - c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
  - ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;
  - d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;
  - dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.
3. Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

## Neni 28

1. Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij.
2. Personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi c, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.
3. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.
4. Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.

5. Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

#### Neni 29

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.

3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.

#### Neni 30

Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

#### Neni 31

Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;

b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

---

**VGJK 5/2003:** Nga materialet e dosjes nuk vërtetohet që të pandehurit apo mbrojtësit të tij t'i jetë komunikuar rekursi i prokurorit. Mosnjoftimi i rekursit vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 414 të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet se "Akti i ankimit i njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private, nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin". Mospërmushja e këtij detyrimi ligjor nuk i ka dhënë mundësi të pandehurit të dijë që çështja e tij do të paraqitet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, dhe të njihej me shkaqet e parashtruara në rekurs, duke i mohuar kështu të drejtën për t'u mbrojtur. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, e ka gjykuar çështjen në mungesë të mbrojtësit të të pandehurit, pa verifikuar arsyet e mosparaqitjes kur nga dosja rezulton se as i pandehuri dhe as mbrojtësi i tij nuk kanë patur dijeni për ushtrimin e rekursit nga prokurori dhe për ditën e gjykimit në Gjykatën e Lartë.

---

#### Neni 32

1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.

2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

---

**VGJK 7/2005:** Ky parim i rëndësishëm është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës së Strasburgut si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe veçanërisht në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur, e cila kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës. Në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykata e ka për detyrë të vlerësojë në tërësi, nëse procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat ishte e drejtë.<sup>[1]</sup> Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykoës nuk mund të mos nënkuptojë që procesi ishte i parregullt.<sup>[2]</sup> Asnjë gjykatë nuk ka mundësi, që pa dëmtuar dhënien e "përmasës së duhur të drejtësisë", të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme. Nisur nga këto qëndrime të evidentuara në jurisprudencën evropiane, Gjykata Kushtetuese e ka konsoliduar qëndrimin e saj, duke evidentuar dallimin që ekziston në një proces ligjor ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Vlerësimi i provave mbetet një çështje për t'u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit, mund dhe duhet të investohet, kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerrogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete.

---

### Neni 33

1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.
2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

### Neni 34

Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

### Neni 35

1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.
2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.
3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.
4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.

---

**VGJK 16/2004:** 2. E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare përbën edhe sot një nga sfidat e shteteve të lira e demokratike, veçanërisht të demokracive të reja. Garantimi i kësaj të drejte themelore është edhe një reflektim ndaj përvojës negative të rregjimeve totalitare e diktatoriale, tendenca e të cilëve ka qenë ndërhyrja ekstreme edhe në çështjet apo vendimet intime personale apo familjare. Në ndryshim nga formulimi i bërë në nenin 12 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ku ndër të tjera thuhet se, "Askush nuk mund të jetë objekt i ndërhyrjes arbitrare në jetën e tij private, në familje, ...", në nenin 8 të KEDrNj, theksohet: "E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare". Një formulim i tillë që ndryshon edhe nga mënyra e garantimit të të drejtave të tjera themelore që përmban KEDrNj, është bërë qëllimisht për të evidentuar, jo vetëm detyrimin negativ të autoriteteve publike për të mos ndërhyrë në jetën private dhe familjare, por edhe detyrimin pozitiv shtetëror për t'i mbrojtur këto të drejta sa më realisht, përmes organeve të tre pushteteve; ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Gjykata Kushtetuese vlerëson se për mbrojtjen e kësaj të drejte dhe



për arrijten e konkluzioneve për çështjen në gjykim, rëndësi të veçantë merr edhe përcaktimi i nocionit të jetës private. Duhet theksuar me këtë rast se ky nocion, nuk ka karakter shterues. Ai ka ardhur duke u zgjeruar vazhdimisht jo vetëm përmes jurisprudencës së GjEDrNj, por edhe nga zhvillimet e diferencuara ligjore dhe jurisprudenciale të vetë shteteve palë në KEDrNj. Megjithatë, në përgjithësi, pranohet se e drejta për respektimin e jetës private në thelbin e saj duhet të sigurojë individit një hapësirë, brenda së cilës, ai do të mund të zhvillonte dhe plotësonte në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Sigurisht, që këtu, përfshihet edhe zhvillimi apo ruajtja në një masë të caktuar e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë. Pra, respektimi i jetës private kërkon në parim mosndërrhyrjen në vendimet që merr vetë individi rreth mënyrës së bërjes së jetës së tij. Mbrojtja e jetës private dhe familjare, në Kushtetutën tonë, bëhet përmes disa dispozitave, veçanërisht nga neni 35 (mbrojtja e të dhënave personale), neni 36 (liria dhe fshhtësia e korrespondencës), neni 37 (paprekshmëria e banesës), neni 53 (mbrojtja e martesës dhe familjes), etj. Për çështjen në gjykim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se është e nevojshme të analizohet neni 35 i Kushtetutës, në të cilin, që në paragrafin e parë, deklarohet se “Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij”. Padyshim që edhe në këtë rast, në parim, qëllimi i hartuesve të Kushtetutës ka qenë pikërisht garantimi i asaj hapësire të nevojshme brenda së cilës, individi, do të mund të zhvillonte në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Në këtë kuadër, sigurisht që është e drejtë e individit të vendosë vetë për mënyrën dhe masën e paraqitjes së tij si person para të tjerëve dhe publikut në tërësi. Është me rëndësi të ritheksoset se “me të dhëna që lidhen me personin e tij” duhet të kuptohen në radhë të parë dhe kryesisht të dhënat me karakter sensitiv, të tilla si origjina racore dhe etnike, bindjet, përkatësitë politike, bindjet fetare, gjendja shëndetësore, jeta seksuale dhe gjendja penale, (shih nenin 2/b të ligjit 8517, datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”), të dhënat e grumbulluara në mënyrë të justifikueshme nga autoritetet kompetente shtetërore, etj. Të dhënat mbi të ardhurat apo pasurinë kanë karakter personal. Për rrjedhojë, ato përfshihen në hapësirën e gjerë që mbrohet nga neni 35 i Kushtetutës. Si rregull, bërja e tyre publike, kërkon pëlqimin e vetë personit të interesuar. Gjykata Kushtetuese vë në dukje gjithashtu, se vetë neni 35 i Kushtetutës, krijon mundësinë e bërjes publike të të dhënave personale edhe pa pëlqimin e personit, nëse një gjë të tillë e “kërkon ligji” (paragrafi 1) ose në rastet e “parashikuara me ligj” (paragrafi 2). Një kufizim i tillë, në kushte të caktuara, gjen mbështetje edhe nga neni 17 i Kushtetutës (kufizimi të bëhet “...vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve...”). Duke pasur parasysh edhe KEDrNj si dhe jurisprudencën e GjEDrNj, vlerësohet se rastet që do të justifikonin në tërësi kufizimin me ligj të kësaj të drejte do të ishin siguria kombëtare, mirëqenia ekonomike e vendit, mbrojtja e rendit kushtetues, parandalimi i veprave penale, mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, etj. Në çdo rast konkret, legjitimitimi ose jo i ndërhyrjes do të varej kryesisht nga intensiteti i saj, shkalla e cënimit të jetës private, domosdoshmëria e kësaj ndërhyrjeje në shoqërinë demokratike dhe në realitetin konkret që e ka diktuar atë, efektiviteti dhe proporcionaliteti në raportin e qëllimit që është synuar të arrihet dhe mjeteve të përdorura për arrijten e tij. Mbi të gjitha duhet patur parasysh se sa më shumë të depërtohet në sferën e jetës intime apo sensitive, aq më shumë rritet edhe detyrimi i pushtetit publik për mbrojtjen e jetës private. Gjykata Kushtetuese çmon se në rastin konkret, kufizimi i të drejtës së jetës private në formën e deklarimit të pasurisë dhe mosmarrjes së pëlqimit për publikimin e mundshëm të të dhënave personale për tre kategori personash (subjekti deklarues, familjarët e tij dhe personat e lidhur me të) në përputhje me ligjin “Mbi të drejtën e informimit”, vjen për shkak të interferimit me njëra tjetrën të dy vlerave të rëndësishme kushtetuese apo dy të drejtave themelore të analizuara më sipër, të garantuara si nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe nga Konventa Evropiane dhe të Drejtave të Njeriut. Prandaj duhen përcaktuar kriteret apo standardet që duhen patur parasysh për të vlerësuar se cila nga këto dy vlera kushtetuese, në një realitet konkret, ka përparësi ndaj vlerës tjetër. Për vendosjen e këtij raporti apo për zgjidhjen e çështjes se legjitimiti ose jo të kësaj ndërhyrjeje, para së gjithash duhet të bëhet referimi në parimin kushtetues të proporcionalitetit, i cili gjen zbatim efektiv veçanërisht në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër, ai shërben si masë kontrolli kushtetues edhe për veprimtarinë legjislative të Kuvendit. Për këtë arsye, është e nevojshme që në bazë të metodës objektive – teleologjike, të evidentohet kuptimi dhe qëllimi kryesor që synon të arrijë ligjvënësi përmes këtij ligji në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë edhe përmes ndërhyrjes në sferën e jetës private. Mbi këtë bazë duhet argumentuar nëse kjo ndërhyrje apo ky mjet i përdorur është i domosdoshëm, i përshtatshëm, proporcional dhe efektiv. Një gjë e tillë arrihet përmes kriterit balancues, i cili bën të mundur të peshohen e vlerësohen sa më drejt të mirat e përgjithshme apo interesat publike që mbrohen në raport me të drejtën e kufizuar. Një e drejtë apo interes, sado me rëndësi publike apo me vlerë që të jetë, nuk mund të peshohet në mënyrë disproporcionale me një të drejtë apo interes tjetër të mbrojtur nga Kushtetuta dhe ligji. Marzhi i këtij vlerësimi, dhe për rrjedhojë edhe raporti që krijohet ndërmjet interesit të mbrojtur dhe atij të cënuar, ndryshon në çdo rast konkret. Ai varet nga një sërë rrethanash dhe kushtesh që ndryshojnë nga një vend në një tjetër, nga një periudhë e caktuar kohore në një tjetër, nga rangu i të drejtave që vendosen në balancë si dhe pasojat që do të kishte përparësia e secilës prej tyre. Gjykata Kushtetuese konstaton se qëllimi kryesor për miratimin e ligjit nr.9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” ka qenë marrja e masave sa më efektive për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, rritja e besimit në institucionet shtetërore, transparenca, parandalimi i rasteve të abuzimit me pushtetin shtetëror dhe pasurimit të paligjshëm të personave të zgjedhur ose të atyre që kryejnë funksione të caktuara shtetërore. Këto fenomene të dëmshme pengojnë zhvillimin e vendit, mirëqënien e përgjithshme dhe ndërtimin e një shteti të lirë e demokratik. Prandaj ligjvënësi ka synuar që në këtë betejë të rëndësishme për fatet e demokracisë në Shqipëri t’i sigurohet një pjesëmarrje aktive dhe publikut. Kjo pjesëmarrje garantohet përmes transparencës, njohjes dhe vlerësimit të publikut të gjerë edhe me të dhënat mbi deklarimet e pasurisë së personave të zgjedhur apo zyrtarë. Deklarimi i pasurisë dhe mundësia e publikimit të të dhënave të deklaratës në përputhje me ligjin nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, është gjithashtu një ndihmesë për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesave. Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vetë, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizike dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike. Deklarimi dhe regjistrimi i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, verifikimi i tyre si dhe mundësia e bërjes publike të të dhënave që kanë këto deklarime ndikojnë pozitivisht në identifikimin ose shmangien e rasteve të konfliktit të interesave, pra edhe të rasteve korruptive. Të dhënat personale me karakter pasuror, si rregull, hyjnë në sferën e jetës private, prandaj në rastin konkret gjen zbatim neni 35 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDrNj. Megjithatë, ato nuk kanë atë natyrë dhe atë karakter që kanë të dhënat me karakter sensitiv, të cilat përbëjnë edhe thelbin e jetës private dhe familjare. Janë pikërisht këto të dhëna, të cilat i krijojnë mundësi individit të zhvillojë në mënyrë të pavarur personalitetin e tij dhe që “në mënyrë të bazuar dhe të njohur nga të tretët, nuk mund të jenë nën vëzhgimin e publikut”. Të dhënat pasurore në tërësinë e tyre nuk e kanë këtë karakter. Për më tepër, në tërësi shpesh ato janë vetiu

nën vëzhgimin dhe vlerësimin e publikut të gjerë. Nga ana tjetër, marzhi i vlerësimit në këtë rast është dhe duhet të jetë shumë më i gjerë dhe tolerues, pasi bëhet fjalë për persona të rëndësishëm publikë, të veshur me pushtet të konsiderueshëm shtetëror. Transparenca dhe besimi i publikut në këtë kategori njerëzish luajnë rol të rëndësishëm në shtetin e lirë e demokratik. Pikërisht për këtë arsye, në jurisprudencën e vendeve të ndryshme demokratike është deklaruar se “publikimi i detajeve mbi të ardhurat ose pasurinë personale nuk përbën ndërhyrje në jetën private, veçanërisht nëse personi ushtron funksione publike ose kuazi – publike”. Gjykata Kushtetuese ka parasysh se kufizimi që i bëhet jetës private në formën e deklarimit dhe mundësisë së publikimit të të dhënave personale me karakter pasuror të subjekteve të caktuara është bërë me ligj, ashtu siç kërkohet edhe nga nenet 17 dhe 35, respektivisht paragrafi i parë dhe i dytë i Kushtetutës sonë si dhe nga paragrafi i dytë i nenit 8 të KEDrNj. Konstatohet gjithashtu se, qëllimi i synuar justifikon plotësisht miratimin e një ligji të tillë. Nga ana tjetër, vlerësohet se mjetet e përdorura për arritjen e këtij qëllimi legjitim, pra kërkesat për deklarimin e pasurisë së subjekteve të caktuara, burimeve të saj dhe mundësia e publikimit të tyre, janë efektive dhe në proporcion me qëllimin e synuar. Ligjvënësi ka treguar kujdes në balancimin sa më të drejtë të së drejtës themelore të informimit dhe detyrimit për respektimin e jetës private. Në balancimin ndërmjet këtyre dy të drejtave themelore, është patur parasysh kontributi që sjell deklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, i burimeve të saj si dhe publikimi i tyre në debatin e përgjithshëm, duke u kthyer kështu në mjet për arritjen e qëllimeve që synohen në rastin konkret. Detyrimi për deklarimin e të ardhurave dhe pasurisë personale si dhe mundësia e publikimit të tyre, nuk synojnë dëmtimin apo denigrimin e subjekteve deklaruese, por një transparencë dhe kontroll më rigoroz ndaj pasurimit apo raporteve të tyre financiare me persona të tretë. Nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon se publiku ka interes të ligjshëm, që përmes transparencës, të informohet më në detaje jo vetëm mbi punën dhe veprimtarinë, por edhe mbi të ardhurat, pasurinë dhe burimet e saj të personave të zgjedhur ose zyrtarë. Pra, balanca e gjetur vlerësohet si e drejtë dhe e bazuar. Për rrjedhojë, konstatohet se ndërhyrja apo kufizimi i sferës së jetës private në formën e dhënies së informacionit mbi pasurinë dhe burimet e saj dhe mundësia e publikimit të tyre, të jenë të justifikuara dhe të domosdoshme në kushtet aktuale të shoqërisë shqiptare. Kërkuar ka pretenduar se neni 34 i ligjit nr.9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, është antikushtetues edhe për shkak se publikimi i të dhënave mund të bëhet pa pëlqimin e subjektit deklarues, gjë që sipas tij bie ndesh me nenin 35 të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese thekson se edhe ky pretendim nuk qëndron. Ajo rithekson se një kufizim i tillë është në përputhje dhe bazohet në nenin 35 paragrafi i dytë i Kushtetutës (parashikohet në ligj), në nenin 17, paragrafi i dytë i Kushtetutës (nuk e çënon thelbin e së drejtës për privatësi dhe nuk i tejkalon kufizimet e parashikuara në KEDrNj) si dhe nenin 8, paragrafi i dytë i KEDrNj (kufizimi synon mirëqënien ekonomike të vendit, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, etj). Për më tepër, vlerësohet se, në këtë rast, ligjvënësi, ka patur parasysh edhe nenin 11, shkronja “b”, të ligjit nr.8517 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ku radhitet si një nga rastet kur nuk është e domosdoshme dhënia e pëlqimit paraprak për trajtimin ose publikimin e të dhënave personale edhe atëhere kur një gjë e tillë është e “nevojshme për përmbushjen e një detyrimi ligjor të vetë subjektit të të dhënave”. Nga ana tjetër, duhet patur parasysh se në nenin 5 të ligjit nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, theksohet qartë se “Çdo person ka të drejtë të informohet për të dhënat vetjake të personave që kryejnë funksione shtetërore ose shërbime publike, ... Për aq sa këto të dhëna lidhen me cilësi të kërkuara nga ligji ose nga një akt nënligjor për personat që i ushtrojnë këto detyra”. Në këtë kuptim rezulton se Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive nuk bën dhe nuk mund të bëjë publike me iniciativën e tij të dhënat që përmban deklarata vetjake e subjektit deklarues. Këto të dhëna jepen vetëm në bazë të kërkesës së bërë (nga publiku) dhe në përputhje me kriteret kushtetuese e ligjore për çdo rast konkret, por sigurisht pa qenë nevoja e dhënies së pëlqimit paraprak nga subjekti deklarues. Detyrimi i nenit 10 të ligjit nr.9049 për dhënien e një autorizimi të veçantë nga subjekti deklarues përmes të cilit autorizohen organet përkatëse të verifikojnë të dhënat e deklaruara, nuk ka të bëjë me dhënien e pëlqimit për publikimin e të dhënave personale, por me vlefshmërinë dhe kontrollin e tyre nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive apo çdo organ tjetër shtetëror që parashikohet me ligj. Pa këtë autorizim do të bëhej pothuajse i pamundur ky proces, veçanërisht në mekanizmat respektive jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

## Neni 36

Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara.

## Neni 37

1. Paprekshmëria e banesës është e garantuar.
2. Kontrolltet e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj.
3. Askujt nuk mund t'i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjeluar një rrezik që i kanoset sigurimit publik.

## Neni 38

1. Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit.

2. Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit.

#### Neni 39

1. Asnjë shtetas shqiptar nuk mund të dëbohet nga territori i shtetit.

2. Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor.

3. Ndalohet dëbimi kolektiv i të huajve. Dëbimi i individëve të huaj lejohet në kushtet e përcaktuara me ligj.

#### Neni 40

Të huajt kanë të drejtën e strehimit në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit.

#### Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

---

**VGJK 30/2005:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenet 41 dhe 181, ka pranuar kriteret e “rregullimit të drejtë” dhe të “shpërblimit të drejtë”. Nga këto kriteret kushtetuese rezulton se kriteri për shpërblimin ose kompensimin në dobi të ish-pronarit nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë. Ky rregullim kushtetues i detyrohet jo vetëm funksionit të dyfishtë privat dhe shoqëror që mbart në vetvete e drejta e pronës, por edhe rrethanave historike, politike, ekonomike, shoqërore e juridike, të cilat kanë ndikuar në situatën e krijuar dhe, si të tilla, nuk mund të mos i kishte parasysh ligjvënësi. Funksioni *privat* që ka e drejta e pronës sjell ndikimin e vet në gëzimin normal të lirisë dhe të të drejtave të individit. Kuptimi historik dhe ai sotshëm i garancisë së pronës është kuptimi i një të drejte themelore që lidhet pazgjidhshmërisht me lirinë individuale. Prona ka njëkohësisht edhe karakterin e dallueshëm *shoqëror*, sepse përdorimi i saj duhet t’i shërbejë mirëqënies publike. “Për sa kohë funksioni i pronës është një mjet për ruajtjen e lirisë vetjake, prona gëzon një mbrojtje të veçantë... Nga ana tjetër, ligjvënësi mund të vendosë kufizime ndaj pronës sa më i madh të jetë funksioni social i saj”. Sidoqoftë, “garancia kushtetuese e pronës nuk mund të pranojë kufizime jo proporcionale, dmth., kufizime që nuk justifikohen me konsiderata sociale.” Nga koncepti i të drejtës së pronës që ka pranuar Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 41 të saj, të cilin e ka sanksionuar edhe neni 1 i Protokollit Shtojcë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk rrjedh asnjë e drejtë absolute për shpërblim të plotë. Çështja e detyrimit për dëmshpërblim në vetvete dhe kufijtë e tij përcaktohen nga rrethanat e secilit rast konkret. Shtetit ka një hapësirë të gjerë vlerësimi, për arsye se ai njeht gjendjen dhe raportet shoqërore më mirë se çdo individ dhe se vetëm ai ka në dispozicion mjetet ligjore për t’i përmirësuar ato. “Objektivat legjitim të *interesit publik* si ato që ndiqen në kuadrin e masave të reformës ekonomike, ose masat e hartuara për të arritur drejtësi më të madhe shoqërore, mund të kërkojnë një rimbursim më të vogël se vlera e plotë e tregut.”<sup>1</sup>.. Gjykata Kushtetuese konstaton se një ndër kriteret kushtetues që gjen zbatim në këto dispozita ligjore të sipërcituara është “*interesi publik*”. Çdo ndërhyrje ndaj pronës mund të justifikohet vetëm nëse është në interesin publik ose të përgjithshëm. “Marrja e pronës në bazë të një politike të llogaritur për të arritur drejtësi shoqërore brenda komunitetit mund të përshkruhet saktësisht si politikë në interesin publik.” Prandaj, i njihet e drejta ligjvënësit që, për arsye të

ekzistencës së interesit publik, të mund të kufizojë hapësirën e disponimit të pronës private. Me qëllim që një ndërhyrje e tillë ndaj të drejtës së pronës të jetë e justifikuar, është e domosdoshme që të ekzistojë edhe një marrëdhënie përpjestimore midis mjeteve të përdorura dhe synimit që kërkohet të realizohet. Mbi këtë bazë, sistemi ligjor duhet të përmbajë një sërë garancish procedurale për të siguruar që ndikimi i tij mbi të drejtën e pronës të mos jetë arbitrar dhe as i paparashikueshëm.

## Neni 42

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

---

**VGJK 23/2007:** Në shqyrtimin e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese përqendrohet vetëm në ato pretendime që kanë të bëjnë me parimet themelore të procesit gjyqësor civil. Në këtë kuadër ka rëndësi të shqyrtohet pretendimi për shkeljen e parimit të barazisë së armëve në proces si dhe pretendimi për shkeljen e parimit të sigurisë juridike si një aspekt i parimit të shtetit të së drejtës. Me këtë rast Gjykata Kushtetuese thekson se barazia e armëve është një aspekt i rëndësishëm i konceptit të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Ky parim nënkupton që secilës palë në proces t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet (ku përfshihet edhe paraqitja e provave nga ana e saj), në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të dukshëm në raport me palën tjetër. ... Në mënyrë të veçantë, neni 42 i Kushtetutës, i vë detyrë gjykatës së zakonshme të bëjë një shqyrtim të përshtatshëm të pretendimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin nëse këto prova janë të rëndësishme për vendimin e saj.

**VGJK 42/2007:** Duke qenë se gjatë gjithë kësaj kohe kërkuesi ka hasur në refuzimin e organeve kompetente për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë, ai, pasi i ka shtuar të gjitha mjetet ligjore të vëna në dispozicion për këtë qëllim, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për të konstatuar cenimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e veprimeve të organeve të mësipërme. Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuesi legjitimohet në kërkesën e tij drejtuar kësaj Gjykate dhe se pretendimet e tij për cenimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor janë të bazuara. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla mund të thuhet se procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

**VGJK 24/2007:** E drejta e çdo individi për t'iu drejtuar gjykatës buron nga neni 42/2 i Kushtetutës. Përsa u përket gjyqtarëve, Kushtetuta i ka deleguar ligjvënësit kompetencën që, nëpërmjet ligjit, të rregullojë në mënyrë të hollësishme çështjet që lidhen me transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore, por pa u shprehur për të drejtën e ankimit të tyre dhe për organin që do të shqyrtojë këto ankesa. Jo vetëm kaq, por legjislacioni ynë ka parashikuar të drejtën e aksesit të një numri funksionarësh publikë nëpërmjet rrugës gjyqësore si p.sh. nëpunësit e shërbimit civil kundër vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil, për largimin e tyre nga detyra, apo të prokurorëve për të kërkuar pagën nëse shkarkimi i tyre nga detyra është i pabazuar. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton disa nga të drejtat themelore të njeriut, por ajo nuk ndalon që shtetet palë të parashikojnë edhe më shumë të drejta e liri për individët, ndërsa Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 17 të saj e ka pranuar përmbajtjen e Konventës Evropiane si minimumin e këtyre kufizimeve, pa penguar që legjislacioni vendas t'u japë më shumë të drejta e liri si dhe një dimension më të madh realizimit të mbrojtjes së individit.

**VGJK 18/2005:** ...Gjykata Kushtetuese rithekson se, e drejta për një proces të rregullt ligjor, luan rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Realizimi i kësaj të drejte shfaqet në aspekte të ndryshme, ndërmjet të cilave, një vend të rëndësishëm ze edhe respektimi i parimeve të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e caktuar me ligj. Për të verifikuar nëse është shkelur parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese e sheh me vend të aplikojë kriteret që ka zhvilluar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në këtë drejtim ka adaptuar një trajtim *in concreto*, duke u shprehur se, "arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke patur parasysh, sidomos, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit si dhe sjelljen e autoriteteve kompetente"...Gjykata Kushtetuese vëren se, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë patur për shqyrtim një çështje civile komplekse. Konkretisht, konstatohet se këtyre gjykatave u janë paraqitur një padi dhe një kundërpadi dhe në gjykim kanë marrë pjesë një numër i madh palësh, të cilët kanë paraqitur një sërë pretendimesh.

**VGJK 5/2006:** Në radhë të parë, neni 42/2 i Kushtetutës e përcakton si një të drejtë themelore të qytetarëve që për mbrojtje të të drejtave, lirive e interesave të tyre ligjore e kushtetuese t'i drejtohen gjykatës. Në përputhje me këtë, Kodi i Procedurës Civile, në pjesën e përgjithshme, ashtu dhe në atë të posaçme, zbërthen e zhvillon më tej në sensin pozitiv atë ç'ka garanton Kushtetuta. Kështu, në nenin 31 Kodi e përkufizon padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që bën pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar në fakte e në ligje ose jo, kurse neni 32, shkronja "a", parashikon se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur.

**VGJK 38/2007:** Parimi i paanësisë që zbatohet për çdo çështje kërkon nga gjyqtarët që të mos kenë paragjykimë në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe të mosveprojnë në mënyrë të tillë që ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. "E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet". Në këtë kuadër, Gjykata Kushtetuese ka theksuar në disa vendime të saj se "parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimit të përligjur në këtë drejtim... Paanshmëria është një parim kushtetues që duhet respektuar nga gjyqtari në çdo shkallë të procesit, detyrim nga i cili nuk përjashtohet as gjyqtari në Gjykatën e Lartë. Sipas nenit 15 të Kodit të Procedurës Penale: "Gjyqtari që ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim pas prishjes së vendimit". Pavarësisht nga natyra e veçantë që paraqet gjykimi në dhomën e këshillimit, vlerësimi nga pikëpamja ligjore i ekzistencës ose jo të shkaqeve të ngritura në rekurs nga një kolegji që në përbërje të tij ka gjyqtarin që e ka marrë këtë vendim në një tjetër shkallë gjykimi, është një moment i rëndësishëm që ndikon në rregullsinë e procesit gjyqësor.

**VGJK 31/2005:** Gjykimi i çështjes nga një gjykatë "e caktuar me ligj" është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Por e drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon gjithashtu që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë prej ligjit. "Një tribunal karakterizohet në kuptimin thelbësor të shprehjes nga funksioni i tij gjyqësor, me të cilin duhet kuptuar të vendosurit mbi çështjet brenda kompetencave të tij, bazuar në rregullimet ligjore dhe sipas procedurave të zhvilluara në mënyrë të përcaktuar. Ai duhet gjithashtu të kënaqë një numër kërkesash të mëtejshme si pavarësia veçanërisht prej ekzekutivit; paanësia; qëndrueshmëria në detyrë e anëtarëve të tij; garancitë e ofruara nga procedura e tij – disa prej të cilave shfaqen edhe në vetë tekstin e nenit 6/1 të konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

**VGJK 5/2003:** ...Gjykata Kushtetuese vlerëson se: - Për të garantuar një proces penal të drejtë, ka rëndësi themelore që i akuzuari të marrë pjesë dhe të mbrohet në gjykim dhe në rast mosparaqitje të tij, nuk mund të gjykohet pa iu siguruar më parë mbrojtja me avokat. Qëndrimi i kundërt vjen ndesh me nenin 42 të Kushtetutës dhe me kërkesat e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

- Që e drejta e mbrojtjes me avokat të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por edhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve;

- Mosnjoftimi i kërkuarit dhe i mbrojtësit për rekursin e prokurorit kundër vendimit të gjykatës së apelit që e kishte deklaruar atë të pafajshëm si dhe mosmarrja pjesë e tyre në seancë gjyqësore për shkak se nuk janë njoftuar, u ka hequr mundësinë për të realizuar mbrojtjen. Një qëndrim i tillë vjen në kundërshtim me nenin 6/3 shkronja "c" të Konventës dhe neni 31/ç të Kushtetutës, sipas të cilave çdo i akuzuar ka të drejtë, "... të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij";

- Ashtu siç përcaktohet në Kushtetutë dhe në Konventë, pjesëmarrja në gjykim dhe ushtrimi i së drejtës së mbrojtjes, janë aspekte të procesit të rregullt ligjor, të lidhura mes tyre dhe që plotësojnë njëra-tjetrën për garantimin e së drejtës së mbrojtjes. Si e tillë, e drejta e mbrojtjes nuk mund të mohohet dhe as të reduktohet. Edhe në rast se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk pranon të marrë pjesë vetë në gjykim, atij duhet t'i garantohet e drejta për t'u mbrojtur me avokat;

- Mossigurimi i pjesëmarrjes në gjykim të të akuzuarit, në çdo rast por dhe atëherë kur ky i fundit i fshihet drejtësisë, nuk mund të përligjë zhvillimin e procesit kundër tij pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e mbrojtësit. Parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal, kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjojnë njëllëj si ato të prokurorit. Ky parim presupozon që secilës palë, duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër. Në rastin konkret, kërkuessit nuk i është krijuar një mundësi e tillë. Përkundrazi, gjykata duke dëgjuar vetëm argumentet e prokurorit të ngritura në rekurs dhe të parashtruara në seancë dhe duke mos dëgjuar pretendimet e kërkuessit (aq më tepër që ky i fundit nuk ka dijeni për rekursin), i ka dhënë procesit gjyqësor zhvillim të njëanshëm;

- Në analizë të fundit, kërkuessi pretendon për proces të parregullt sepse kundër tij u dha vendimi i formës së prerë pa u njoftuar për rekursin e prokurorit kundër vendimit që e kishte deklaruar atë të pafajshëm dhe pa u mbrojtur ndaj akuzës nëpërmjet avokatit të caktuar prej tij;- Siç ve në dukje Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vendimin për çështjen "Lala" kundër Hollandës: "Për t'u konsideruar i drejtë procesi gjyqësor penal, është me rëndësi vendimtare që të akuzuarit t'i sigurohet mbrojtje efektive jo vetëm në shkallë të parë, por edhe në apel, bile me përparësi për këtë të fundit". Në pikëpamjen e Gjykatës Kushtetuese është e papranueshme që neni 6/1 i Konventës të përshkruajë me hollësi garancitë procedurale që u ofrohen palëve në gjykim dhe të mos mbrojtë në radhë të parë atë të drejtë, e cila bën të mundur realizimin e këtyre të drejtave të tjera dhe që është pjesëmarrja në gjykim. Në rast se një pjesëmarrje e tillë mungon, nuk mund të bëhet fjalë për proces të rregullt. E drejta për të marrë pjesë në gjykim, presupozon jo vetëm pjesëmarrjen fizike të palës, por krijimin për të të mundësive që duke njohur pretendimet e palës tjetër, të jetë në gjendje të parashikojë prapësimet dhe pretendimet e saj. Kjo nuk është një kërkesë formale dhe pa rëndësi, por substanciale dhe e domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave të palës sepse vetëm në këtë mënyrë sigurohet roli i paanshëm i gjykatës dhe i jepet asaj mundësia reale të

shprehë me vendim opinionin për çështjen, pa cënuar rregullsinë e procesit. Duke shqyrtuar çështje të kësaj natyre për shkelje të të drejtës kushtetuese të shtetasve për një proces të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese synon të konfirmojë atë praktikë të saj për zbatimin me korrektësi e konsekuencë të kërkesave të nenit 6 të Konventës dhe dispozitave kushtetuese si dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me këtë rast Gjykata Kushtetuese ve në dukje se në një shtet ligjor, kërkesat e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dispozitat e Kushtetutës që garantojnë të drejtën e individit për proces të rregullt ligjor, duhet të zbatohen pa asnjë rezervë dhe se shkelja e tyre duhet t'i nënshtrohet një kontrolli të rreptë dhe efektiv për të siguruar realisht të drejtat kushtetuese.

---

## Neni 43

Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.

---

<sup>1</sup> **VGJK 14/2005:** Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta e ankimit në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet kuptuar si një mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Pra, me Kushtetutë, kujdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkallim pozitiv krahasuar me standartet që ofron në këtë drejtim Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në nenin 6 të kësaj Konvente nuk parashikohet e drejta për të pretenduar mjete ankimi kundër vendimeve gjyqësore, e për pasojë, as detyrimi i shteteve palë për të ngritur gjykata apeli ose rishikimi (Gjykata të Larta ose Kasacioni). Prandaj, sipas jurisprudencës së Strasburgut, nuk mund të konsiderohet cënim i këtij neni fakti nëse në rrugë ligjore, Ligjvënësi i një prej shteteve palë në Konventë do të zëvendësonte ose anulonte (hiqte) një mjet ankimi ekzistues, të parashikuar në legjisllacionin e tij. Megjithatë, në nenin 2 të Protokollit 7 të Konventës, vetëm për çështjet penale, është parashikuar e drejta e çdo personi të dënuar për kryerjen e një veprë penale që të paraqesë të paktën një herë për shqyrtim në një gjykatë më të lartë çështjen e deklarimit të fajësisë ose të masës së dënimit të tij. Por, sipas paragrafit të dytë të nenit 2 të Protokollit 7 të Konventës, edhe në këto raste, shtetet palë kanë liri mjaft të gjerë vlerësimi dhe veprimi për të përjashtuar nga e drejta e ankimit vepra të lehta penale ose rastet kur personi është gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, etj.. Madje, edhe në rastet kur parashikohet shprehimisht e drejta e ankimit në çështjet penale, ato (pra shtetet palë) janë të lira ta vlerësojnë e lejojnë atë edhe për çështje të faktit dhe të ligjit ose ta kufizojnë vetëm për çështje të ligjit. Megjithëse neni 6, si rregull, nuk garanton të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, në rastet kur ai parashikohet si i tillë nga Kushtetuta apo legjisllacioni i brendshëm i shteteve palë në këtë Konventë, “proceset që do të zhvillohen në gjykatat e apelit ose kasacionit duhet të respektojnë me rigorozitet garancitë themelore të këtij neni. Për aq sa është e mundur, këto kërkesa apo standarte duhet të zbatohen edhe në gjykimet që zhvillojnë gjykatat kushtetuese të këtyre shteteve. Në këtë kuadër dhe brenda këtyre standarteve, duhet të shihet edhe e drejta e ankimit. Për këto arsye, kufizimet e mundshme që mund t'i bëhen njohjes dhe ushtrimit të kësaj të drejte (pra të drejtës së ankimit), nga legjisllacioni i brendshëm, në analogji me të drejtën e aksesit në gjykatë që garanton paragrafi i parë i nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duhet të plotësojnë dy kushte themelore: të ndjekin një qëllim të ligjshëm dhe të mos çenojnë thelbin e kësaj të drejte (të drejtës së ankimit). Përveç sa më sipër, si për çdo të drejtë tjetër të garantuar nga Konventa, sipas jurisprudencës së Strasburgut, është mëse e domosdoshme që për çdo realitet konkret, legjitimitimi ose jo i ndërhyrjes duhet të vlerësohet lidhur ngushtë me parimin e proporcionalitetit apo domosdoshmërisë së këtij kufizimi në një shoqëri demokratike. Në rastin në gjykim, këto kritere duhet të ballafaqohen para së gjithash me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sipas të cilit, kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duke qenë gjithnjë në përpjestim me gjendjen që i ka diktuar. Ato nuk mund të çenojnë thelbin e së drejtës dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Shihet qartë se kriteret e Konventës për kufizimin e mundshëm të së drejtës së ankimit, përfshihen plotësisht brenda kërkesave të nenit 17 të Kushtetutës lidhur me kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese. Për më tepër, sipas këtij neni, kufizimet e këtyre të drejtave duhet të kenë si pikë maksimale referimi, pikërisht standartet e kësaj Konvente.

**VGJK 9/2003:** ... E drejta e ankimit është element i procesit të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe e lidhur ngushtë me parimin e dëgjimit, parashikuar në nenin 33 të Kushtetutës. Ajo parashikohet si “ankim efektiv” në nenin 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas kësaj të drejte, çdo individ, mund t'i drejtohet instancave kombëtare kur pretendon se është viktimë e një mase të marrë nga autoritetet shtetërore dhe që sipas tij vjen në kundërshtim me Kushtetutën, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe ligjet e brendshme. E drejta e ankimit presupozon të drejtën e qytetarit për t'u drejtuar një organi më të lartë shtetëror, pranimit e ankimit, ekzistencën e organit për shqyrtimin e ankimit, afatet optimale të shqyrtimit, shqyrtimin objektiv, kontrollin gjyqësor si kontrollin përfundimtar ndaj ankimit dhe një garanci për një rehabilitim të mundshëm si pasojë e shqyrtimit dhe pranimit të ankimit.

---

## Neni 44

Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

### KREU III

## LIRITË DHE TË DREJTAT POLITIKE

### Neni 45<sup>2</sup>

1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.
2. Përrjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht.
3. Të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë, kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur.
4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

**VGJK 40/2007:** E drejta e votës është një nga të drejtat themelore politike që gëzon individi. Kjo e drejtë ushtrohet nëpërmjet ngritjes së një sistemi zgjedhor që garanton fshehtësinë, lirinë dhe barazinë e votës duke i siguruar shtetasve qenien e tyre politikisht aktiv duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që duhet të kenë ata në një sistem demokratik. E drejta e votës është një element qendror i demokracisë dhe i shtetit të së drejtës. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa bërë dallime mbi baza shtresash apo përkatësie në grupe të caktuara shoqërore ose mbi baza të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike. Nga ushtrimi i të drejtës së votës nuk duhet përjashtuar asnjë pjesë sado e vogël e popullsisë, përveç rasteve të përcaktuara në ligjin themeltar të shtetit. Megjithatë e drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve. Në këtë këndvështrim, për vetë rëndësinë që merr kjo e drejtë në një shoqëri demokratike, kufizimet që i duhen bërë kësaj të drejte jo vetëm duhet të jenë të pakta, por ato duhen zbatuar brenda kufijve kushtetues. E rëndësishme është që kufizimet të mos jenë të tilla që ta bëjnë jo efektive ushtrimin e kësaj të drejte ose ta cenojnë atë në thelbin e saj, pasi e drejta e votës nuk është një privilegj që pushteti shtetëror ua njeh shtetasve, por një instrument për të zgjedhur mënyrën dhe personat që do të qeverisin vetë ata. Duke ushtruar të drejtën e votës zgjedhësit i krijojnë mundësinë të ndikojnë në mënyrën dhe cilësinë e funksionimit të rendit juridik duke e bërë shtetasin më të përgjegjshëm për rolin që ai ka në drejtimin e jetës së vendit. Ky është në fakt edhe thelbi i demokracisë. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 45 të saj, parashikon të drejtën e çdo individi mbi 18 vjeç të zgjedhë e të zgjidhet. Përrjashtim bëjnë personat të cilëve u është hequr kjo e drejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë për paaftësi mendore. Gjithashtu, paragrafi 3 i këtij neni parashikon se të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur. Ky parashikim kushtetues është brenda standardeve demokratike dhe bashkëkohore. Gjykata Kushtetuese thekson se teoria e së drejtës kushtetuese si dhe praktika gjyqësore evropiane e quan të pranueshme dhe të justifikuar vendosjen e kritereve të tilla si, moshë minimum ose vendbanimi në një zonë të caktuar, përrfshirja në lista zgjedhësisë apo pasja e shtetësisë së vendit ku zhvillohen zgjedhjet si dhe aftësia mendore për të shprehur vullnetin politik. Duke iu referuar edhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dispozita e nenit 1 Protokollit 3 të Konventës Evropiane për të Dretat e Njeriut, vendet anëtare kanë një hapësirë të gjerë në hartimin e legjisllacioneve të tyre për zgjedhjet natyrisht duke respektuar thelbin e së drejtës. Kufizimet që mund t'i vendosen kësaj të drejte duhet t'i përrgjigjen një qëllimi legjitim dhe të mos jenë arbitrare apo joproporcionale. Neni 45/3 i Kushtetutës sonë ka shkuar tej parashikimeve minimale si detyrime që rrjedhin dhe nga aktet ndërkombëtare. Këto akte, që synojnë garantimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, u lënë shteteve anëtare një hapësirë të gjerë vlerësimi të mekanizmave që kanë në dispozicion për ta bërë ushtrimin e të drejtës së votës efektive edhe për grupe të posaçme. Në këtë aspekt i është lënë vetë shteteve anëtare të vlerësojnë, midis të tjerave, edhe grupet e individëve që mund të përjashtohen nga e drejta e votës, psh., vendosja e një moshe më të lartë për të ushtruar të drejtën e votës ose vendosja e kritereve të tilla si shtetësia. Në rastin konkret, ligjvënësi ynë ka vendosur minimumin e kritereve kufizuese duke iu njohur të burgosurve të drejtën aktive të zgjedhjes. Pra, nga pikëpamja e garancisë kushtetuese formale e drejta e votës së të

burgosurve është arritur nga dispozita e nenit 45/3 të Kushtetutës. Parashikimi i të drejtës së votës në përgjithësi dhe i grupeve të posaçme, siç konsiderohen të burgosurit, në veçanti, është shprehje e një demokracie politike dhe paraqet rëndësi për pjesëmarrjen e gjerë të votuesve në një proces të rëndësishëm. Gjykata Kushtetuese konstaton se neni 63 i Kodit Zgjedhor vendos rregullat e ushtrimit të drejtës së votës për të burgosurit në zbatim të detyrimit që rrjedh nga dispozita e nenit 45/3 të Kushtetutës. Konkretisht, paragrafi 2 i nenit 63 parashikon votimin për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, kurse paragrafi 3 i këtij neni i referohet votimit në zgjedhjet për pushtetin vendor. Një nga dallimet midis këtyre dy dispozitave është se për zgjedhjet vendore ligjvënësi e ka lidhur ushtrimin e të drejtës së votës me vendbanimin, ndërsa për zgjedhjet e përgjithshme jo. Arsyeja e këtij dallimi duhet kërkuar tek fakti se në zgjedhjet e përgjithshme votohet për anëtarët e organit ligjvënës, të cilët i përkasin të gjithë popullit. Një nga parimet kryesore të përfaqësimit popullor është edhe mungesa e mandatit detyrues të deputetit, pra deputeti përfaqëson jo zonën zgjedhore ku ai votohet por të gjithë zgjedhësit. Ndryshe ndodh në rastin e zgjedhjeve vendore. Këtu synohet një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit lokal. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimiti parashkollor, pastrimi dhe gjelbërimi i mjediseve të njësisë vendore, etj. Për këtë arsye, votimi në zgjedhjet vendore trajtohet si pjesë e strukturës së demokracisë nga posht lart duke u mundësuar zgjedhësve pjesëmarrjen në qeverisje edhe në forumet më të vogla, përveç parlamentit kombëtar. Në këtë këndvështrim, pranohet se pushteti lokal është më afër qytetarëve dhe këta të fundit janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në drejtimin e njësisë vendore ku ata kanë vendbanimin. Sipas nenit 12 të Kodit Civil, banimi është "...vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qendron zakonisht ose të shumtën e kohës." Në këtë kuptim, vendbanimi është pika qendrore e marrëdhënieve jetësore të një njeriu. Është kërkesë ligjore që një person të ketë një vendbanim kryesor, brenda një juridiksioni të caktuar, me qëllim që të votojë, të punësohet ose të presë përfitime të tjera brenda këtij juridiksioni. Kushti për të pasur vendbanimin në zonën zgjedhore është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte, qoftë edhe minimale, midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të caktuar. Në këtë këndvështrim, duket me vend që neni 63/3 i Kodit Zgjedhor e lidh ushtrimin e të drejtës së votës për të burgosurit me konceptin e vendbanimit dhe jo me vendin e vuajtjes së dënimit ose vendqendrimin. Gjykata Kushtetuese çmon se kushtëzimi i të drejtës së votës me konceptin e "vendbanimit" në përmbytjen e dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor nuk e bën atë antikushtetuese, përkundrazi ai garanton shprehjen direkte të vullnetit të zgjedhësit për drejtuesit e njësisë vendore ku ai banon. Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosushtrimi i të drejtës së votës nga të burgosurit dhe të paraburgosurit nuk është rrjedhojë e antikushtetutshmërisë së dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor.

#### Neni 46

1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.
2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.
3. Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit.

#### Neni 47

1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.
2. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj.

#### Neni 48

Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

### KREU IV

## LIRITË DHE TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE



## Neni 49

1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.
2. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës.

**VGJK 20/2006:** E drejta për punë që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetues, është një e drejtë e individit në sensin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfutur me punë të ligjshme, fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkupton çdo veprimtari të ligjshme që sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale, përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që i jep Kushtetuta individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit, ka si qëllim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Liria e profesionit nuk është thjeshtë një e drejtë për të patur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit, gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që i bën neni 49 i Kushtetutës të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë. Në këtë mënyrë e trajton të drejtën për punë edhe doktrina kushtetuese, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.

## Neni 50

Të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës.

## Neni 51

1. E drejta e të punësuarit për grevë që ka të bëjë me marrë-dhëniet e punës, është e garantuar.
2. Kufizime për kategori të veçanta të punësuarish mund të vendosen me ligj për t'i siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme.

## Neni 52

1. Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj.
2. Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj.

## Neni 53

1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje.
2. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.
3. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.

## Neni 54

1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

2. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë.

3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

#### Neni 55

1. Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.

2. Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.

#### Neni 56

Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij.

#### Neni 57

1. Kushdo ka të drejtën për arsimim.

2. Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.

3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë.

4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.

5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.

6. Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.

7. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj.

**VGJK 36/2007:** Për Gjykatën Kushtetuese merr rëndësi të veçantë kryerja e analizës kushtetuese të nenit 8 të ligjit, për të nxjerrë përfundime lidhur me ndikimin që mund të ushtrojë kufizimi i të drejtës së votës së anëtarëve të Akademisë mbi moshën 75 vjeç në procesin e riorganizimit të Akademisë së Shkencave, të konstituimit të organeve drejtuese të saj, si dhe në zbatimin e parimeve kushtetuese të autonomisë institucionale dhe të lirisë akademike. Liria akademike dhe autonomia institucionale janë parime të rëndësishme që kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në nenin 57 të saj parashikohet se *“Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj”*. Zhvillimi i autonomisë akademike udhëhiqet nga ideja se shkencën mund të ekzistojë dhe të sjellë progres vetëm kur veprimtaria shkencore e akademike është e lirë dhe e pavarur. Mbi këtë bazë, parimi i lirisë akademike, që shpreh përpjekjen për mbrojtjen nga ndikimet që mund t'i vijnë lirisë së mendimit shkencor nga individë ose pushtete jashtë sferës akademike, ka të bëjë me autonominë institucionale që përfshin kryerjen e një sërë veprimesh dhe ushtrimin e një sërë tagrash në pavarësi nga kontrolli i pushtetit shtetëror. Pikërisht, kjo vetëqeverisje akademike reflektohet në lirinë e kërkimit dhe të krijimit të shkencore, në hartimin e programeve të kërkimit shkencor, në zgjedhjen, në mënyrë të lirë dhe të pakomanduar nga të tjerë të organeve drejtuese, si dhe në përcaktimin në mënyrë të pavarur të rregullave për organizimin dhe funksionimin e vetë institucionit. Për respektimin e këtij standardi kushtetues, ligjvënësi detyrohet të marrë masa të përshtatshme për moskufizimin e mjeteve financiare e organizative, në mënyrë që liria akademike, kërkimi shkencor dhe përcjellja e rezultateve të tij tek publiku të mbeten të paprekura. Sanksionimi drejtpërdrejt në Kushtetutë i autonomisë së institucioneve arsimore e shkencore si edhe i lirisë akademike përbën njëkohësisht një detyrim për ligjvënësin për të kufizuar pushtetet e tij mbi veprimtarinë e tyre në fushë të kërkimit shkencor dhe të mesimdhënies. Nuk ka dyshim se është e drejtë e ligjvënësit të ndërhyjë në rregullimin e përmbajtjes së lirisë akademike, në parashikimin e pavarësisë nga kontrolli shtetëror të aktiviteteve të institucioneve

kërkimore shkencore dhe të arsimit të lartë, pa cenuar autonominë institucionale që garantohet me Kushtetutë. Ushtrimi i tagrës së vendimmarrjes përbën një shprehje të efektivitetit të autonomisë institucionale dhe ndërhyrja e shtetit, pikërisht në këtë aspekt thelbësor, do të sillte vështirësi në zbatimin e ligjit dhe do të cenonte standardet kushtetuese të kësaj autonomie si edhe të lirisë akademike. Në ligjin objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se nuk gjenden dispozita të plota që të rregullojnë tranzicionin për Akademinë e riorganizuar. Parashikimi me ligj i heqjes të së drejtës së votës për anëtarët e Akademisë mbi moshën 75 vjeç përbën mangësi thelbësore të ligjit, që sjell njëkohësisht edhe pamundësinë ligjore, në aspektin procedural, për të riorganizuar Akademinë e Shkencave. Ligji nr. 9655, datë 11.12.2006 "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", në nenin 10 të tij, ka parashikuar Asamblenë si organin më të lartë drejtues të Akademisë, nga i cili do të zgjidhen të gjithë organet e tjera të saj, ndërkohë që akademikëve mbi moshën 75 vjeç u ka hequr të drejtën e votës. Ky parashikim ligjor sjell pamundësinë e mbledhjes dhe të konstituimit të këtij organi, për arsye e thjeshtë se si anëtarë të rregullt të Akademisë mbeten të ushtrorj të drejtën e votës vetëm 11 anëtarë, të cilët përbëjnë më pak se gjysmën e asamblesë së Akademisë, asamble që do të duhet të përbëhet nga 45 anëtarë. Në këtë këndvështrim, ligji nuk ka parashikuar rregullime për mënyrën e vendimmarrjes, duke e bërë këtë në të njëjtën kohë edhe të pazbatueshëm. Referenca që vetë ligji ka bërë tek statuti për mënyrën e funksionimit të organeve drejtuese të Akademisë (neni 9/2) nuk sjell ndonjë zgjidhje, për arsye se statuti nuk ka autorizim ligjor të vendosë rregulla të ndryshme nga ato të ligjit dhe, njëherësh, as mund të bllokojë veprimin e ligjit, me anë të caktimit të rregullave që shmanjin vullnetin e shumicës së anëtarësisë. Nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese konkludon se këto rregullime duheshin parashikuar drejtpërsëdrejti nga ligji dhe jo nga ndonjë akt i prejardhur nënligjor, siç është statuti. Pikërisht, situata e re që krijohet me rregullimin ligjor të parashikuar në nenin 8, që u heq akademikëve mbi moshën 75 vjeç të drejtën e votës krijon një situatë të bllokimit institucional dhe me pasoja të padëshirueshme. Reduktimi i ndjeshëm i numrit të akademikëve, pengon jo vetëm arritjen e *quorum-it* të nevojshëm ligjor për vendimmarrje, gjë që sjell pamundësinë në zgjedhjen e organeve drejtuese, por krijon impakt frenues edhe ndaj lirisë akademike, në kuptimin që ajo vendoset nën presionin e kushteve të papërshtatshme për t'u ushtruar plotësisht. Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese çmon se dispozita ligjore e sipërcituar, në pjesën që mohon të drejtën e votës për akademikët mbi moshën 75 vjeç, me pasojë bllokimin e procesit të vendimmarrjes institucionale dhe mosrespektimin e standardeve kushtetuese të lirisë akademike dhe të autonomisë institucionale, është e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

## Neni 58

1. Liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë.
2. E drejta e autorit mbrohet me ligj.

## KREU V

### OBJEKTIVAT SOCIALE

## Neni 59

1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:
  - a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;
  - b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;
  - c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;
  - ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;
  - d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
  - dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;
  - e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;
  - ë) zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;

g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

2. Përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave.

## KREU VI

### AVOKATI I POPULLIT

#### Neni 60

1. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.

2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij.

3. Avokati i Popullit ka buxhet të veçantë, të cilin e administron vetë. Ai e propozon buxhetin sipas ligjit.

#### Neni 61

1. Avokati i Popullit zgjidhet nga tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë prej 5 vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Avokati i Popullit mund të jetë çdo shtetas shqiptar, me arsim të lartë, me njohuri dhe veprimtari të njohura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit.

3. Avokati i Popullit gëzon imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

4. Avokati i Popullit nuk mund të bëjë pjesë në asnjë parti politike, nuk mund të kryejë veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale dhe as të marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare.

#### Neni 62

1. Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesë të motivuar të jo më pak se një së tretës së deputetëve.

2. Në këtë rast Kuvendi vendos me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij.

#### Neni 63

1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit.

2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme.

3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

4. Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij.

## PJESA E TRETË

### KUVENDI

#### KREU I

### ZGJEDHJA DHE AFATI

#### Neni 64

1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë. 100 deputetë zgjidhen drejtpërdrejt në zona njëemërore me numër të përafërt zgjedhësish. 40 deputetë zgjidhen nga listat shumëemërore të partive dhe/ose koalicioneve të partive sipas renditjes në to.

2. Numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie dhe/ose koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve.

3. Partitë që marrin më pak se 2.5 për qind dhe koalicionet e partive që marrin më pak se 4 për qind të votave të vlefshme në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve, nuk përfitojnë nga listat shumëemërore përkatëse.

---

**VGJK 1/2004:** Sistemi i zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i përcaktuar në nenin 64 të Kushtetutës, është një sistem i përzier me elementë të mazhoritarit që janë mbizotërues dhe i plotësuar me elementë proporcionalë. Kjo për faktin se nga numri i përgjithshëm prej 140 deputetë, 100 prej tyre zgjidhen drejtpërdrejt në zonat njëemërore dhe 40 nga listat shumëemërore të partive ose të koalicioneve të partive. Zgjedhja e mbi 2/3 të deputetëve në zonat njëemërore dhe marrja për bazë e këtyre rezultateve në ndarjen e mandateve plotësuese, përcaktimi i numrit maksimal të deputetëve pa lejuar rritjen e tij dhe mënyra e ndarjes së mandateve plotësuese, sipas paragrafit të dytë të nenit 64 të Kushtetutës, në një raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra në të gjithë vendin, përbëjnë elementet e një sistemi të përzier zgjedhor në të cilin, ndikimin më të madh e kanë elementet mazhoritarë. Për të plotësuar kuadrin e këtij sistemi të përzier, në pikën 3 të nenit 64 të Kushtetutës, është parashikuar përjashtimi nga përfitimi prej listave shumëemërore i partive dhe koalicioneve që marrin përkatësisht më pak se 2.5 % dhe 4 % të votave të vlefshme në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve. Në përcaktimin e një sistemi zgjedhor duhet të merren në konsideratë shumë faktorë, siç janë ata historikë, politikë, etnikë, kulturorë, shoqërorë apo gjeografikë. Çdo sistem zgjedhor në një shoqëri demokratike synon të sigurojë stabilitet dhe qeverisje efektive e të qëndrueshme dhe njëkohësisht, të sigurojë një përfaqësim sa më të gjerë të popullit dhe një shprehje sa më të plotë të vullnetit të tij. Në parim, çdo sistem zgjedhor, konsiderohet në tërësinë e tij, demokratik nëqoftëse nëpërmjet tij, respektohen të gjitha rregullat e një konkurrimi të drejtë e të barabartë. Në radhë të parë, sistemi zgjedhor dhe procedurat që lidhen me zbatimin e tij, duhet të garantojnë e të venë në zbatim përfaqësimin real të komunitetit dhe ushtrimin adekuat të sovranitetit të popullit. Neni 2 i Kushtetutës, duke sanksionuar sovranitetin e popullit si një parim të rëndësishëm kushtetues, në pikën 2, përcakton edhe mënyrën e ushtrimit të tij nëpërmjet përfaqësuesve ose drejtpërsëdrejti. Përfaqësimi i popullit në Kuvend bëhet sipas nenit 64 të Kushtetutës me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të deputetëve në çdo zonë zgjedhore. Fitues është ai që ka marrë numrin më të madh të votave, të cilat shprehin dëshirën dhe vullnetin e popullit. Kandidatët e listës zgjidhen sipas renditjes që bën subjekti zgjedhor. Në zbatim të nenit 64 të Kushtetutës, i gjithë vendi është ndarë në 100 zona zgjedhore me numër të përafërt zgjedhësish dhe çdo zonë ka përfaqësuesin e vet si deputet në Kuvend. Zëvendësimi, qoftë edhe i një deputeti të zgjedhur në zonën njëemërore me një tjetër të listës proporcionale, çënon raportin e përcaktuar nga Kushtetuta. Vlerësimi i elementëve që i përkasin aspektit proporcional në një sistem zgjedhor të përzier, nuk duhet të prekë në mënyrë thelbësore elementin tjetër bazë të sistemit, prandaj, është kusht "sine qua non" që në çdo dispozitë ligjore të bëhen rregullimet e nevojshme pa prekur kriteret dhe raportet e vendosura nga Kushtetuta. Përbajtja e fjalisë së parë të pikës 3 të nenit 14 të Kodit Zgjedhor, prek pikërisht ato raporte të vendosura në Kushtetutë, prandaj është e papajtueshme me të.

---

## Neni 65

1. Kuvendi zgjidhet për katër vjet.
2. Zgjedhjet për Kuvendin zhvillohen 60 deri në 30 ditë para mbarimit të mandatit dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së tij.
3. Mandati i Kuvendit vazhdon deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri. Në këtë ndërkohë Kuvendi nuk mund të nxjerrë ligje ose të marrë vendime, me përjashtim të rasteve të vendosjes së masave të jashtëzakonshme.

## Neni 66

Mandati i Kuvendit zgjatet vetëm në rast lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo. Kur Kuvendi është i shpërndarë, ai rithirret vetiu.

## Neni 67

1. Kuvendi i porsazgjedhur thirret në mbledhjen e parë nga Presidenti i Republikës jo më vonë se 20 ditë nga përfundimi i zgjedhjeve.
2. Në rast se Presidenti i Republikës nuk e ushtron këtë kompetencë, Kuvendi duhet të mblidhet vetë brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

## KREU II

### DEPUTETËT

## Neni 68

1. Kandidatët për deputetë mund të paraqiten vetëm nga partitë politike, nga koalicionet e partive, si dhe nga zgjedhësit.
2. Rregullat për caktimin e kandidatëve për deputetë, për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, si dhe përcaktimi i zonave zgjedhore dhe kushtet e vlefshmërisë së zgjedhjeve rregullohen nga ligji për zgjedhjet.

## Neni 69

1. Nuk mund të kandidojnë e as të zgjidhen deputetë, pa hequr dorë nga detyra:
  - a) gjyqtarët, prokurorët;
  - b) ushtarakët e shërbimit aktiv;
  - c) punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar;
  - ç) përfaqësuesit diplomatikë;
  - d) kryetarët e bashkive dhe të komunave, si dhe prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre;
  - dh) kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve;

e) Presidenti i Republikës dhe funksionarët e lartë të administratës shtetërore të parashikuar nga ligji.

2. Mandati i fituar në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni është i pavlefshëm.

---

**VGJK 37/2000:** Sipas neneve 69/1 pika "d", 69/2, 70/2 dhe 71/2 pika "c" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kryetarët e bashkive dhe komunave nuk kanë të drejtë të kandidojnë e të zgjidhen deputetë dhe anasjelltas, deputetët nuk kanë të drejtë të kandidojnë e të zgjidhen kryetarë bashkie e komune, pa hequr dorë nga kjo detyrë. Funksioni i deputetit, është i papajtueshëm me atë të kryetarit të bashkisë apo komunës.... Vetë delegimi i ushtrimit të pushtetit shtetëror nga populli tek deputetët, u jep mundësi këtyre të fundit të ushtrojnë veprimtari jo vetëm në hartimin e miratimin e ligjeve, por edhe në kontrollin e zbatimit të tyre. Për më tepër, në ligjin nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit", e sidomos në nenet 6, 8 e 10 ku përcaktohen marrëdhëniet e tij me organet e pushtetit vendor, deputetit i janë dhënë kompetenca që në thelb janë kompetenca kontrolli, siç janë e drejta për të kërkuar shpjegime nga ato organe, e drejta të propozojë rishikimin ose shfuqizimin e aktit të marrë nga organet e pushtetit vendor etj. Këto kompetenca nuk mund të kryhen nëse deputeti zbaton njëkohësisht edhe kompetenca ekzekutive në organin e pushtetit vendor.

---

#### Neni 70

1. Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues.
2. Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj.
3. Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre.
4. Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.

#### Neni 71

1. Mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga komisioni përkatës i zgjedhjeve.
2. Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, sipas rastit:
  - a) kur ai nuk bën betimin;
  - b) kur heq dorë nga mandati;
  - c) kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë të parashikuara në nenet 69, 70 paragrafët 2 dhe 3;
  - ç) kur mbaron mandati i Kuvendit;
  - d) kur mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht në Kuvend;
  - dh) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

#### Neni 72

Para fillimit të ushtrimit të mandatit deputetët bëjnë betimin në Kuvend.

#### Neni 73

1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe për votat e dhëna prej tij. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.

2. Deputeti nuk mund të ndiqet penalisht pa autorizimin e Kuvendit. Autorizimi kërkohet edhe në rastin kur ai do të arrestohet.

3. Deputeti mund të ndalohet ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Në këto raste, Prokurori i Përgjithshëm njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës.

4. Për rastet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Kuvendi vendos me votim të fshehtë.

---

**VGJK 39/2000:** Për çështjet e parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, kërkesa për marrjen e autorizimit për ndjekjen penale të personave që gëzojnë imunitet, i drejtohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nga vetë gjykata pranë së cilës është depozituar kërkesa e të dëmtuarit akuzues... kur subjekt i këtyre veprave janë persona që në bazë të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë imunitet penal. Ndjekja penale kundër tyre nuk mund të fillojë pa autorizimin e organeve shtetërore kompetente, siç mund të jetë Kuvendi, për deputetët, ministrat dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese, për anëtarët e saj dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për gjyqtarët e rretheve dhe të apeleve. Në këto raste, kërkesën pranë këtyre organeve për marrjen e autorizimit ka të drejtë ta bëjë vetëm gjykata, pa pasur nevojë për ndihmën ose ndërhyrjen e prokurorit. Sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, prokurori është i përjashtuar nga pjesëmarrja e fazës së hetimit paraprak të këtyre çështjeve. Këto vihen në lëvizje vetëm mbi kërkesën e të dëmtuarit akuzues dhe çdo veprim procedural që ka lidhje me këtë fazë, kryhet nga vetë gjykata. Veç kësaj, edhe gjatë gjykimit të këtyre çështjeve, pozita procedurale e prokurorit është e një lloji të veçantë. Ai nuk është palë në debatin gjyqësor, që zhvillohet vetëm midis të pandehurit dhe të dëmtuarit akuzues. Pra, për këtë kategori veprash penale, ai është përjashtuar me ligj nga roli i tij si përfaqësues i akuzës dhe si autoritet që ushtron ndjekjen penale. Për interpretimin e nenit 73/2 të Kushtetutës, del me këtë konkluzion: Gjykata e zakonshme, është i vetmi organ procedues për veprat penale që ndiqen mbi kërkesën e të dëmtuarit akuzues. Për këtë shkak, ajo ka të drejtë dhe është e detyruar me ligj t'i drejtohet drejtpërsëdrejti, pa ndërmjetësimin e prokurorit, të gjitha organeve kompetente, duke përfshirë edhe Kuvendin dhe t'iu kërkojë atyre sipas përkatësisë, autorizimin për ndjekjen penale të personave që gëzojnë imunitet, vetëm në rastet kur i dëmtuari akuzues, në bazë të neneve 59 e 284/5 të Kodit të Procedurës Penale, ushtron kërkesë për procedim.

### KREU III

#### ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

##### Neni 74

1. Kuvendi i zhvillon punimet vjetore në dy sesione. Sesioni i parë fillon të hënën e tretë të janarit dhe sesioni i dytë të hënën e parë të shtatorit.

2. Kuvendi mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm, kur kërkohet nga Presidenti i Republikës, nga Kryeministri ose nga një e pesta e të gjithë deputetëve.

3. Sesionet e jashtëzakonshme thirren nga Kryetari i Kuvendit në bazë të një rendi dite të përcaktuar.

##### Neni 75

1. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet.



2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullore së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.

---

**VGJK 35/2007:** Nga kjo dispozitë rezulton se Rregullorja e Kuvendit është një akt juridik që ka si qëllim të vendosë rregulla mbi veprimtarinë dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit. Mosrespektimi i saj e bën ligjin antikushtetues, vetëm nëse janë prekur dispozita të nivelit kushtetues, që gjejnë pasqyrim në të. Për çështje të tjera Rregullorja e Kuvendit nuk mund të jetë objekt kontrolli kushtetues... Rrjedhimisht, vetëm mosrespektimi nga Kuvendi i këtyre përcaktimeve kushtetuese i jep të drejtë subjektit të interesuar të parashtrijë kërkesë para Gjykatës Kushtetuese për antikushtetueshmëri të ligjit për shkak të formës. ...

---

#### Neni 76

1. Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe përfaqëson Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët.
2. Nëpunësi më i lartë civil i Kuvendit është sekretari i përgjithshëm.
3. Shërbimet e tjera të nevojshme për funksionimin e Kuvendit kryhen nga nëpunës të tjerë, siç përcaktohet në rregulloren e brendshme.

#### Neni 77

1. Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme.
2. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore.
3. Komisionet e hetimit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.

---

**VGJK 18/2003:** ...“Interpretimin e nenit 77 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në këtë mënyrë:  
1. Komisionet hetimore janë mjet efektiv kontrolli që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit, të cilat ngrihen për çështje të veçantam, të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit;  
2. Ngritja e komisioneve hetimore parlamentare, kur kërkohet nga një e katërta e deputetëve, është e detyrueshme. Objekti dhe fusha e veprimit të komisioneve hetimore, duhet të respektojë parimet kushtetuese dhe normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, duke mos cënuar pavarësinë dhe duke mos penguar veprimtarinë e organeve të pushteteve të tjera;  
3. Parimet kushtetuese, veçanërisht, parimi i ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve, i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, i prezumimit të pafajësisë, i paanshmërisë, i respektimit të jetës private të individit, përbëjnë standarte kushtetuese mbi të cilat ngrihen dhe funksionojnë komisionet hetimore parlamentare;  
4. Çështjet e veçanta që përbëjnë thelbin e objektit të veprimtarisë së komisioneve hetimore parlamentare, të cilat e përmbajnë në vetvete interesin publik, janë ato që hetohen në aspektin e kontrollit e të zbatimit të ligjeve, të njohjes e verifikimit në thellësi të një fenomeni, ngjarjeje, a veprimtarie dhe që nxisin iniciativat për propozime, amendime apo miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë e shtetin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale”.

...Sigurisht që të gjitha **parimet kushtetuese** janë të rëndësishme për t'u patur parasysh dhe për t'u respektuar gjatë ngritjes dhe ushtrimit të veprimtarisë së komisioneve hetimore parlamentare, por Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme të evidentojë se një ndër parimet kushtetuese thelbësore, që merr rëndësi esenciale dhe që lidhet me garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor është parimi i prezumimit të pafajësisë. Ky parim është pranuar se mund të çënohet jo vetëm nga gjyqtarë apo gjykata, por edhe nga autoritetet publike. Interpretimi i zgjeruar edhe tej procesit penal ofruar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut merr një rëndësi të veçantë edhe përse i përket garantimit të të drejtave të parashikuara në Konventë në mënyrë praktike dhe efektive, jashtë kontekstit teorik apo iluziv . Ky parim mishërohet edhe në lidhje me zbatimin e nenit 6, paragrafi 2 të Konventës Evropiane. Gjatë aktivitetit hetimor, komisionet parlamentare ushtrojnë edhe kompetenca gjyqësore apo quasi gjyqësore. Ato janë të pajisura nga

ligji me pushtete të njëjta me ato të organeve të hetimit e të gjyqimit. Në këtë kuptim, komisionet hetimore duhet të garantojnë plotësisht këtë parim, duke mos e trajtuar a priori të interesuarin për çështjen në fjalë si fajtor.

...**Interpretimin e shprehjes çështje e veçantë**, Gjykata Kushtetuese e realizon brenda konceptit të funksionit të kontrollit parlamentar dhe të së drejtës së pakicës për të përdorur këtë instrument të rëndësishëm sipas parimeve kushtetuese. Objekti i hetimit, i argumentuar qartë dhe në mënyrë të mjaftueshme në kërkesë, duhet të përmbajë fakte të përcaktueshme ose kompleks faktesh, të cilat të tregojnë qartë se për çfarë po hetohet. Në këtë mënyrë, objekti i hetimit evidenton dhe çështjen e veçantë. Të gjitha ato çështje që përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe që përmbajnë në vetvete një interes publik e përfshijnë këtë kuptim. Dobishmëria e këtyre hetimeve sigurisht që shihet në nxjerrjen e përgjegjësive politike e institucionale, që ndihmon evidentimin e problemeve dhe mospërsëritjen e fenomeneve që kanë ndikim për vetë shoqërinë, por jo çdo çështje publike mund të sqarohet më së miri nga parlamenti dhe të përfshihet në objektin e hetimit.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se dhënia e kuptimit të saktë të shprehjes **çështje e veçantë** nuk mund të realizohet në mënyrë të plotë në vendimet abstrakte të interpretimit kushtetues. Gjithësesi, lista e çështjeve me interes publik nuk mund të jetë kurrsesi shterruese, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në vartësi të situatave të ndryshme që krijohen. Çështjet e hetimit të trajtuara në aspektin e verifikimit të zbatueshmërisë së legjislacionit, të formulimit të propozimeve apo iniciativave ligjore që kanë për qëllim frenimin dhe parandalimin e fenomeneve negative për shoqërinë e shtetin janë të përfshira në konceptin kushtetues si çështje e veçantë.

**VGJK 26/2006:** Gjykata Kushtetuese, ka theksuar se hetimi parlamentar nuk mund të jetë absolutisht i pakufizuar. Ky kufizim imponon, që objekti i hetimit të respektojë parimet kushtetuese, që hetimi parlamentar të lidhet me veprimtarinë e legjislativit dhe që hetimi të mos përdoret në mënyrë abuzive.

## Neni 78

1. Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.
2. Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.

## Neni 79

1. Mbledhjet e Kuvendit bëhen të hapura.
2. Me kërkesën e Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të një së pestës së deputetëve mbledhjet e Kuvendit mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar shumica e të gjithë anëtarëve të tij.

## Neni 80

1. Kryeministri dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave është i detyruar t'u përgjigjet interpelancave dhe pyetjeve të deputetëve brenda tri javëve.
2. Anëtari i Këshillit të Ministrave ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit ose të komisioneve të tij; atij i jepet fjala sa herë që e kërkon.
3. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për sa e lejon ligji.

## KREU IV

### PROCESI LIGJVËNËS

## Neni 81

1. Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.

2. Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:

a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta;

b) ligji për shtetësinë;

c) ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore;

ç) ligji për referendumet;

d) kodet;

dh) ligji për gjendjen e jashtëzakonshme;

e) ligji për statusin e funksionarëve publikë;

ë) ligji për amnistinë;

f) ligji për ndarjen administrative të Republikës.

## Neni 82

1. Propozimi i ligjeve, kur është rasti, duhet të shoqërohet kurdoherë me raportin që për ligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij.

2. Asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose që pakëson të ardhurat, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së projektligjit.

3. Në qoftë se Këshilli i Ministrave nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, projektligji kalon për shqyrtim sipas procedurës së zakonshme.

## Neni 83

1. Projektligji votohet tri herë: në parim, nen për nen dhe në tërësi.

2. Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit.

3. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81 paragrafi 2, me përjashtim të nënparagrafit dh.

## Neni 84

1. Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

2. Ligji quhet i shpallur, në qoftë se Presidenti i Republikës nuk ushtron të drejtat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe në paragrafin 1 të nenit 85.

3. Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.

4. Në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Ligji duhet të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

#### Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

### PJESA E KATËRT

#### PRESIDENTI I REPUBLIKËS

#### Neni 86

1. Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit.
2. President mund të zgjidhet vetëm shtetasi shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetët e fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeç.

#### Neni 87

1. Kandidati për President i propozohet Kuvendit nga një grup prej jo më pak se 20 deputetësh. Një deputet nuk lejohet të marrë pjesë në më shumë se një grup propozues.
2. Presidenti i Republikës zgjidhet me votim të fshehtë dhe pa debat nga Kuvendi me një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij.
3. Kur në votimin e parë nuk arrihet kjo shumicë, brenda 7 ditëve nga kryerja e votimit të parë bëhet një votim i dytë.
4. Në rast se edhe në votimin e dytë nuk arrihet kjo shumicë, brenda 7 ditëve bëhet një votim i tretë.
5. Kur ka më shumë se dy kandidatë dhe asnjëri prej tyre nuk ka marrë shumicën e kërkuar, brenda 7 ditëve bëhet një votim i katërt ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave.
6. Në rast se edhe në votimin e katërt asnjëri prej dy kandidatëve nuk ka marrë shumicën e kërkuar, bëhet një votim i pestë.
7. Në rast se edhe pas votimit të pestë asnjëri prej dy kandidatëve nuk ka marrë shumicën e kërkuar, Kuvendi shpërndahet dhe brenda 60 ditëve bëhen zgjedhjet e reja të përgjithshme.
8. Kuvendi i ri zgjedh Presidentin sipas procedurës së parashikuar nga paragrafët 1 deri në 7 të këtij neni. Në rast se edhe Kuvendi i ri nuk e zgjedh Presidentin, ai shpërndahet dhe brenda 60 ditëve bëhen zgjedhjet e reja të përgjithshme.
9. Kuvendi pasardhës zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.

## Neni 88

1. Presidenti i Republikës, në çdo rast, zgjidhet për 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Procedura për zgjedhjen e Presidentit fillon jo më vonë se 30 ditë para mbarimit të mandatit presidencial paraardhës.

3. Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit, por jo më parë se të ketë mbaruar mandati i Presidentit që largohet. Presidenti bën këtë betim:

“Beto hem se do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t’i shërbej interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar.” Presidenti mund të shtojë edhe: “Zoti më ndihmoftë!”

4. Presidenti që jep dorëheqjen para mbarimit të mandatit të vet, nuk mund të kandidojë në zgjedhjen presidenciale që bëhet pas dorëheqjes së tij.

## Neni 89

Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private.

## Neni 90

1. Presidenti i Republikës nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij.

2. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Propozimi për shkarkimin e Presidentit në këto raste mund të bëhet nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij.

3. Vendimi i Kuvendit i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, e cila, kur vërteton fajësinë e Presidentit të Republikës, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.

## Neni 91

1. Kur Presidenti i Republikës është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit zë vendin dhe ushtron kompetencat e tij.

2. Në rast se Presidenti nuk mund të ushtrojë detyrën për më shumë se 60 ditë, Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve, vendos dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila vërteton përfundimisht faktin e pamundësisë. Në rast të vërtetimit të pamundësisë, vendi i Presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e Presidentit të ri fillon brenda 10 ditëve nga dita e vërtetimit të pamundësisë.

## Neni 92

Presidenti ushtron edhe këto kompetenca:

- a) i drejton mesazhe Kuvendit;
- b) ushtron të drejtën e faljes sipas ligjit;
- c) jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit;
- ç) jep dekorata e tituj nderi sipas ligjit;
- d) jep gradat më të larta ushtarake sipas ligjit;
- dh) me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare;
- e) pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë;
- ë) lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit;
- f) me propozim të Kryeministrit, emëron drejtorin e shërbimit informativ të shtetit;
- g) emëron Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e universiteteve sipas ligjit;
- gj) cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve;
- h) kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre.

#### Neni 93

Presidenti i Republikës, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr dekrete.

#### Neni 94

Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të.

### PJESA E PESTË

#### KËSHILLI I MINISTRAVE

#### Neni 95

1. Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat.

2. Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore.

#### Neni 96

1. Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend.

2. Në qoftë se Kryeministri i emëruar nuk miratohet nga Kuvendi, Presidenti emëron një Kryeministër të ri brenda 10 ditëve.

3. Në qoftë se edhe Kryeministri i emëruar rishtas nuk miratohet nga Kuvendi, brenda 10 ditëve Kuvendi zgjedh një Kryeministër tjetër. Në këtë rast Presidenti emëron Kryeministrin e ri.

4. Kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin.

---

**VGJK 28/2002:** Neni 96 i Kushtetutës, në pamje të parë, krijon përshtypjen sikur ka të bëjë ekskluzivisht me Kryeministrin dhe se mosmiratimi i tij, si subjekt i veçantë nga Kuvendi, shkakton krizë qeveritare apo parlamentare. T'i japësh një kuptim të tillë dispozitës kushtetuese do të thotë të pranosh se mosmiratimi nga Kuvendi i programit politik dhe i përbërjes së Këshillit të Ministrave, sipas nenit 97 të Kushtetutës, nuk sjell asnjë pasojë juridike kushtetuese, dhe se besimin politik Kuvendi ia jep Kryeministrit, thjesht për cilësitë e tij personale dhe jo për alternativën dhe për programin që propozon apo për përbërjen e ekipit që do të përmbushë këtë program. Natyrisht, një kuptim i tillë i nenit 96 të Kushtetutës e ka bazën tek interpretimi jo i saktë që i bëhet kësaj dispozite. Për interpretimin e saktë dhe përfundimtar të neneve 96 e 97 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se përmbajtja e këtyre dispozitave duhet parë në kontekstin e të gjithë neneve që parashikohen në Pjesën e Pestë të Kushtetutës, si dhe të dispozitave të tjera të saj, të analizuara këto edhe mbi bazën e koncepteve doktrinare të së drejtës kushtetuese shqiptare dhe asaj të huaj. Në të njëjtën kohë, për të interpretuar drejt dispozitat e përmendura më lart, nuk mund të mos mbahen parasysh edhe çështje të tjera me rëndësi të veçantë, siç janë pozicioni i ekzekutivit në një Republikë Parlamentare, roli i Kryeministrit dhe i Këshillit të Ministrave e të raporteve midis tyre, rolin e veçantë të Kuvendit për formimin e organeve sidomos të Kryeministrit e të Këshillit të Ministrave, pa mënjnuar natyrisht në këtë proces interpretimin, analizën e këtyre dispozitave jo vetëm në aspektin gramatikor, por në të gjithë aspektet që bëjnë të mundur një shpjegim korrekt e të saktë të përmbajtjes së tyre.

---

## Neni 97

Kryeministri i emëruar sipas nenit 96, nenit 104 ose 105, i paraqet për miratim Kuvendit, brenda 10 ditëve, programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij.

---

**VGJK 28/2002:** Kryeministri i emëruar nga Presidenti i Republikës miratohet në Kuvend njëherësh me programin politik dhe me përbërjen e Këshillit të Ministrave.... Kryeministri është pika qendrore e ekzekutivit nga pikëpamja e përgjegjësisë politike kundrejt Kuvendit. Nisur nga ky këndvështrim, Kushtetuta parashikon procedura të përpikta e të shpejta për emërimin e miratimin e Kryeministrit e të Këshillit të Ministrave, duke u kushtëzuar kjo me shpërndarjen e Kuvendit në rast mosmiratimi. Për Kuvendin që ushtron detyra të rëndësishme për formimin dhe kontrollin e Këshillit të Ministrave, rëndësi primare merr programi politik dhe përbërja e Këshillit të Ministrave. Prandaj, në kuptim të neneve 96 e 97 të Kushtetutës, Kuvendi i jep votëbesimin Këshillit të Ministrave jo vetëm për shkak të cilësive të Kryeministrit, por, në radhë të parë, nga programi politik dhe përbërja e Këshillit të Ministrave, të cilin ai do kryesojë e përfaqësojë. Kështu që, marrja në shqyrtim dhe miratimi i Kryeministrit siç përmend neni 96 i Kushtetutës, nuk mund të kuptohen të ndarë nga programi politik i Këshillit të Ministrave dhe nga përbërja e tij. Ky argument del edhe nga përmbajtja e neneve 96 e 97 të Kushtetutës dhe të çon në konkluzionin se miratimi i Kryeministrit nuk është i ndarë në kohë me miratimin e programit dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave. Nenet 96, 97, 104 e 105 të Kushtetutës përcaktojnë që Presidenti emëron Kryeministrin. Kjo do të thotë, që, në çdo rast, përfshirë edhe rastin e zgjedhjes së Kryeministrit nga Kuvendi (neni 96 paragrafi 3, neni 104 e 105 paragrafi 1 i Kushtetutës), emërimi i Kryeministrit është kompetencë e Presidentit. Mirëpo, Kryeministri i emëruar nga Presidenti ende nuk fiton si organ cilësitë juridike për të marrë përsipër përgjegjësi politike për veprimtarinë e tij dhe të Këshillit të Ministrave derisa nuk është miratuar nga Kuvendi. Në dallim nga ligji nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Kushtetuta, edhe pse e koncepton Kryeministrin si subjekt të veçantë që mbart të drejta e detyrime të rëndësishme kushtetuese e ligjore, përcakton përgjegjësinë e tij politike të lidhur ngushtë me veprimtarinë e Këshillit të Ministrave. Është kjo arsyeja që mocioni i mosbesimit, sipas nenit 105/1 të Kushtetutës, paraqitet vetëm ndaj Kryeministrit edhe pse objekt mund të jetë vetëm veprimtaria e tij si subjekt i Këshillit të Ministrave që ai drejton, pa përjashtuar edhe atë të ministrave të veçantë. Për pasojë, pranimi i mocionit shkakton shkarkimin e Këshillit të Ministrave në tërësi. Neni 97 i Kushtetutës parashikon detyrimin e Kryeministrit të emëruar nga Presidenti që brenda 10 ditëve të paraqesë për miratim programin politik të Këshillit të Ministrave, së bashku me përbërjen e tij. Qëllimi i kësaj dispozite është që Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave që ky do ta drejtojë, t'ia nënshtrojnë kontrollit parlamentar programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, përfshirë edhe Kryeministrin (neni 95/1 të Kushtetutës), si kusht

për dhënien e besimit politik. Por, ky detyrim i parashikuar në nenin 97 të Kushtetutës, kurrsesi, nuk duhet kuptuar si një veprim që realizohet pas miratimit të Kryeministrit të emëruar sipas nenit 96 të Kushtetutës. Nëse Kushtetuta do të kishte këtë qëllim, nuk do të shprehej në nenin 97 të saj se “Kryeministri i emëruar sipas nenit 96...”, por do të përdorte termin “Kryeministri i miratuar sipas nenit 96...”, që janë dy gjëra krejt të ndryshme. Duke pasur cilësinë e një Kryeministri të emëruar por të pamiratuar, ai i drejtohet Kuvendit me qëllim përmbushjen e detyrimit kushtetues që buron nga neni 97 i Kushtetutës. Ky kuptim, që rezulton nga përmbajtja e neneve 96 e 97 të Kushtetutës të çon në konkluzionin se Kryeministri i emëruar por i pamiratuar i paraqitet Kuvendit për miratim, së bashku me programin politik, dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave. Nisur nga argumentet e parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin përfundimtar se Kryeministri i emëruar duhet të paraqitet në Kuvend për t’u miratuar njëherësh me programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave.

---

## Neni 98

1. Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve.
2. Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi.

---

**VGJK 6/2002:** Interpretimin e pikës 2 të nenit 98 të Kushtetutës në këtë mënyrë: -Nëse dekreti i Presidentit të Republikës, i nxjerrë në përputhje me nenin 98 të Kushtetutës, nuk shqyrtohet nga Kuvendi brenda afatit 10 ditor, ai nuk konsiderohet i miratuar apo i shfuqizuar. - Kuvendi duhet ta shqyrtojë dekretin pas këtij afati. - Në rastin kur Kuvendi nuk shqyrton brenda afatit 10 ditor dekretin e Presidentit të Republikës, të nxjerrë në përputhje me nenin 98 të Kushtetutës, Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, veç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të.... Me fjalën “shqyrtim”, sipas nenit 98 pika 2 të Kushtetutës, kuptohet e drejta dhe detyrimi i Kuvendit për të bërë objekt diskutimi e debati dekretin e Presidentit dhe për të marrë një vendim të caktuar për miratimin ose mosmiratimin e tij. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës, i nxjerrë në përputhje me pikën 2 të nenit 98 të Kushtetutës, nuk kufizohet vetëm në kontrollin formal të tij, por dhe në atë substancial, sepse ai është akt i një kontrolli politik të ngjashëm me atë që ushtrohet në kuadrin e një mocioni besimi apo mosbesimi. Në rrethanat kur Kuvendi nuk e shqyrton dekretin brenda afatit 10 ditor, mospërmbushja e kësaj detyre nuk mund të konsiderohet as si rrëzim e as si pranim i tij. Heshjtja nuk konsiderohet si rrëzim, pasi mosshqyrtimi nënkupton sa qëndrimin indiferent ndaj tij, aq edhe pamundësinë për të marrë, si numrin e nevojshëm të votave “pro”, ashtu edhe të votave “kundër” tij. Veç kësaj, mosshqyrtimi, megjithëse mund të mbartë në vetvete një mesazh politik, prapë nuk mund të konsiderohet si pranim i tij përse nuk është përmbushur njëra nga alternativat që rrjedhin nga shqyrtimi i tij, miratimi ose mosmiratimi i dekretit. Edhe nëse ndodhemi para një mosushtrimi të kësaj të drejte, ky qëndrim nuk mund të anulohet procesin kushtetues për emërimin e një ministri, sepse raportet ndërmjet Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave janë raporte kontrolli e besimi, pasi pa besim të Kuvendit nuk mund të formohet as qeveria e as të miratohet emërimi i ministrave të veçantë. Pas besimit të marrë, mosshqyrtimi i dekretit të Presidentit për ministra të veçantë nuk pajtohet me konceptin e prezumimit të besimit që gëzon Këshilli i Ministrave, përse kohë nuk votohet një mosbesim kundër Kryeministrit. Kuvendi e kontrollon Qeverinë dhe aktin e Presidentit me mjete demokratike. Ka praktika të parlamentarizimit të njohura me qëndrime aktive, por jo me heshjtje. Duke mos shqyrtuar dekretet e Presidentit, pra duke mos ushtruar Kuvendi të drejtën dhe detyrën e tij, krijohet një precedent i rrezikshëm për funksionimin e shtetit dhe qeverisjen e vendit.

---

## Neni 99

Para fillimit të detyrës, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat betohen para Presidentit të Republikës.

---

## Neni 100

1. Këshilli i Ministrave përcakton drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore.
2. Këshilli i Ministrave merr vendime me propozim të Kryeministrit ose të ministrit përkatës.
3. Mbledhjet e Këshillit të Ministrave bëhen të mbyllura.



4. Aktet e Këshillit të Ministrave janë të vlefshme, kur nënshkruhen nga Kryeministri dhe ministri propozues.

5. Këshilli i Ministrave nxjerr vendime dhe udhëzime.

## Neni 101

Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

---

**VGJK 24/2006:** Gjykata Kushtetuese vlerëson ... kuptimin e elementeve të mëposhtëm: 1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit; 2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit; 3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre; 4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

I. Për shqyrtimin e kësaj çështjeje, duhet të marrin përgjigje një sërë pyetjesh që lidhen me kuptimin kushtetues të termave *nevojë* dhe *urgjencë*, me domosdoshmërinë e pranisë së këtyre dy elementeve, me pasojat që mund t'i vijnë aktit normativ për shkak të mosekzistencës së tyre, me organet që kanë të drejtën për të verifikuar nevojën dhe urgjencën konkrete, të cilat kanë shërbyer si bazë për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit. Gjykata Kushtetuese çmon se *nevoja* dhe *urgjenca*, janë elementë me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe si të tillë, janë elementë përcaktues për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Kuptimi i tyre është autonom, i lidhur me tërësinë e përmbajtjes së dispozitës dhe me parimet bazë që përshkojnë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Nevoja dhe urgjenca janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ato mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm jetësorë, natyrorë e shoqërorë. Si raste të tilla përmendim: fatkeqësitë natyrore; boshllëku legjislativ i shkaktuar nga shfuqizimi i akteve; nevoja për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike; parandalimi i menjëhershëm i spekulimeve. Ajo që i bashkon të gjitha këto situata është fakti se përfaqësojnë një gjendje jo të zakonshme në jetën e vendit ku evidentohet dukshëm rreziku i ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat publike ose për të drejtat themelore të shtetasve. Ky rrezik dikton nevojën e masave të menjëhershme, por që legjislacioni ekzistues nuk i mundëson dot. Nevoja dhe urgjenca duhen kuptuar si parakushte të domosdoshme me pasojë pavlefshmërinë e aktit normativ me fuqinë e ligjit. Mungesa e tyre, shndërrohet në ves të legjitimitetit kushtetues të qeverisë për nxjerrjen e aktit normativ dhe në vijim, në ves të ligjit që e ka miratuar atë. Duke qenë kushte paraprake, nevoja dhe urgjenca duhet të jenë vërtetuar se ekzistojnë përpara momentit të marrjes të iniciativës nga qeveria për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit. Këto dy kushte duhet të jenë gjithashtu, prezente, të lidhura e të ndërvarura e në momentin kur nxirret akti normativ me fuqinë e ligjit. Nëse ekziston nevoja për nxjerrjen e një ligji, por pa ndonjë urgjencë të dukshme, qeveria nuk mund të ndërmarrë nismën për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit, pasi kjo do të përbënte një detyrë të pushtetit legjislativ. Vetëm kur situata e krijuar vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi legjislativ, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara, iniciativa ligjvënëse mund t'i kalojë qeverisë. Nëse nuk do të vlerësohej ky aspekt, qeveria do të merrte, pa të drejtë, funksionet ligjvënëse të Kuvendit. Kushtetuta, nëpërmjet nenit 101 të saj, ka lejuar që pushteti ekzekutiv të mund të miratojë akte që kanë të njëjtën fuqi si ligjet vetëm, kur rasti shfaqet si i jashtëzakonshëm dhe *nevoja e urgjenca* bëjnë të pamundur ushtrimin e kompetencës ligjvënëse nga Kuvendi. Nga ana tjetër, elementi *urgjencë* nuk mund të ekzistojë në vetvete pa *nevojën*, sepse *urgjenca* tregon vetëm një situatë që nuk mund të presë, ndërsa *nevoja* tregon substancën e saj, përcakton situatën që kërkon zgjidhje, tregon marrëdhënien shoqërore që kërkon rregullim ligjor. Prania e domosdoshme e të dy elementëve rezultojnë edhe nga analiza gjuhësore e tekstit të nenit 101 të Kushtetutës. Lidhëza “dhe” si në çdo rast, kërkon praninë e njëkohshme të të dy elementëve, në dallim nga rastet e tjera kur në dispozitën ligjore janë përdorur lidhëset “ose”/ “apo”. Kuptimin e tyre të vërtetë termat *nevojë* dhe *urgjencë* e manifestojnë në kuadër të situatës të rastit konkret, duke i vlerësuar në kohën kur është vërtetuar prania e tyre. Nga kuptimi i përmbajtjes së nenit 101 të Kushtetutës rezultojnë se vlerësimin e parë faktik dhe substancial të këtyre elementëve i përket ta bëjë, qeveria. Ajo nuk mund të ndërmarrë një nismë, për nxjerrjen e një akti normativ me fuqinë e ligjit, pa vlerësuar më parë rrethanat e krijuara që kanë shkaktuar nevojë dhe urgjencë. Natyra e vlerësimit që bën ky organ është faktik dhe juridik. Gjykata Kushtetuese vlerëson, se prania e nevojës dhe urgjencës në kushtet e nxjerrjes së një akti normativ me fuqinë e ligjit, është e lidhur me ekzistencën e vetë normës. Këtë opinion ka shprehur dhe jurisprudenca kushtetuese ndërkombëtare duke vlerësuar se ekzistenca paraprake e nevojës dhe urgjencës, përbën një kërkesë që lidhet me vlefshmërinë kushtetuese të aktit normativ që ka fuqinë e ligjit. Nga ana tjetër Gjykata Kushtetuese vlerëson se Qeveria është e detyruar të shpjegojë dhe argumentojë nevojën dhe urgjencën konkrete që e kanë detyruar të nxjerrë aktin normativ me fuqinë e ligjit. Ky detyrim ka karakter formal dhe substancial. Shpjegimin, qeveria është e detyruar ta pasqyrojë në përmbajtjen e çdo akti normativ me fuqinë e ligjit që nxjerr, minimalisht në preambulën e tij.

2. Akti normativ me fuqinë e ligjit vepron për një periudhë kohe maksimalisht 45 ditë. Përkohshmëria e kësaj norme lidhet me kushtin

e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili nëse e miraton e kthen atë në ligj. Nëse akti nuk miratohet nga Kuvendi, apo nuk merret në shqyrtim prej tij, me kalimin e periudhës 45 ditore, ai jo vetëm nuk prodhon më efekte për të ardhmen por, njëkohësisht, humbet fuqinë që nga fillimi. Ligji, si akt normativ, nuk e ka si karakteristikë të domosdoshme përkohshmërinë. Ai, pasi hyn në fuqi, bëhet pjesë konstante e korpusit të legjislacionit, me përjashtim të rasteve kur vetë Kuvendi i cakton një afat kohor fuqisë së tij. Në këtë mënyrë, ligji që miraton aktin normativ me fuqinë e ligjit, duke e zëvendësuar këtë akt pas miratimit, nuk shoqërohet me kufizim kohor të fuqisë së tij. Gjykata Kushtetuese vlerëson se shprehja “masa të përkohshme”, në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës, duhet kuptuar e lidhur vetëm me fuqinë provizore, maksimumi 45 ditëshe, të aktit normativ me fuqinë e ligjit që i përmban ato masa dhe jo me fuqinë juridike të ligjit që e ka miratuar atë.

3. Akti normativ me fuqinë e ligjit është ligj në kuptimin material të termit, por jo në kuptimin formal të tij. Ai, në thelb, rregullon marrëdhënie shoqërore të rëndësishme që meritojnë trajtim me ligj nga Kuvendi, por kur vërtetohet prania e nevojës dhe urgjencës, Kushtetuta lejon që iniciativën ligjvënëse, në këtë rast, ta kryejë Këshilli i Ministrave. Kuvendi ruan të drejtën e vlerësimit përfundimtar të këtij akti dhe, nëse e miraton atë, e kthen në ligj edhe në kuptimin formal. Gjykata Kushtetuese çmon, se fuqia juridike e aktit normativ me fuqinë e ligjit është e barabartë me fuqinë e ligjit që nga momenti i nxjerrjes së tij, sepse kjo vlerë e normës përcaktohet nga natyra e marrëdhënies juridike që gjen rregullim në të dhe jo nga organi që e ka miratuar. Fuqia juridike është element i pandashëm i përmbajtjes së normës. Hyrja në fuqi e aktit normativ me fuqinë e ligjit dallon nga hyrja në fuqi e ligjit, të cilën Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar qartë, me vendimin e saj nr.47, datë 07.07.1999. Për të interpretuar këtë aspekt të aktit normativ me fuqinë e ligjit, Gjykata Kushtetuese çmon se duhen mbajtur parasysh përmbajtja dhe specifikat e nenit 101 të Kushtetutës. Elementë të tillë, si nevoja dhe urgjenca, tregojnë se aktet në fjalë, duhet të hyjnë në fuqi menjëherë. Këta elementë, që qëndrojnë në bazë të transferimit kushtetues të së drejtës së nxjerrjes së aktit normativ me fuqinë e ligjit, nga Kuvendi drejt Këshillit të Ministrave, do të zhvendësohen në përhyrjen në fuqi të tyre, do të duhet të respektohen, detyrimisht, të gjitha afatet dhe procedurat e parashikuara nga neni 117 i Kushtetutës. Nga ana tjetër, përmbajtja e pjesës së dytë të dispozitës kushtetuese në shqyrtim, ku thuhet: “*Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, nëqoftëse nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve*”, tregon qartë se ato hyjnë në fuqi menjëherë. Me një interpretim *a contrario* të kësaj fjalie, kuptohet se aktet normative me fuqinë e ligjit duhet ta disponojnë fuqinë juridike që nga krijimi i tyre, me qëllim që të ekzistojë mundësia për ta humbur atë, po nga fillimi, kur nuk miratohen prej Kuvendit, si dhe kur kalon afati 45 ditor pa u marrë në shqyrtim prej tij. Për të gjitha arsyet e mësipërme Gjykata Kushtetuese çmon gjithashtu, se njoftimi publik i aktit normativ me fuqinë e ligjit është detyrim kushtetues për organin që e nxjerr atë. Megjithatë, bëra publike e këtyre akteve nuk ka si domosdoshmëri botimin në Fletoren Zyrtare. Këshilli i Ministrave, për këtë qëllim mund të përdorë, në funksion të kohës që ka në dispozicion, krahas botimit në Fletoren Zyrtare dhe komunikimin zyrtar me mjete të tjera të përshtatshme, njoftimin me anë të mediave, apo mjete të tjera si këto. Pavarësisht nga forma e përzgjedhur për komunikimin publik, njoftimi duhet të mbërrijë detyrimisht në adresë të subjekteve që lidhen me të drejtat e detyrimet që krijon akti normativ me fuqinë e ligjit, me qëllim, që ata të mos cenohen.

4. Lidhur me çështjen e miratimit nga Kuvendi të aktit normativ me fuqinë e ligjit, paraqet interes, sqarimi i elementëve të tillë, si forma juridike me të cilën duhet të shprehet vullneti i Kuvendit për këtë qëllim, kompetencat e këtij organi lidhur me vlerësimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit të nxjerrë nga qeveria, si dhe karakteri i shqyrtimit që ky organ i bën aktit normativ të qeverisë. Pavarësisht nga përmbajtja e vullnetit përfundimtar të Kuvendit ndaj një akti normativ me fuqinë e ligjit të nxjerrë nga qeveria, Gjykata Kushtetuese çmon, se vlerësimin e tij ky organ është i detyruar ta pasqyrojë vetëm me anë të një ligji. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit, të nxjerrë nga qeveria dhe dhënia fuqi të mëtejshme atij nuk mund të bëhet veçse, me anë të një norme që ka të njëjtat vlera, pra me ligj. Kuvendi i Shqipërisë është organi që bën vlerësimin dhe kontrollin e nevojës dhe urgjencës, sepse Kushtetuta e ka ngarkuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë për këtë qëllim. Duke përdorur termin “miraton”, dokumenti themelor i shtetit ka parasysh vlerësimin në formë dhe përmbajtje të normës dhe elementëve përbërës të saj, si dhe shprehjen e mendimit përfundimtar nga organi vlerësues lidhur me aktin që shqyrton. Natyra e këtij vlerësimi është juridike, por dhe politike. Kuvendi, nëpërmjet mazhorancës, shpreh qëndrimin e tij politik ndaj veprimit ligjvënës të qeverisë, por në të njëjtën kohë, si një organ i ngarkuar për miratimin e ligjeve, kontrollon dhe kushtetutshmërinë e akteve normative të nxjerra dhe përputhjen e tyre me dispozitat e tjera ligjore. Vlerësimi dhe kontrolli i Kuvendit mbi aktin normativ me fuqinë e ligjit bazohet në faktin se pushteti ekzekutiv, në këtë rast, ushtron përjashtimisht një funksion ligjvënës. Gjykata Kushtetuese vlerëson gjithashtu, se Kuvendi disponon tagra të plota për të zgjedhur një nga tre alternativat e mëposhtme: të marrë në shqyrtim dhe ta miratojë aktin e nxjerrë nga Këshilli i Ministrave; ta marrë në shqyrtim dhe të mos e miratojë atë; të heshtë, derisa të plotësohet afati 45 ditor, që dispozita kushtetuese i ka lënë në dispozicion për t’u shprehur lidhur me aktin. Alternativa e zgjedhur nga Kuvendi lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me perspektivën e mëtejshme të normës. Akti normativ me fuqinë e ligjit do të vazhdojë të prodhojë efekte, nëse miratohet, njësoj si gjithë ligjet e tjera, por ai do të humbasë fuqinë juridike që nga fillimi dhe do të konsiderohet se nuk ka ekzistuar kurrë nëse Kuvendi nuk e miraton, ose lejon të kalojë afati 45 ditor pa u shprehur në mënyrë përfundimtare për të. Çdo lloj ndërhyrje nga ana e Kuvendit pas kalimit të këtij afati është e pavlefshme, pasi praktikisht nuk ekziston më objekti ndaj të cilit mund të bëhet vlerësim. Në mënyrë të qartë Kushtetuta e ka përcaktuar afatin 45 ditor si një afat prekluziv që nuk mund të zgjatet për asnjë lloj arsyeje, nga asnjë autoritet. Përfundimi i këtij afati sjell pasoja të menjëhershme për aktin normativ me fuqinë e ligjit, duke e lënë atë pa fuqi që nga fillimi. Përsa i takon natyrës së shqyrtimit nga Kuvendi të aktit normativ me fuqinë e ligjit, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ai është dhe i karakterit substancial. Përpara miratimit ose mosmiratimit të normës së nxjerrë nga Këshilli i Ministrave, Kuvendi e shqyrton atë për ta vlerësuar si në formë, ashtu dhe në përmbajtje. Ai shqyrton praninë e të gjitha elementëve të përcaktuara shprehimisht për aktin normativ me fuqinë e ligjit në Kushtetutë, si dhe pajtueshmërinë e përmbajtjes së tij me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi. Gjykata Kushtetuese, përfaqëson gjithashtu, një autoritetin që ka kompetencë të vlerësojë këto akte në përgjithësi dhe nevojën e urgjencën si elementë të veçantë të tyre, por vetëm nëse një prej subjekteve të legjitimuar, i është drejtuar me kërkesë për këtë qëllim.

## Neni 102

1. Kryeministri:
  - a) përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij;
  - b) koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to;
  - c) siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave;
  - ç) bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës qendrore të shtetit;
  - d) kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë e në ligje.
2. Kryeministri zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave.
3. Kryeministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra.
4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

## Neni 103

1. Ministër mund të caktohet kushdo që ka cilësitë për deputet.
2. Ministri nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore dhe as të jetë drejtues ose anëtar i organeve të shoqërive fitimprurëse.
3. Anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit.

---

**VGJK 38/2000:** Për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj anëtarit të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është i zgjedhur deputet, do të zbatohet e njëjta procedurë që parashikohet edhe për deputetin. Në disa dispozita të Kushtetutës jepet vetëm e drejta e gëzimit të imunitetit për një pjesë të funksionarëve të lartë të shtetit, por nuk parashikohet procedura që duhet ndjekur për heqjen e imunitetit. Janë ligjet përkatëse ato që parashikojnë dhe rregullojnë në mënyrë më të hollësishme këtë moment juridik. Rregulli i referimit të gëzimit të imunitetit për një pjesë funksionarësh të lartë është parashikuar në disa dispozita të Kushtetutës si në nenin 61/3, 154/5 dhe 165/2 të saj. Nga e njëjta referencë ligjore nuk bën përjashtim as anëtar i Këshillit të Ministrave, i cili sipas nenit 103/3 gëzon imunitetin e deputetit. Meqenëse vetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e barazon në aspektin substancial gëzimin e imunitetit të anëtarit të Këshillit të Ministrave me imunitetin e deputetit, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se edhe procedura që ndiqet për heqjen e imunitetit të deputetit, e parashikuar në nenin 73 të saj dhe në nenin 173 e vijues të Rregullores së Kuvendit do të jetë e zbatueshme dhe për anëtarin e Këshillit të Ministrave që nuk është deputet. Në kuptim dhe zbatim të dispozitave të sipërcituara Gjykata Kushtetuese konkludon, se dhënia e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale për anëtarin e Këshillit të Ministrave që nuk është i zgjedhur deputet, do të bëhet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë sipas procedurës ligjore që parashikohet edhe për heqjen e imunitetit të deputetit.

## Neni 104

1. Në rast se mocioni i besimit i paraqitur nga Kryeministri refuzohet nga shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi, brenda 15 ditëve, zgjedh një Kryeministër tjetër. Në këtë rast Presidenti emëron Kryeministrin e ri.
2. Kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin.
3. Votimi i mocionit nuk mund të bëhet pa kaluar 3 ditë nga paraqitja e tij.

#### Neni 105

1. Në rast se mocioni i mosbesimit i paraqitur nga një e pesta e deputëteve miratohet nga shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi, brenda 15 ditëve, zgjedh një Kryeministër tjetër. Në këtë rast Presidenti emëron Kryeministrin e ri.
2. Kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin.
3. Votimi i mocionit nuk mund të bëhet pa kaluar 3 ditë nga paraqitja e tij.

#### Neni 106

Kryeministri dhe ministrat janë të detyruar të qëndrojnë në detyrë deri në formimin e Këshillit të Ministrave pasardhës.

#### Neni 107

1. Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit.
2. Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.
3. Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj.

### PJESA E GJASHTË

#### QEVERISJA VENDORE

#### Neni 108

1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.
2. Ndarjet administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë me parë mendimi i popullsisë që banon në to.
3. Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisese, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore.
4. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2.

#### Neni 109

1. Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilët zgjidhen çdo tre vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

2. Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendorë dhe si kryetar bashkie ose komune e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse.

4. Organet e njësive të qeverisjes vendore kanë të drejtë të formojnë bashkime dhe institucione të përbashkëta me njëri-tjetrin për përfaqësimin e interesave të tyre, të bashkëpunojnë me njësitë vendore të vendeve të tjera, si dhe të përfaqësohen në organizatat ndërkombëtare të pushteteve vendore.

#### Neni 110

1. Qarku përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale, ekonomike e sociale dhe të interesave të përbashkët.

2. Qarku është njësia ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore.

3. Organi përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Bashkitë dhe komunat delegojnë anëtarë në këshillin e qarkut në përpjesëtim me popullsinë e tyre, por për çdo rast të paktën një anëtar. Kryetarët e komunave dhe të bashkive janë kurdoherë anëtarë të këshillit të qarkut. Anëtarët e tjerë të tij zgjidhen me lista përpjesëtimore ndër këshilltarët bashkiakë ose komunalë nga këshillat përkatës.

4. Këshilli i qarkut ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime me fuqi detyruese të përgjithshme për qarkun.

#### Neni 111

1. Njësitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë.

2. Njësitë e qeverisjes vendore kanë buxhet të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj.

#### Neni 112

1. Njësive të qeverisjes vendore mund t'u delegohen me ligj kompetenca të administratës shtetërore. Shpenzimet që kryhen për ushtrimin e delegimit, përballohen nga shteti.

2. Organeve të qeverisjes vendore mund t'u vihen detyrime vetëm në përputhje me ligjin ose sipas marrëveshjeve që ato lidhin. Shpenzimet që lidhen me detyrimet që u vihen me ligj organeve të qeverisjes vendore përballohen nga buxheti i shtetit.

#### Neni 113

1. Këshillat komunalë, bashkiakë dhe të qarkut:
  - a) rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre;
  - b) ushtrojnë të drejtat e pronës, administrojnë në mënyrë të pavarur të ardhurat e krijuara, si dhe kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtari ekonomike;
  - c) kanë të drejtë të mbledhin dhe të shpenzojnë të ardhurat që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre;
  - ç) kanë të drejtë të vendosin, në përputhje me ligjin, taksa vendore, si dhe nivelin e tyre;
  - d) caktojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre në pajtim me ligjin;
  - dh) krijojnë simbolet e qeverisjes vendore, si dhe titujt vendorë të nderit;
  - e) ndërmarrin nisma për çështje vendore përpara organeve të caktuara me ligj.
2. Organet e njësisë të qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra.
3. Të drejtat për vetëqeverisje të njësisë të qeverisjes vendore mbrohen në gjykatë.

Neni 114

Këshilli i Ministrave cakton prefektin si përfaqësues të tij në çdo qark. Kompetencat e prefektit caktohen me ligj.

Neni 115

1. Organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.
2. Organi i shpërndarë ose i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve, dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet.
3. Në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse.

## PJESA E SHTATË

### AKTET NORMATIVE DHE MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

#### KREU I

#### AKTET NORMATIVE

Neni 116

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:
  - a) Kushtetuta;

- b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- c) ligjet;
- ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.

---

**VGJK 6/2006:** Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore përfshirë këtu dhe gjykatat e çdo niveli si dhe organet që zbatojnë vendimet e tyre. Garancitë e Konventës ndikojnë në interpretimin dhe mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të individit të shprehura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Veç kësaj, Gjykata Kushtetuese çmon se teksti i Konventës dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut shërbejnë për të bërë interpretimin kushtetues dhe për të përcaktuar, rast pas rasti, kufijtë e të drejtave themelore kushtetuese. Ky pozicion i Konventës, vjen si pasojë e angazhimeve të Shtetit Shqiptar për t'i dhënë një mbrojtje të garantuar të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Aspekt tjetër me rëndësi ka të bëjë me detyrimet që rrjedhin nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, për palët që marrin pjesë në gjykim, sepse sipas nenit 41 të Konventës, palët kontraktuese, me ratifikimin e Konventës, janë të detyruara të garantojnë përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me Konventën. Veç kësaj, praktika e kësaj Gjykate paraqet rëndësi për vlerat orientuese të jurisprudencës të saj edhe për gjykatat shqiptare. Pra, ky problem ka mbetur për t'u vlerësuar rast pas rasti nga gjykatat që gjykojnë në shkallë të parë dhe nga ato që gjykojnë në shkallë të dytë, pa harruar se objekt i këtij vlerësimi, sipas Gjykatës së Strasburgut, duhet të jetë tërësia e procesit, së bashku me fazën e hetimeve dhe me shkallën e apelit, me procesin eventual para Gjykatës Kushtetuese, si dhe me ekzekutimin e vendimit. Përsa u parashtrua, duke u bazuar në këto standarde kushtetuese, kërkesa e kërkuarit me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm, duhet pranuar edhe për një shkak tjetër, sepse moszbatimi i një vendimi të tillë cenon të drejtën e individit për t'u drejtuar gjykatës.

---

#### Neni 117

1. Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.

2. Shpallja dhe botimi i akteve të tjera normative bëhet sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

3. Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Shpallja dhe botimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare bëhet sipas ligjit.

#### Neni 118

1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.

2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.

#### Neni 119

1. Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrive e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre.

2. Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera.

3. Rregulloret dhe urdhrat nxirren në bazë dhe për zbatim të akteve që kanë fuqi juridike të përgjithshme.

#### Neni 120

Parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj.

### KREU II

## MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

#### Neni 121

1. Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet kur ato kanë të bëjnë me:

a) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;  
b) të drejtat dhe liritë e njeriut, si edhe detyrimet e shtetasve, siç parashikohen në Kushtetutë;

c) anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare;

ç) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë;

d) miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve.

2. Kuvendi, me shumicën e të gjithë anëtarëve, mund të ratifikojë edhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare që nuk parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kryeministri e njofton Kuvendin sa herë që Këshilli i Ministrave nënshkruan një marrëveshje ndërkombëtare që nuk ratifikohet me ligj.

4. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe denoncimin e marrëveshjeve ndërkombëtare parashikohen me ligj.

#### Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.



3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

#### Neni 123

1. Republika e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, u delegon organizatave ndërkombëtare kompetenca shtetërore për çështje të caktuara.

2. Ligji me të cilin ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare, siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

3. Kuvendi mund të vendosë që ratifikimi i një marrëveshjeje të tillë të bëhet me referendum.

### PJESA E TETË

#### GJYKATA KUSHTETUESE

#### Neni 124

1. Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.

2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.

#### Neni 125

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.

2. Gjyqtarët emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi, nga radhët e juristëve me kualifikim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion.

3. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo tre vjet në një të tretën e saj sipas procedurës së caktuar me ligj.

4. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emërohet nga radhët e anëtarëve të saj nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit, për një periudhë prej 3 vjetësh.

5. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij.

---

**VGJK 2/2005:** Kuvendi i Shqipërisë në rastet e shqyrtimit të dekreteve të Presidentit të Republikës për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ka kompetencë të shqyrtojë jo vetëm përmbushjen e kritereve formale, por të shqyrtojë edhe *meritën* e emërimit të tyre. Për rrjedhojë, Kuvendi i Shqipërisë ka kompetencë të japë ose jo pëlqimin për emërimet e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

---

#### Neni 126

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ndiqet penalisht pa pëlqimin e Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të ndalohet ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

#### Neni 127

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur:
  - a) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
  - b) nuk paraqitet pa arsye në detyrë për më shumë se 6 muaj;
  - c) mbush moshën 70 vjeç;
  - ç) jep dorëheqjen;
  - d) me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i paaftë për të vepruar.
2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese.
3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, Presidenti i Republikës emëron, me pëlqimin e Kuvendit, një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.

#### Neni 128

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila, kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin nga detyra të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

---

**VGJK 3/2006:** ... për interpretimin... konkretisht i shprehjes “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë figurën”. Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se kjo shprehje, përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilët mund të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Më tej, Gjykata Kushtetuese vazhdon me arsyetimin se ato janë të lidhura me akte e sjellje të parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj si dhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momenti subjektiv si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.

**VGJK 75/2002** Shprehja “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën...”, parashikuar nga nenet 128, 140 dhe 149, pika 2 të Kushtetutës, përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilët mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ato janë të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte... Nëse gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, i Gjykatës së Lartë, apo Prokurori i Përgjithshëm rezultojnë se ka shkelur Kushtetutën, ka kryer akte që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij, apo ka shkelur rëndë ligjin, marrja e masës së shkarkimit nga Kuvendi është e lidhur domosdoshmërisht me kryerjen e procedurave përkatëse. Funkcioni që kryen Kuvendi në këtë rast është i një natyre të veçantë. Procesi i realizuar prej Kuvendit ndryshon nga gjithë veprimtaria e tij e zakonshme si një organ që miraton ligje. Ky proces ligjor që është një proces gjykimi disiplinor dhe i ngjashëm me procedurat hetimore administrative ka parimet e veta, të cilat lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e atyre shkaqeve konkretë që kanë shërbyer për organin kompetent për të marrë masën e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit apo prokurorit. ... **Ekzistenca e këtyre shkaqeve kushtetuese për shkarkim përbën një garanci më shumë për funksionet që ata kryejnë, por edhe për vet institucionet**

kushtetuese që ato përfaqësojnë. Këto nene kushtetuese kanë lënë në vlerësimin e Kuvendit, si karakterin dhe rëndësinë e shkeljes së kryer, ashtu edhe faktin nëse akti apo veprimi, është i asaj natyre që mund të diskreditojë figurën e gjyqtarit apo të prokurorit. Ajo që nënkupton dispozita kushtetuese është që rasti konkret për shkarkim duhet të ketë ndodhur dhe të jetë i vërtetuar si i tillë. Pikërisht ky konkluzion del nga interpretimi që i bëhet fjalisë së dytë në nenet 128 e 140. Gjykata Kushtetuese duke shqyrtuar vendimin e Kuvendit që ka shkarkuar gjyqtarin, vërteton nëse ekziston shkak i shkarkimit. Pra, ajo vërteton nëse Kuvendi ka vepruar në përputhje me Kushtetutën, rregulloren dhe me ligjet përkatëse dhe nëse ai i ka respektuar të gjitha procedurat për ta motivuar, argumentuar dhe arsytuar plotësisht vendimin e shkarkimit. Nëpërmjet këtij kontrolli konstitucional që kryhet mbi vendimin e Kuvendit, Gjykata Kushtetuese shqyrton jo vetëm procedurën e shkarkimit, por edhe thelbin e çështjes. Prandaj, me qëllim që vendimi i Kuvendit të jetë sa më i bazuar dhe të mos rrëzohet si antikushtetues, ai duhet të ketë plotësuar të gjitha elementet e domosdoshëm të një procedure korrekte, sepse mjafton mosrespektimi i procedurës dhe i formës së nxjerrjes së një akti, që ai të konsiderohet i pavlefshëm. Përsa i përket nenit 149 pika 2 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se është Presidenti i Republikës organi kompetent i ngarkuar nga Kushtetuta për të kryer një verifikim nga pikpamja kushtetuese të shkaqeve si dhe të procedurave të ndjekura nga Kuvendi për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Ky konkluzion del nga mënyra e formulimit të këtij neni kushtetues në të cilin, përdorimi i shprehjes “mund të shkarkohet”, do të thotë se vendimi i Kuvendit për propozimin e shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm nuk është përfundimtar, por është vetëm iniciimi i një procedure shkarkimi, bazueshmëria në ligj dhe në Kushtetutë e të cilës vlerësohet në këtë rast nga Presidenti i Republikës. Nisur nga sa u parashtrua më lart, Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme të verë në dukje se elementet bazë të një procedure ligjore, që lidhen me mënyrën e iniciimit të procedurës për shkarkim, *quorum*-in e nevojshëm për vendimmarrjen, shkaqet ligjore për shkarkim, si dhe organin që vendos përfundimisht për to, janë të parashikuara përgjithësisht në Kushtetutë. Megjithatë një rregullim të mëtejshëm ato e gjejnë në ligjet bazë, siç është rasti i cuourumit të domosdoshëm që nevojitet për iniciimin e procedurave për shkarkim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

---

### Neni 129

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës.

### Neni 130

Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private.

### Neni 131<sup>3</sup>

Gjykata Kushtetuese vendos për:

a)<sup>4, 5</sup> pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122;

---

<sup>3</sup> **VGJK 35/2007**: ... Gjykata Kushtetuese vlerëson se nuk është detyrë e kësaj Gjykate shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërië mes dy ligjeve të ndryshme apo ligjeve dhe kodeve. Në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese hyjnë papajtueshmëria e ligjeve apo kodeve me Kushtetutën, sikundër është shprehur dhe në disa vendime të saj të mëparshme kjo Gjykatë. Mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera, nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe për rrjedhojë nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese<sup>41</sup>.

<sup>4</sup> **VGJK 36/2007**: Me qëllim të realizimit të kontrollit të kushtetutshmërisë të dispozitës ligjore të kundërshtuar, Gjykata Kushtetuese vlerëson si të domosdoshme të sqarojë, pikësëpari, kuptimin e saktë dhe të qartë që i duhet dhënë asaj dispozite. Aspekti i rëndësishëm i respektimit të kushtetutshmërisë së normave juridike është qartësia, rrjedhshmëria, koherenca dhe mungesa e kontradiksionit logjik ndërmjet tyre. Ekzistenca e paqartësisë, e pasaktësisë, e kontradiksionit logjik ose e pazbatueshmërisë të normave ligjore, që mbartin drejtpërsëdrejti rrezikun e mosrespektimit të parimit të shtetit të së drejtës, shërben si argument i

b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;

c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;

ç)<sup>6,7</sup> mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;

---

mjaftueshëm, në fushën e kontrollit kushtetues, për t'i konsideruar ato si të papajtueshme me Kushtetutën. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore që i lë shteg zbatuesit t'i jap asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vet norma.

<sup>5</sup> **VGJK 29/2006:** Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese duke qenë e orientuar në kuptimin doktrinar që i jepet parimit *res judicata* mban në vëmendje të veçantë edhe arsyet dhe shkaqet e përligjura dhe objektive të cilat diktojnë domosdoshmërinë e evoluimit të jurisprudencës kushtetuese dhe përshtatjen e saj me standardet demokratike bashkëkohore. Në këtë drejtim, është për t'u theksuar se Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 131, shkronja "a" të Kushtetutës, ka jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin që, për arsye të ratifikimit të një marrëveshje ndërkombëtare, të jetë e lirë dhe të mos pengohet në ushtrimin e kompetencës së saj për të vendosur për pajtueshmërinë e ligjit me këtë marrëveshje ndërkombëtare.

Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese pasi analizoi paralelisht të dy kërkesat dhe veçanërisht qëndrimin që ajo ka shprehur në arsyetimin e vendimit nr.2, datë 25.01.1999 konkludon se qoftë në aspektin formal, ashtu dhe në atë substancial nuk ndodhemi përpara gjësë së gjykuar. Ndonëse të dy çështjet kanë ngjashmëri, këndvështrimi aktual i Gjykatës Kushtetuese është drejtuar nga shkak i ndryshëm ligjor dhe kërkimet përfundimtare të kërkuarit që kanë të bëjnë me zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore dhe papajtueshmërinë e dispozitave ligjore me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore.

<sup>6</sup> **VGJK 26/2006:** ...duke përfshirë në objektin e hetimit një numër çështjes që nuk përfshihen në sferën kontrolluese të tij, organi ligjvënës, ka cenuar kompetencat e organit të prokurorisë dhe për rrjedhojë, ka krijuar një mosmarrëveshje kompetencash, që në kuptim të nenit 131 shkronja "ç" të Kushtetutës i përket për zgjidhje Gjykatës Kushtetuese. Kjo Gjykatë, për këto arsye e konsideron konfliktin e kompetencave rrjedhojë e ndërhyrjes së pushtetit legjislativ (nëpërmjet komisionit hetimor) ndaj kompetencave kushtetuese e ligjore të organit të prokurorisë. Gjykata Kushtetuese ka juridiksion të vendosë për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve (neni 131/ç i Kushtetutës), me kusht që, mosmarrëveshja të ketë lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së tyre (neni 54/1 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"). Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim këto mosmarrëveshje kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete (neni 54/2 i ligjit të sipërcituar), dhe si bazë për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve mund të shërbejë çdo lloj akti ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve, që kanë çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre (neni 54/4 i ligjit). Edhe sipas jurisprudencës kushtetuese që ka të bëjë me këtë lloj konflikti, që të lindë një mosmarrëveshje kompetence ndërmjet pushteteve, duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë këto kushte të nevojshme: mosmarrëveshja, si rregull, të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme; mosmarrëveshja të lindë ndërmjet organeve kompetente që deklarojnë përfundimisht vullnetin e pushtetit e pushtetit, të cilit i përkasin; si dhe mosmarrëveshja të lindë për përcaktimin e sferës së kompetencave të përcaktuara nga normat kushtetuese për pushtete të ndryshme. Edhe në rastin në shqyrtim janë prezent të gjithë elementët e një mosmarrëveshje të tillë. Konkretisht, Kuvendi, si pushtet legjislativ, ka marrë vendimin nr.31, datë 02.05.2006 me të cilin ka konsideruar veten kompetent për të kontrolluar e vlerësuar vendimet e organit të Prokurorisë, të marra për çështje konkrete. Organi i Prokurorisë ka pretenduar se kjo është sferë e kompetencave të tij, duke kërkuar zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje në Gjykatën Kushtetuese.

<sup>7</sup> **VGJK 29/2006:** Në bazë të nenit 131, shkronja "ç" të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror e qeverisjes vendore. Çështje të kësaj natyre ngrihen nga organi kushtetues kompetent duke i kërkuar Gjykatës Kushtetuese të deklarojë përfundimisht organin, të cilit i takon të ushtrojë vullnetin e vet në sferën e caktuar të veprimtarisë shtetërore, dhe të përcaktojë gamën e kompetencave të tij. Dispozita e shkronjës "ç" të nenit 131 të Kushtetutës përfshin mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes së pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor) si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror-qeverisje vendore). Veç këtyre, mbështetur në jurisprudencën kushtetues, kjo dispozitë përfshin edhe një gamë tjetër mosmarrëveshjesh, siç janë ato që mund të lindin midis organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike, në këtë ose atë pushtet, siç janë Presidenti, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria dhe organe të tjera kushtetuese. Ndarja e pushteteve në thelb nuk është gjë tjetër veçse ndarje kompetencash. Kompetenca është tagra që i jepet juridikisht një organi ose një pushteti për të vendosur mbi çështje të caktuara. Që një mosmarrëveshje kompetence të përfshihet në

d) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të kësaj Kushtetute;

dh) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;

e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës dhe të deputetëve, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre;

ë) kushtetutshmerinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;

f)<sup>8</sup> gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.<sup>9,10</sup>

---

juridiksionin kushtetues duhet që ajo të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme dhe që secili prej tyre të kërkojë veçmas tjetrit të materializojë vullnetin e pushtetit, të cilit i përket, duke nxjerrë akte që ai çmon se i takojnë sferës së vet të kompetencave. Duke iu referuar doktrinës dhe jurisprudencës kushtetuese, Gjykata Kushtetuese vlerëson se mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit "normativ" kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit "individual", kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse të zbatimit të ligjit konkret. Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjesh të ndryshëm dy institucioneve, si edhe kur ligji parashikon kompetencën, por nuk ka saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto* dhe duke abstraguuar nga rasti konkret. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe, mbi këtë bazë, ka nxjerrë aktin individual të zbatimit. Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit, me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit. Pavarësisht nga shprehja ose jo e kundërshtimeve për përkatësinë e pushtetit, mund të konsiderohet se konflikti është i pranueshëm për tu gjykuar edhe në rast se, nga ushtrimi abuziv i pushtetit pakësohen ose pengohen ushtrimi i kompetencave që Kushtetuta ia atribuon subjektit ankues. Konflikti ndërmjet ligjeve që ka lindur për çështje përkatëse kompetencash midis organeve kushtetues përbën çështje kushtetuese, ndryshe nga rastet e tjera të kolizionit ligjor, për të cilët gjykata e zakonshme është kompetente të vendosë se cili nga ligjet është i zbatueshëm për çështjen në shqyrtim para saj. Ky është aspekti dallues që paraqet çështja e mosmarrëveshjeve të kompetencës si prerogativë e Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht nëse mosmarrëveshja përkatëse ka lindur në bazë të ligjit si akt normativ apo të aktit të zbatimit të tij si akt individual i organit përkatës. Duke shtjelluar dispozitën e nenit 131, shkronja "ç" të Kushtetutës, ligjvënësi në nenin 54 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" specifikon se "Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim këto konflikte kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete dhe, sipas rastit, kanë nxjerrë aktet për rregullimin e saj, ose kur subjektet nuk e kanë konsideruar veten kompetente të vendosin në raste të veçanta." Para së gjithash, kjo dispozitë bën fjalë për mosmarrëveshje ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme, objekt i së cilës është përkatësia e një kompetence si edhe për organin që ankohet se i është cenuar sfera e kompetencës dhe që, për këtë arsye, i drejtohet Gjykatës Kushtetuese të deklarojë organin të cilit i përket kompetenca në fjalë.

<sup>8</sup> **VGJK 27/2007:** ...Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Gjykata Kushtetuese konstaton se për rastin në shqyrtim, kërkuesi megjithëse i ka patur në dispozicion, nuk ka shteruar mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tij ligjore. Sipas nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile kundër vendimit të pushimit të përmbauesit gjyqësor mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë. Në këto kushte, përderisa nuk është shfrytëzuar ky instrument juridik që ligji i ka lënë në dispozicion kërkuetit për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese e ligjore, çështja nuk mund të përfshihet në juridiksionin kushtetues dhe për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

<sup>9</sup> **VGJK 9/2005:** Gjykata Kushtetuese konfirmon edhe një herë qëndrimin e saj të shprehur në vendimin nr.10, datë 02.04.2003 se sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, "Mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore". Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apeliemeve.

**VGJK 10/2003:** Kërkuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij për një proces të rregullt ligjor, në kuptimin kushtetues. Nga vendimi i gjykatës së rrethit dhe nga ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, del se kërkuesi nuk ka qenë palë në gjykimin në gjykatën e rrethit në të cilën pretendon se i është mohuar bashkëpronësia dhe sipas parimeve

## Neni 132<sup>11</sup>

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton.

2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ligji ose akti tjetër normativ të shfuqizohet në një datë tjetër. Mendimi i pakicës botohet bashkë me vendimin.

---

procedurale, ai vendim nuk mund të ketë efekte juridike për kërkuesin. Si rrjedhojë, këtij të fundit nuk i është mohuar e drejta të ngrejë padi themeli në gjykatë për çdo mohim të së drejtës së tij të bashkëpronësisë. Sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë, vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apelimeve. Veç sa sipër, Gjykata Kushtetuese, nuk mund të mos vejë në dukje që procesi ligjor i zhvilluar nga gjykatat është i rregullt nga pikëpamja kushtetuese. Fakti që provat e reja të paraqitura pas gjykimit dëshmojnë se kërkuesi është bashkëpronar në pasurinë trashëgimore nuk mund ta bëjnë procesin të parregullt përderisa nuk del që gjykatat të kenë neglizhuar si për marrjen e provave ashtu edhe për thirrjen në gjyq të personave që pretendojnë për bashkëpronësi.

<sup>10</sup> **VGJK 17/2005:** Sipas kriterit kushtetues të vlerësimit të çështjes lidhur me shterimin e mjeteve ligjore, Gjykata Kushtetuese çmon se përgjithësisht, nuk konsiderohen të shteruara mjetet ligjore kur për shkelje gjatë procedimeve të mëparshme, çështja është kthyer për rigjykim nga instanca më e lartë gjyqësore. Në këto raste, mungesa e legjitimitit për të ushtruar ankim kushtetues lidhet dhe përcaktohet nga fakti se procesi vazhdon dhe ka ende mjete të tjera ankimi për të rivendosur të drejtën gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatat e sistemit gjyqësor. **Një situatë e ndryshme krijohet kur kërkuesi pretendon se nuk janë respektuar kriteret e procesit të rregullt ligjor në instancën e fundit të gjykimit dhe nuk është parashikuar asnjë mjet ankimi ndaj vendimit të kësaj shkalle gjykimi.** Në këto raste edhe pse çështja kthehet për rigjykim dhe procesi gjyqësor vazhdon, në aspektin e shterimit të mjeteve ka rëndësi fakti, se kërkuesi, nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara në instancën e fundit të gjykimit dhe se shqyrtimi gjyqësor rishtazi, nuk pretendon të ndreqë këto shkaqe, por të gjykojë çështjen në themel. Në rrethana të tilla, është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, të vlerësojë sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkuesi i ka shterur ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara. Një qëndrim të tillë lidhur me kriteret vlerësuese për shterimin e mjeteve ka mbajtur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj. Në një vendim të saj kjo Gjykatë, në radhë të parë vuri në bisedim faktin e shterimit të mjeteve, duke përcaktuar se ky rregull nënkupton që kërkuesi t'u drejtohet mjeteve që janë efektive dhe të mjaftueshme për të realizuar ndreqjen e shkeljeve të lejuara.<sup>[2]</sup> Ajo, nënvizon se ekzistenca e mjeteve në fjalë duhet të jetë me siguri e realizueshme, jo vetëm në teori por edhe në praktik, pa çenuar efektivitetin e domosdoshëm. Nisur nga këto kriteret kushtetuese dhe qëllimi që ato synojnë të arrijnë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, për vetë rrethanat specifike të paraqitura, kur rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, kërkuesit nuk kanë mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën për rishikim. Në këto rrethana, kërkuesit i kanë shterur të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre, prandaj pretendimet e ngritura në kërkesë duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit kushtetues.

<sup>11</sup> **VGJK 7/2006:** Është e vërtetë se natyra e vendimit të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 132 të Kushtetutës, si rregull, lidhet me të drejtën për të shfuqizuar aktet që shqyrton. Në të vërtetë Gjykata Kushtetuese, duke patur edhe shumë kompetenca të tjera veç atyre të parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës, është e detyruar të japë dhe vendime të llojeve të tjera, të ndryshme, pra dhe vendime konstatuese apo deklarative që në të vërtetë kanë efekte, pavarësisht se nuk janë të natyrës që shfuqizojnë një akt konkret. Kështu psh., Gjykata Kushtetuese vendos dhe për vërtetimin e pamundësisë së Presidentit të Republikës për të ushtruar funksionet e tij ose për zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të tij dhe të deputetëve, si dhe verifikimin e zgjedhjes se tyre. Në raste të kësaj natyre dhe për të tjera si këto, Gjykata Kushtetuese merr vendime që kanë një natyrë tjetër nga ato për të cilat bëhet fjalë në nenin 132 të Kushtetutës. Pra, Gjykata Kushtetuese vendos nëse konstaton prekjën e një të drejte themelore nga organet që merren me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pas kësaj, çdo organ që ka detyrime nga vendimi përkatës, detyrohet të marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin në mënyrë të plotë e të përpiktë me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

**VGJK 2/2003:** Në nenin 132 pika 1 të Kushtetutës është parashikuar, se Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. Përveç kësaj, kontrolli kushtetues i ligjeve ose akteve të tjera normative shtrihet vetëm mbi ato burime të të drejtës që aktualisht janë në fuqi. Megjithatë, në disa raste, këtij kontrolli i nënshtrohen edhe norma juridike të shfuqizuara kur këto, si pjesë e të drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar. Duke iu referuar çështjes objekt gjykimi ... Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është pa objekt pasi ligji i kundërshtuar prej kësaj gjykate për papajtueshmëri me Kushtetutën ka rënë nga fuqia.... Me plotësimin e këtij qëllimi ky ligj ka rënë nga fuqia. Përveç kësaj, ky ligj, hyn në kategorinë e ligjeve të posaçme. Për pasojë, duke qenë i tillë, në rastet kur ligji pasardhës është i përgjithshëm, nuk aplikohet rregulli i abrogimit (i shfuqizimit nga ligjvënësi). Këtu bën përjashtim vetëm rasti kur ligjvënësi shpreh një vullnet të kundërt, dmth., në rastet kur me ligjin e përgjithshëm që nxjerr pas ligjit të posaçëm, ligjvënësi ka për qëllim të eliminojë ose të rregullojë pasojat që ka sjellë ligji i posaçëm, gjë që në rastin në shqyrtim nuk ka ndodhur.

**VGJK 8/2003:** Shkeljet e ndryshme ligjore që mund të evidentohen nga palët gjatë proceseve gjyqësore nuk lidhen pazgjidhshmërisht me konceptin kushtetues dhe të jurisprudencës evropiane të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar ankesat e individëve për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk ka për qëllim të dublojë dhe të spostojë të drejtën e gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor për të zgjidhur vetë çështjet. E drejta për një proces të rregullt ligjor përbën një nga të drejtat e parashikuara në Kushtetutën tonë dhe në Konventën Evropiane dhe lidhet me garancitë që u ofrohen palëve gjatë një gjykimi, në drejtim të respektimit të atyre parimeve esenciale që përbëjnë thelbin e procesit. Standarte të tilla kushtetuese si e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, e drejta e mbrojtjes, paanësia në gjykim, gjykim publik, prezumimi i pafajësisë etj., përbëjnë elementet kryesore që Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar në jurisprudencën e saj për kuptimin sa më të plotë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

### Neni 133

1. Pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj.
2. Gjykata Kushtetuese vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj.

### Neni 134

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:
  - a) Presidentit të Republikës;
  - b) Kryeministrit;
  - c) jo më pak se një së pestës së deputetëve;
  - ç) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
  - d) çdo gjykate sipas rastit të nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute;
  - dh) Avokatit të Popullit;
  - e) organeve të qeverisjes vendore;
  - ë) organeve të bashkësive fetare;
  - f) partive politike dhe organizatave të tjera;
  - g) individëve.

## 2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët dh, e, ë, f dhe g të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

**VGJK 40/2007:** Gjykata Kushtetuese vlerëson si të nevojshme që së pari të shprehet mbi legjitimitimin e kërkuarit. Lidhur me këtë Gjykata çmon se Avokati i Popullit legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së tij para kësaj Gjykate. Siç është theksuar edhe në praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete. Interesi i tij duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij. Gjykata Kushtetuese e sheh me vend të ndalet edhe një herë në përcaktimin e konceptit “interes” në çështjen me kërkuar Avokatin e Popullit, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës, ku parashikohet se ky organ mund të bëjë kërkesë para kësaj Gjykate vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tij. Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit është organ kushtetues i krijuar për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike. Një nga mënyrat me të cilat ky organ realizon funksionin e tij është edhe vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e akteve normative të nxjerra nga administrata publike dhe që nga evidentimi i Avokatit të Popullit rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Avokati i Popullit mund të arrijë në këtë përfundim përmes hetimeve, vëzhgimeve apo informacioneve që ai mbledh, kur individët i drejtohen atij me anë të ankesës ose kërkesës. Nëse ky organ vlerëson se si rrjedhim i veprimtarisë së administratës publike janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të individit, atëherë ai ndërmerr hapa konkretë për verifikimin e mëtejshëm të shkaqeve që kanë çuar në këtë shkelje dhe rast pas rasti rekomandon marrjen e masave të karakterit normativ, nëse është e nevojshme. Gjykata Kushtetuese konstaton se kompetenca e Avokatit të Popullit për t’iu drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë që i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike. Nuk është detyra kryesore e Avokatit të Popullit t’i drejtohet gjykatave në tërësi dhe Gjykatës Kushtetuese në veçanti. Megjithatë në legjislationet e vendeve ku nuk është parashikuar ekzistenca e mjeteve të tilla si kundërshtimi i drejtpërdrejt i akteve normative para Gjykatës Kushtetuese, Avokati i Popullit mund të luajë një rol të rëndësishëm në verifikimin e shkeljeve të të drejtave themelore të individit deri në investimin e Gjykatës Kushtetuese. Në raste të tilla, Avokati i Popullit duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Kur Avokati i Popullit krijon bindjen se shkelja ka ardhur si pasojë e përmbajtjes së një ligji ose akti tjetër normativ, pra nga vetë formulimi i vullnetit të organit që e ka nxjerrë atë, atëherë ai mund të investojë Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e aktit si antikushtetues. Në një rast të tillë mund të thuhet se çështja konkrete lidhet me interesin e këtij organi kushtetues për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individit. Në këtë këndvështrim, interesi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me qëllim shfuqizimin si antikushtetues të aktit të ligjvënësit duhet të shqyrtohet rast pas rasti, pasi ky është edhe kuptimi i nenit 134/2 të Kushtetutës, i cili e ka renditur këtë organ në grupin e subjekteve që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm nëse justifikojnë interesin e tyre në çështjen konkrete. Ashtu siç është shprehur edhe në praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, interesi i një subjekti në një çështje në kuptim të shkronja “dh”, “e” “ë”, “f” të nenit 134 të Kushtetutës do të quhet i justifikuar nëse ai arrin të provohet nga vetë kërkuari se pasoja është e drejtpërdrejt pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose organizatës respektive. Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuari i plotëson të tre këto kritere, pasi kërkesa lidhet me përmbajtjen e aktit normativ, i cili, sipas tij, sjell pasoja direkte në një të drejtë kushtetuese themelore siç është e drejta e votës. Gjithashtu, cenimi është aktual dhe jo potencial, pasi, sipas kërkuarit, të burgosurit janë penguar realisht të ushtrorin të drejtën e votës si rrjedhim i përmbajtjes së dispozitës së nenit 63/3 të Kodit Zgjedhor. Edhe elementi i tretë, pra lidhja e drejtpërdrejt me subjektin, ekziston, pasi, siç u shpreh më lart, është në funksionin e Avokatit të Popullit të mbrojtë interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike. Në kërkesën para kësaj Gjykate kërkuari ka parashtruar se ai është vënë në lëvizje për këtë shkelje nga vetë të burgosurit, të cilët nuk kanë pasur mundësi të ushtrorin të drejtën e tyre të votës. Avokati i Popullit, në ushtrim të kompetencave të veta, ka krijuar mendimin se shkak për mosushtrimin e kësaj të drejte është përmbajtja e dispozitës së Kodit Zgjedhor, eliminimi i së cilës mund të sjellë si pasojë vendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Gjykata Kushtetuese çmon se vënia në lëvizje nga Avokati i Popullit është në përputhje me funksionin e tij kushtetues dhe me filozofinë e krijimit të këtij institucioni, si një mekanizëm efektiv në mbrojtje të të drejtave kushtetuese të shtetasve, të drejta të cilat përbëjnë bazën e rendit tonë juridik.

**VGJK 29/2006:** Ligji organik për Gjykatën Kushtetuese formulon orientime të përgjithshme për organin që ka të drejtën të iniciojë gjykimet në këtij lloji, por ai nuk specifikon konkretisht se cilët janë këto organe. Sipas nenit 54, pika 3 të këtij ligji, kërkesa para Gjykatës Kushtetuese ngrihet nga *subjektet në konflikt* ose nga *subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti*. Pavarësisht nga karakteri objektiv apo subjektiv i shkakut që lind mosmarrëveshjen, Gjykata Kushtetuese vendos, sipas nenit 56 të ligjit të sipërpërmendur, se cili organi i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete, për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, ajo shqyrton gjithashtu edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet pikësisht në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa i takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe eliminuar dhe shkakun vendimtar që e ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes. Nisur nga sa u parashtrua më sipër, nxirret konkluzioni se çdo organ pushteti legjitimohet të bëjë kërkesë para Gjykatës Kushtetuese kur ai pretendon se ndodhet para një konflikti kompetence, i cili mund të ketë lindur për shkak të ligjit ose të një veprimtarie faktike. Përcaktuese është që sfera e kompetencave e organeve apo subjekteve të konfliktuara duhet të jetë e përkufizuar nga norma kushtetuese. Nga kjo analizë, Gjykata Kushtetuese



konkludon se Bashkia e Tiranës, nëpërmjet Kryetarit të saj, si organ ekzekutiv i qeverisjes vendore dhe një ndër subjektet e parashikuara nga neni 134/1, shkronja “e” të Kushtetutës, por, për më tepër si “*subjekti në konflikt*”, që pretendon për ekzistencën e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, duke iu referuar parimit të decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore, legjitimohet në aspektin kushtetues për të ngritur një çështje të kësaj natyre. Edhe në aspektin e legjitimitetit formal e procedural është Kryetari i Bashkisë, i cili mban edhe pozicionin e Kryetarit të KRRT-së, që sipas ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ushtron të gjitha kompetencat që ligji i ka njohur komunës ose bashkisë në fushën e planifikimit urban.

**VGJK 35/2007:** Çështjen e legjitimitetit të kërkuarit, (*locus standi*) Gjykata Kushtetuese e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet inicuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat (*organizatat e tjera*) janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke patur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta. Në rastin konkret, Shoqata “Pronësi me Drejtësi”, sipas statutit, në fokus të veprimtarisë së saj ka mbrojtjen e interesave të ish-pronarëve, që janë zhveshur nga pronësia nëpërmjet shtetëzimeve, konfiskimeve dhe me çdo mënyrë tjetër nga regjimi totalitar si dhe mbrojtjen e interesave ekonomike të pronarëve nga çdo cenim i të drejtës së pronësisë. Gjatë shqyrtimit të çështjes është konstatuar, se ligji objekt shqyrtimi, trajton probleme që lidhen me legalizime në vendbanime formale, zona informale, territore të tjera si dhe të shtesave pa leje në ndërtime me leje; kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore ku është ngritur ndërtimi pa leje; urbanizim të zonave të blloqeve informale, të ndërtimeve informale dhe integrimin e tyre në zhvillimin territorial; procedurat e legalizimeve dhe ngritjen e strukturave përgjegjëse për realizimin e tyre. Ky ligj rregullon jo vetëm problemin e legalizimit të ndërtimeve pa leje të ngritura mbi toka apo troje të pronarëve privatë, por dhe mbi toka e troje pronë publike. Nga shqyrtimi i problematikës konstatohet se me interesat e kërkuarit kanë të bëjnë vetëm problemet e kalimit të pronës private tek ndërtuesit e paligjshëm dhe ajo pjesë e ligjit që trajton aspekte të urbanizimit të zonave të ndryshme që përfshihen në të, por që prekin pronën private. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i kërkuarit për antikushtetutshmërinë e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nuk mbart në vetvete interesin për t’u konsideruar në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si subjekt inicues i gjykimit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike lidhur me çështje që nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre. Kërkuari legjitimohet vetëm për atë pjesë të ligjit që ka të bëjë me cenimin e interesave të pronarit të ligjshëm privat. Pretendimi i përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave lidhur me moslegjitimitetin e kërkuarit për pjesën e dispozitave të ligjit që kanë të bëjnë me pronën publike është i drejtë.

**VGJK 1/2005:** Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet inicuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet funksionit e veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Partitë politike janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ato kanë legjitimitet kushtetues vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve e pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve e veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri tek ndarja e mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm. Prandaj, demokracia përfaqësuese, ashtu si dhe sistemi i zgjedhjeve, nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Ky pozicion specifik që partitë politike kanë në raport me zgjedhjet përcakton njëkohësisht dhe interesin e tyre për të patur një legjislacion dhe rregulla sa më të qarta e të drejta.

## PJESA E NËNTË

### GJYKATAT

#### Neni 135

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.
2. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.

**VGJK 12/2003:** U vërtetua se Gjykata e Apelit Korçë, gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor ka lejuar disa shkelje të rëndësishme procedurale. Ajo ka marrë përsipër rolin e ekspertit duke vlerësuar si të zënë truallin e paditësve në kushtet, kur sipas nenit 135 të

Kushtetutës, gjykatat janë organe të pushtetit gjyqësor dhe si të tilla nuk mund të kryejnë detyra jashtë veprimtarisë gjyqësore. Proceduralisht, ekspertët, thirren nga gjykata për sqarimin e fakteve për të cilat kërkohen njohuri të posaçme. Çështja e përcaktimit të llojit të truallit objekt konflikti, është e tillë që gjykata e apelit zgjidhjen e saj nuk duhet ta bënte vetë, por të urdhëronte kryerjen e një ekspertimi të ri.

## Neni 136

1. Anëtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.

2. Njëri nga anëtarët emërohet Kryetar sipas procedurës së parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndrojnë në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi.

4. Gjyqtarët e tjerë emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

5. Gjyqtarë mund të jenë vetëm shtetasit me arsim të lartë juridik. Kushtet dhe procedura e zgjedhjes caktohen me ligj.

**VGJK 2/2005:** Kuvendi i Shqipërisë në rastet e shqyrtimit të dekreteve të Presidentit të Republikës për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ka kompetencë të shqyrtojë jo vetëm përmbushjen e kriterëve formale, por të shqyrtojë edhe *meritën* e emërimit të tyre. Për rrjedhojë, Kuvendi i Shqipërisë ka kompetencë të japë ose jo pëlqimin për emërimet e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

a) Gjykata Kushtetuese vlerëson se, së pari, termi *pëlqim*, që gjendet në tekstin e neneve 125/1 e 136/1 të Kushtetutës, duhet të analizohet në kuptimin literal. Në këtë aspekt, ky term, sipas kuptimit të zakonshëm të tij, nënkupton *të qenët në një mendje për diçka, miratimin, pranimin*.<sup>14</sup> Pra, *pëlqimi* i Kuvendit, sipas kuptimit të mësipërm, nënkupton pranimin e kandidatit përkatës. Thënë ndryshe, *pëlqimi* që kërkojnë dispozitat e mësipërme, nënkupton një lloj *konsensusi* midis këtyre organeve kushtetuese që përfshihen në procesin e emërimit të gjyqtarëve të gjykatave më të larta;

b) Krahas kuptimit gjuhësor të termit të mësipërm, edhe në bazë të interpretimit teleologjik të dispozitave – objekt interpretimi, konstatohet se qëllimi i hartuesve të Kushtetutës, ka qenë që emërimi i gjyqtarëve të mos mbetet vetëm në kompetencën e një organi, gjë që siguron në mënyrë më të përshtatshme pavarësinë dhe autoritetin e këtyre gjykatave. Për pasojë, pjesëmarrja e Kuvendit të Shqipërisë në këtë proces ka për qëllim balancimin e kompetencës së Presidentit të Republikës në emërimin e gjyqtarëve, dhe kjo vjen në harmoni edhe me parimin e ndarjes dhe *balancimit* ndërmjet pushteteve, të parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës. Interpretimi, sipas të cilit, emërimi i përket, në mënyrë ekskluzive, një organi politik me natyrë individuale (Kryetari të Shtetit), nuk do të ishte në pajtim me *standardin* përkatës në këtë fushë. Ky përfundim mund të konfirmohet edhe nga pikëpamja e **të drejtës kushtetuese të krahasuar**. Kështu, në Kushtetutat dhe ligjet që përcaktojnë regjimin e një shteti demokratik të së drejtës, standardi përkatës në këtë drejtim synon një *procedurë* për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave më të larta, që nga pikëpamja e organeve kushtetuese që marrin pjesë në këtë proces, mund të quhet *plurale*. Në esencë, kjo procedurë emërimi karakterizohet – ose nga *ndarja* e kompetencës së zgjedhjes së gjyqtarëve midis shumë organeve ose institucioneve të shtetit; - ose, në raste të tjera, nga *kooperimi i institucional* i dy ose më shumë organeve në caktimin e gjyqtarëve; ose si një *procedurë ekskluzivisht* (ose pothuajse) *parlamentare* për zgjedhjen e gjyqtarëve, ku hyn në lojë pluralizmi konkurrencial i partive politike që marrin pjesë dhe nevoja për kërkimin e një konsensusi midis tyre. Në rastin në shqyrtim, sistemi i emërimit i pranuar nga Kushtetuta e Shqipërisë ka në esencë *kooperimin institucional* të Presidentit të Republikës dhe të Kuvendit të Shqipërisë;

c) Gjykata vlerëson gjithashtu se, kompetenca e Kuvendit të Shqipërisë për një shqyrtim të plotë, pra edhe në këndvështrimin e meritës, të zgjedhjes së bërë nga ana e Presidentit të Republikës, është në pajtim edhe me formën e regjimit politik të përcaktuar në Kushtetutë (neni 1) - si Republikë Parlamentare. Në këtë vështrim, pjesëmarrja e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e emërimit të gjyqtarëve, që shkon tej një kontrolli juridik të procesit, është në harmoni të plotë me natyrën politike të këtij organi;

d) Konstatimet e mësipërme gjejnë konfirmim duke patur parasysh edhe evoluimin e kuadrit kushtetues në vendin tonë lidhur me procesin e caktimit të gjyqtarëve të gjykatave më të larta, proces në të cilin, Kuvendi i Shqipërisë ka patur dhe ka një rol substancial.

#### Neni 137

1. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të ndiqet penalisht vetëm me miratimin e Kuvendit.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të ndalohe ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

3. Gjyqtarët e tjerë mund të ndiqen penalisht vetëm me miratim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

4. Gjyqtari mund të ndalohe ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

#### Neni 138

Koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet; paga dhe përfitimet e tjera të tyre nuk mund të ulen.

#### Neni 139

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron kur:

- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- b) nuk paraqitet në detyrë pa arsye për më shumë se 6 muaj;
- c) mbush moshën 65 vjeç;
- ç) jep dorëheqjen;
- d) deklarohet i paafte për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë.

#### Neni 140

Gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paafësi mendore a fizike dhe për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila, kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.

#### Neni 141

1. Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të

Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

2. Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të caktuara gjyqësore.

---

**VGJK 31/2005:** Funkzioni rishikues i Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, kërkon që Gjykata e Lartë, së pari, të aplikojë të drejtën mbi faktet e konstatuara e të vlerësuara në mënyrë të pavarur nga gjykatat e rrethit dhe apelit dhe, së dyti, të njësijë praktikën gjyqësore, në bazë të interpretimit që u jep problemeve juridike, pra, të interpretojë ligjin për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë në të gjithë territorin. Vendimet për zgjidhjen e çështjeve konkrete, ndonëse nuk kanë efekte jashtë kufijve objektivë të çështjes në gjykim, ndihmojnë për një funksionim harmonik të së drejtës dhe marrin vlera të veçanta përsa i përket koherencës dhe vazhdueshmërisë së orientimeve jurisprudenciale.

---

## Neni 142

1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.
2. Gjykata e Lartë duhet t'i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës.
3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

---

**VGJK 6/2006:** Këto dispozita kushtetuese, lidhur me procesin e rregullt ligjor, në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, janë trajtuar të lidhura ngushtë me paragrafin e parë të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku përcaktohet se: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet detyrimisht dhe publikisht, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e krijuar ligjërish, e cila vendos qoftë për konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij”*<sup>2</sup>. Këto parime të rëndësishme të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane, të vështruara në kuadrin e të drejtave të njeriut, nënvizojnë edhe faktin se çdo qytetar që i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj, prandaj janë të lidhura me domosdoshmërinë e respektimit të një afati të arsyeshëm. Për shqyrtimin e kërkesës së kërkuarit, kjo lidhje çmohet si e domosdoshme. Organet e shtetit janë të detyruara të zbatojnë vendimet gjyqësore, të cilat janë të detyrueshme jo vetëm për palët, por dhe për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Sipas nenit 146 të Kushtetutës “Gjykatat i japin vendimet *“Në Emër të Republikës”*”. Ky deklaron kushtetues dëshmon faktin se vendimet e gjykatave janë vlerësuar nga Kushtetuta, si përsa i përket karakterit të tyre ashtu dhe për pasojat që ato sjellin për shtetasit dhe për shoqërinë në tërësi. **I gjithë procesi gjyqësor shpesh herë i vështirë e problematik nuk do të kishte vlerë nëqoftëse nuk do të pasohej nga një proces që lidhet drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e organeve të përmbartimit, me ekzekutimin e vendimit ose të realizimit të së drejtës së fituar.**

Faza e dytë, kur lipset dhe ndërhyrja, qoftë dhe me masa shtërguese për zbatimin e tij, realizohet ajo që quajmë qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë, e drejta është e sigurtë, por kërkohet që ajo të vihet në jetë qoftë dhe me masa shtërguese nëse zbatimi vullnetar nuk jep rezultatet e duhura. Duke qenë kështu, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë. Gjykata Kushtetuese, çmon se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Por kjo çështje paraqet veçoritë e veta në një aspekt tjetër, sepse në këtë rast, kjo gjykatë vetëm se konstaton shkeljen e bërë nga organet përkatëse, të cilat, nuk kanë zbatuar pa shkaqe të përligjura ligjore, një vendim të formës së prerë të gjykatës.

## Neni 143

Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private.

## Neni 144

Gjykatat kanë buxhet të veçantë, të cilin e administrojnë vetë. Ato e propozojnë buxhetin e tyre sipas ligjit.

#### Neni 145

1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.
2. Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.
3. Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit.

---

**VGJK 11/2004:** Në nenin 145 të Kushtetutës sanksionohet, se gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Me këtë kuptohet pavarësia, përgjegjësia dhe kompetenca e veçantë e gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet zgjidhjes së çështjeve konkrete. Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara. Askujt nuk i lejohet të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë. Këto koncepte, mbi pavarësinë e gjyqësorit dhe e gjyqtarëve gjejnë pasqyrim dhe në deklaratën e Këshillit konsultativ të gjyqtarëve Europian, sipas të cilës "... principet themelore të statusit të gjyqtarit të jenë të përcaktuara në normat e brendëshme të nivelit më të lartë dhe në rregulla të nivelit legjislativ". Gjyqtarët kanë detyrim të japin vendime në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, prandaj janë vendosur mekanizma apo rregulla që sigurojnë shmangien nga presionet, që mund të vijnë edhe nga funksionarë apo struktura të tjera, apo edhe nga brenda gjyqësorit nëpërmjet gjyqtarëve të niveleve më të larta ose që bëjnë pjesë në organizma vendimmarrëse për karrierën dhe statusin e gjyqtarit.

---

#### Neni 146

1. Gjykatat i japin vendimet në emër të Republikës.
2. Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast.

#### Neni 147

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Gjykatës së Lartë, ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, si dhe 9 gjyqtarë të të gjitha niveleve, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare. Anëtarët e zgjedhur qëndrojnë në detyrë për 5 vjet pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.
2. Presidenti i Republikës është Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e tij një zëvendëskryetar. Zëvendëskryetari organizon veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe kryeson mbledhjet e tij në mungesë të Presidentit të Republikës.
4. Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit.

5. Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tyre, përveçse kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor.

6. Gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Kundër këtij vendimi gjyqtari ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë, e cila në këtë rast, vendos me kolegje të bashkuara.

---

**VGJK 38/2003:** Ndonëse në nenin 147/6 të Kushtetutës në fuqi, përcaktohet se gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për largimin e tyre nga puna, ndërsa për prokurorët nuk parashikohet ndonjë e drejtë e tillë, kjo nuk do të thotë se prokurorët nuk kanë të drejtën të kërkojnë në gjykatë të drejtat e tyre juridiko-civile. Kushtetuta nuk përcakton për prokurorët ndonjë procedurë të veçantë gjykimi siç bën për gjyqtarët, por nuk i përjashton ata nga e drejta për t'u drejtuar në gjykatë, ndaj akteve administrative, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, ashtu siç e kanë këtë të drejtë të gjithë personat e tjerë fizikë e juridikë... Gjykata e Lartë i referohet vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të datës 08.12.1999 në çështjen "Pellegrini" kundër "Francës", në të cilin përjashtohen nga veprimi i nenit 6/1 të Konventës, "E drejta për një proces të rregullt", kërkesat e ngritura nga funksionarët, (duke përmendur forcat e armatosura e policinë) detyrimet e të cilave janë karakteristike për administratën që funksionon si deponituese e pushtetit publik dhe që është përgjegjëse për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit. Arsyetimi i mësipërm nuk mund të merret si bazë për t'u mohuar prokurorëve të drejtën për t'u drejtuar gjykatës. Konventa si instrument i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ofron vetëm një standart minimum të mbrojtjes së të drejtave dhe shtetet nuk pengohen të shkojnë përtej këtij kufiri duke i njohur funksionarëve të drejtën për t'u ankuar. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e njehtë drejtën për t'u drejtuar gjykatës kur shprehet se "neni 6/1 i siguron çdokujt të drejtën të paraqesë ankesa në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile përpara një gjykate ose arbitrazhi; në këtë mënyrë, ai ushtron "të drejtën për gjykim", nga e cila e drejta për t'u drejtuar gjykatës që është e drejta për të filluar një proces përpara një gjykate për çështje civile, përbën një aspekt". (Philis kundër Greqisë nr.1, vendimi i 27 gushtit 1991). Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.28 , datë 21.02.2002 ka shfuqizuar pikën 2 të nenit 34 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" që mohohte të drejtën e ankimit të prokurorit ndaj dekretit të Presidentit për shkarkimin e tij nga detyra. Ky shfuqizim është bërë si në çdo rast tjetër, nëpërmjet interpretimit të Kushtetutës, i cili ka fuqi "erga omnes" dhe është përfundimtar në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës. Prandaj, zbatimi i këtyre vendimeve është një detyrim kushtetues, të cilin asnjë organ, nuk ka të drejtë ta verë në diskutim.

**VGJK 11/2004:** Në kuptim të nenit 147, pika 4 të Kushtetutës dhe ligjeve të lartpërmendura, KLD-ja është i vetmi organ që ka kompetencë të marrë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, pavarësisht se kush ka bërë verifikimin e shkeljes dhe kush bën propozimin për masën disiplinore. Këtë kompetencë KLD-ja e zbaton duke vepruar si organ që dëgjon "palët" dhe administron provat e nevojshme rreth pretendimeve të parashtruara. KLD-ja është e lirë që të mos pranojë asnjë kërkesë apo propozim që vjen për masa disiplinore, kur nuk krijon bindjen se shkelja ekziston dhe nëse është i tillë që justifikon masën. KLD-ja vepron si një organizëm demokratik sepse gjyqtari jo vetëm që njihet paraprakisht me gjithë materialet në ngarkim të tij, por merr pjesë në mbledhje të KLD-së, mund të përfaqësohet edhe nga avokati, ka të drejtë të bëjë çdo sqarim apo të kundërtshtojë çdo akuzë, duke paraqitur edhe prova që i çmon të nevojshme. Nga njëra anë përbërja e KLD-së, ku 2/3 janë përfaqësues të gjyqësorit, dhe nga ana tjetër, funksionimi i tij mbi baza demokratike, e bëjnë këtë organ që të jetë objektiv dhe të marrë masa të drejta kur vërtetohen shkelje, si dhe të vihet në mbrojtje të gjyqtarëve ndaj akuzave të padrejta. Kështu që, për këtë organ pak rëndësi ka se kush bën propozimin. Jo vetëm kaq. Sipas nenit 16 shkronjës "ç" të ligjit për KLD-në, ky organ ka të drejtë dhe detyrë që të kryej verifikime për procedimin disiplinor të propozuar nga Ministri i Drejtësisë, në rastet kur çmohet dhe kërkohet nga KLD-ja. Në këto kushte KLD-ja ka dhe instrumentat e duhura, Inspektoriatin e tij, që të verifikojë çdo propozim që i vjen për procedimin disiplinor. Duke qenë kështu, fakti që sipas ligjit, Ministri ka të drejtë të kryej inspektime dhe në përfundim, kur vërteton shkelje që passjellin përgjegjësi disiplinore, të nis procedimin disiplinor, nuk përbën ndonjë zgjidhje me karakter antikushtetues, sepse nuk vjen në kundërshtim me nenet 7 e 145 të Kushtetutës.

**VGJK 24/2007:** Neni 147 i Kushtetutës ka parashikuar kompetencën e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që të ndërhyjë e të marrë masa për disiplinimin e gjyqtarëve në ato aspekte që lidhen me ushtrimin e funksioneve e ruajtjen e figurës së gjyqtarit. Por, ndërsa për largimin nga detyra Kushtetuta u ka dhënë të drejtë gjyqtarëve të ankohen në Gjykatën e Lartë, për masat e tjera disiplinore nuk përcakton organin ku ata mund të ankohen dhe as mënyrën e shqyrtimit të këtyre ankesave. Llojin dhe natyrën e masave disiplinore si dhe procedurën e marrjes së tyre Kushtetuta e ka lënë në vlerësim të ligjvënësit. Gjykata Kushtetuese, duke pranuar se "Kushtetuta nuk i ka lënë ndonjë hapësirë ligjvënësit që në kuptim të fuqizimit të standardit të mbrojtjes së gjyqtarëve, të përfshijë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë shqyrtimin e ankimit ndaj masave të tjera disiplinore"<sup>1</sup>, nuk ka konsideruar si të papajtueshëm me Kushtetutën shqyrtimin nga organe gjyqësore të ankesave të gjyqtarëve për masat disiplinore të dhëna nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

**VGJK 26/2007:** Gjykata Kushtetuese çmon të domosdoshme të nënvizojë faktin, se qëndrimi i mbajtur prej saj, për evidentimin e zgjerimit në mënyrë antikushtetuese dhe tej kuptimit të nenit 141 që ligjvënësi i kishte dhënë juridiksionit të Gjykatës së Lartë, nuk ka patur për qëllim mohimin e të drejtës së gjyqtarëve për t'u drejtuar gjykatës për masat e tjera disiplinore. Ajo është konsekuente në qëndrimin e saj lidhur me mos lejimin e tejkalimit të juridiksionit kushtetues të Gjykatës së Lartë, në funksion të standardit të

mbrojtjes së gjyqtarit. Për rastin konkret, Kushtetuta nuk jep hapësirë për të interpretuar në mënyrë të zgjeruar juridiksionin e Gjykatës së Lartë, por njëkohësisht as nuk e ndalon ligjvënësin, që nëpërmjet nxjerrjes së normave ligjore, të parashikojë hollësisht të gjitha elementet e domosdoshëm që lidhen me rastet e përgjegjësisë disiplinore, si dhe të procedurave që duhen ndjekur. Në nenin 147 të Kushtetutës parashikohen dy rregullime për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit, nga të cilat, në kuptim dhe në nenin 4 të saj, njëri zbatohet drejtpërdrejt, ndërsa tjetri të referon te zgjidhja diskrecionare e ligjvënësit. Nga mënyra e formulimit të nenit 147, pika 6 konkludohet se vetë Kushtetuta ka rregulluar çështjet që lidhen me largimin nga detyra të gjyqtarit si dhe ka njohur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë si organin kompetent që merret me shqyrtimin e këtij ankimi. Një formulimi i ndryshëm jepet në pikën 4 të këtij neni, sipas të cilit, “Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit”. Kushtetuta, nëpërmjet kësaj dispozite referuese e ka autorizuar ligjvënësin që mbi bazën e koncepteve dhe parimeve kushtetuese të caktojë kufijtë e hapësirës rregulluese për transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve nëpërmjet nxjerrjes së normave përkatëse juridike. Pikërisht mbi bazën e këtij interpretimi të dispozitës së sipërcituar, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se “*lloji dhe natyra e masave disiplinore si dhe procedura e marrjes së tyre janë brenda vullnetit të ligjvënësit, përjashtimisht masës së shkarkimit nga detyra për të cilën Kushtetuta ka parashikuar një rregullim të veçantë.*” Gjykata Kushtetuese i përmbahet konceptit se kushtetuta duhet interpretuar si një “instrument i gjallë” dhe, në mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe më efikas të mundshëm. Gjithashtu, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vendos mbi palët kontraktuese detyrimin për të organizuar sistemin gjyqësor në një mënyrë të tillë, që gjykatat e tyre të realizojnë parametrat e sanksionuar nga kjo dispozitë. Parimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e gjyqësorit kërkojnë gjithashtu ekzistencën edhe të mekanizmave që garantojnë realizimin efektiv të tyre. Kriteri i aksesit në gjykatë është i përmbushur në qoftë se vendimet e autoriteteve administrative i nënshtrohen kontrollit të organit gjyqësor të pajisur me juridiksion të plotë. E drejta e gjyqtarit për t’u drejtuar një autoriteti të pavarur, i cili ka në dispozicion mjetet për të rivendosur në vend të drejtat e procesit ligjor, ose pavarësinë e vet gjyqësorit, përbën një standard për funksionimin normal të shtetit të së drejtës.

**VGJK 29/2005:** Formulimi i kësaj dispozite përfshihet në ato raste përjashtimore kur normat kushtetuese nuk mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi në to është parashikuar mundësia e rregullimit të marrëdhënies përkatëse me anë të ligjit. Kjo dispozitë e Kushtetutës përmban elementet e një norme referuese, për shkak se mënyrën e transferimit të gjyqtarëve dhe përgjegjësinë e tyre disiplinore, ia ka deleguar ligjvënësit. Sipas dispozitës së sipërcituar, ligjvënësit i është dhënë e drejta që nëpërmjet ligjeve të rregullojë në mënyrë të hollësishme çështjet që përfshihen vetëm në këto dy drejtime të specifikuar. Është i ndryshëm formulimi i nenit 147, pika 6, në të cilin rezultojnë se Kushtetuta nuk e ka autorizuar ligjvënësin, por ka marrë përsipër ta rregullojë vetë si çështjen e objektit të ankimit ashtu edhe atë të organit kompetent që do të merret me shqyrtimin e tij. Në këtë mënyrë, kjo normë kushtetuese paraqitet si një dispozitë përjashtimore e kufizuese, dhe si e tillë, duhet interpretuar në mënyrë strikte. Kushtetuta, pa lënë shteg për mëdyshje, ka parashikuar se vetëm ankimi për masën e shkarkimit nga detyra të Këshillit të Lartë të Drejtësisë shqyrtohet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Mbështetur në kuptimin që del nga kjo analizë, Gjykata Kushtetuese çmon se neni 34, pika 1 e ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, që parashikon të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë ndaj çdo mase tjetër me karakter disiplinor, përbën tejkalim të përmbajtjes së dispozitës kushtetuese në dy drejtime, në aspektin e zgjerimit të masave të tjera disiplinore dhe në atë të tejkalimit të juridiksionit të Gjykatës së Lartë. ... Ndërsa, sa i përket dhënies së masave të tjera disiplinore, neni 147/4 i Kushtetutës ia ka deleguar kompetencat ligjvënësit të zakonshëm, për të parashikuar rastet dhe kriteret e zbatimit konkret të tyre. Në favor të këtij përfundimi flet edhe dispozita e nenit 46 të ligjit për pushtetin gjyqësor, e cila parashikon rastin e ankimit në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të shkarkimit nga detyra për një nga arsyet e parashikuara në Kushtetutë... Mbështetur në këto argumente, neni 34/1 i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, që zgjeron objektin e ankimit të gjyqtarëve për masat e tjera disiplinore si dhe juridiksionin e Gjykatës së Lartë, i ka kapërcyer caqet e vendosura nga Kushtetuta. Përderisa ndodhemi përpara një norme ligjore që nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet e specifikuar kushtetuese, por në tejkalime jashtëkushtetuese, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, Gjykata Kushtetuese çmon se është prekur parimi i hierarkisë së normave. Ky është një qëndrim i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese në disa çështje të tjera analoge, në të cilat ka theksuar se “*atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla ...*”

**VGJK 25/2007:** Gjykata Kushtetuese, në këtë vendim, ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë ka juridiksion të shqyrtojë vetëm vendimet që Këshilli i Lartë i Drejtësisë merr ndaj gjyqtarit për shkarkimin nga detyra (duke përjashtuar kështu juridiksionin e saj për masat e tjera disiplinore), duke u shprehur se: “Kushtetuta nuk i ka lënë ndonjë hapësirë ligjvënësit, që në kuptim të fuqizimit të standardit të mbrojtjes së gjyqtarëve, të përfshijë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë edhe shqyrtimin e ankimit ndaj masave të tjera disiplinore”. Çështja: nëse gjyqtarët duhet të gëzojnë të drejtën të ankohen kundër vendimeve që kanë për objekt masat e tjera disiplinore ndaj tyre. **Përgjigje:** kjo gjykatë në jurisprudencën e saj, është shprehur se “e drejta e prokurorëve për t’u ankuar buron nga Kushtetuta. Kushtetuta nuk përcakton për prokurorët ndonjë procedurë të veçantë gjykimi siç bën për gjyqtarët, por nuk i përjashton ata nga e drejta për t’u drejtuar gjykatës dhe për të kundërshtuar aktet administrative sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, ashtu siç e kanë këtë të drejtë të gjithë personat e tjerë fizikë e juridikë”. Duke mbajtur këtë qëndrim, Gjykata Kushtetuese ka bërë interpretimin e frymës së nenit 147/7 të saj dhe ka konkluduar se edhe gjyqtarët duhet ta gëzojnë patjetër të drejtën e ankimit kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

**VGJK 3/2006:** Gjykata Kushtetuese vlerëson se gjyqtari, për shkak të funksionit që ka, trajtohet nga Kushtetuta si funksion kushtetues. Si i tillë, ai gëzon përveç të tjerave, mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta. Kjo del qartë nga përmbajtja e dispozitës që parashikon shkarkimin e gjyqtarit, e cila është e ngjashme me atë të shkarkimit të zyrtarëve që ushtrojnë funksione të rëndësishme, duke përdorur të njëjtat standarte për këtë kategori funksionarësh shtetërorë. Megjithatë Kushtetuta ka parashikuar të njëjtin trajtim për këta funksionarë, një gjë e tillë nuk e kanë bërë ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve përkatëse. Konkretisht, për zyrtarët e parashikuar nga nenet 128 (gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese), 140 (gjyqtarët e Gjykatës së Lartë) dhe 149 (Prokurori i Përgjithshëm) të Kushtetutës, nuk është bërë asnjë formulim tjetër në ligjet organike të tyre. E kundërta ka ndodhur për gjyqtarët e

nivelit të parë dhe të dytë në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Nisur nga këto arsye, Gjykata Kushtetuese konstaton se Kushtetuta, nuk ka pasur për qëllim që të autorizojë ligjvënësin të parashikojë rastet e shkarkimit, pasi këtë ajo e ka bërë nëpërmjet nenit 147/6 të saj, sipas të cilit gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte a sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Ky togfjalësh i përdorur nga ligjvënësi, përforcon edhe më shumë qëndrimin e mbajtur nga kjo Gjykatë. Nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon se pika 6 e nenit 42 të ligjit për pushtetin gjyqësor që parashikon shkarkimin e gjyqtarit për shkelje të disiplinës është e papajtueshme me pikën 6 të nenit 147 të Kushtetutës dhe për këtë arsye, ajo duhet të shfuqizohet. Shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi si dhe organi që duhet ta marrë atë në shqyrtim, rregullohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Kjo përbën një garanci më shumë për gjyqtarët për shkak të funksionit që ata kryejnë dhe misionin që u ka ngarkuar shteti dhe shoqëria. Shkarkimi i gjyqtarit nga detyra sipas nenit 46/6 të ligjit, në referim të nenit 41, nuk përputhet me rastet konkrete të parashikuara nga neni 147/6. Parashikimi i shkarkimit nga detyra në të njëjtën dispozitë ligjore ku listohen edhe masat e tjera disiplinore, mënjanon aplikimin e nenit 147/6 të Kushtetutës si dhe shkakton antikushtetutshmëri në procedimin e gjyqtarëve. Shfuqizimi i kësaj dispozite nuk krijon boshllëk ligjor, sepse mund të zbatohet direkt rregullimi i nenit 147/6 të Kushtetutës. Në ndihmë të interpretimit të kësaj dispozite vjen edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e neneve 128, 140 e 149/2 të Kushtetutës, konkretisht i shprehjes “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë figurën”. Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se kjo shprehje, përmbledh në vetvete një sërë elementësh, të cilët mund të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Më tej, Gjykata Kushtetuese vazhdon me arsyetimin se ato janë të lidhura me akte e sjellje të parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj si dhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momenti subjektiv si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.

---

## PJESA E DHJETË

### PROKURORIA

#### Neni 148

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.
2. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar.
3. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.

#### Neni 149

1. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.
2. Prokurori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kuvendit, për shkelje të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit.
3. Prokurorët e tjerë emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm.
4. Prokurori i Përgjithshëm informon herë pas here Kuvendin për gjendjen e kriminalitetit.



---

**VGJK 75/2002:** Shprehja "shkelje e rëndë e ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve" nga Prokurori i Përgjithshëm, parashikuar nga neni 149, pika 2 të Kushtetutës lidhet me një sërë elementesh që kanë të bëjnë me ato shkelje të dispozitave ligjore të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj. Këto shkelje marrin karakterin e rëndë të tyre lidhur ngushtë me rëndësinë e ligjit të shkelur, me pasojat e ardhura, apo që mund të vinin nga shkelja, me frekuencën e shkeljes, kohëvazhdimin e pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe me qëndrimin subjektiv që mban autori i shkeljes kundrejt saj dhe pasojës së ardhur.

**VGJK 38/2003:** Natyra juridike e aktit përcaktohet në radhë të parë nga marrëdhënia që rregullon dhe nga lloji i veprimtarisë që ushtron organi që e nxjerr. Nga përmbajtja dhe fryma e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, del se veprimtaria e Presidentit të Republikës si kryetar shteti, ka elementë të tre pushteteve; legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor. Për këtë arsye Ai ka kompetencë të nxjerrë si akte që janë shprehje e drejtimit politik, ashtu edhe akte (dekrete) individuale që për nga natyra e tyre, afrojnë më shumë me veprimtarinë ekzekutive urdhërdhënëse të administratës shtetërore. Në aktet me karakter administrativ përfshihen edhe dekretet për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve, që mund të çënojnë të drejtat juridiko-civile të prokurorit. Duke pasur të tilla cilësi dekreti, ashtu siç është shprehur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.25, datë 13.02.2002, duhet të jetë objekt i ankimit dhe i shqyrtimit gjyqësor. Gjykata Kushtetuese çmon gjithashtu se e drejta e prokurorëve për t'u ankuar buron nga Kushtetuta. Kufizimi që i bëhet kësaj të drejte për shkak të përgjegjësisë së veçantë që ata kanë në mbrojtje të interesave publikë, nuk gjen mbështetje tek neni 17 i Kushtetutës. Edhe nga përmbajtja e nenit 148 të Kushtetutës, ku përcaktohen detyrat e prokurorisë për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzave në gjyq, etj., si dhe nga vetë kuptimi si organ i pavarur, del që prokurorëve duhet t'u jepen të drejta e garanci siç është edhe e drejta e ankimit ndaj masave që ata i konsiderojnë të padrejta.

---

## PJESA E NJËMBËDHJETË

### REFERENDUMI

#### Neni 150

1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë.

2. Kuvendi, me propozimin e jo më pak se një së pestës së deputetëve ose me propozimin e Këshillit të Ministrave, mund të vendosë që një çështje ose një projektligj i një rëndësie të veçantë të shtrohet në referendum.

3. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit, si dhe vlefshmëria e tij parashikohen me ligj.

#### Neni 151

1. Ligji i miratuar me referendum shpallet nga Presidenti i Republikës.

2. Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në asnjë referendum.

3. Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet përpara se të kenë kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

---

**VGJK 31/2003:** 1. Gjykata Kushtetuese vlerëson se shqyrtimi i kushtetutshmërisë së kërkesës për referendum, dikton nevojën e sqarimit të kushteve të përgjithshme që lidhen me institutin e referendumit në përgjithësi dhe atij shfuqizues në veçanti, në vështrim të nenit 151 të Kushtetutës. Në një vështrim të përgjithshëm, pozicioni i referendumit si mjet kushtetues është i lidhur me nocionin e sovranitetit të popullit (neni 2/1 i Kushtetutës), që ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij ose në mënyrë të drejtpërdrejtë (neni 2/2). Në këtë drejtim një rëndësi themelore merr çështja e përcaktimit të kushteve dhe rasteve, në të cilat, populli mund ta ushtrojë sovranitetin në mënyrë të drejtpërdrejtë. Sipas doktrinës, parimi i ushtrimit të sovranitetit nga populli, nënkupton një koncept demokratik sipas kriterëve të një demokracie përfaqësuese që përmban edhe elementë që mundësojnë ushtrimin direkt të demokracisë kushtetuese. Me këtë kuptohet që populli, të drejtën për të ushtruar funksion ligjvënës, normalisht, nuk e ushtron vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur prej tij. Demokracia përfaqësuese, historikisht, është konceptuar si formë e zakonshme e qeverisjes. Ajo është shprehje e demokracisë që mundëson shfaqjen e vullnetit të shumicës në formën e një akti që do t'i shërbejë interesit të përgjithshëm. Instrumentet e demokracisë direkte zenë vend në këtë vështrim, jo si pushtet konkurrues i organeve përfaqësuese, por si instrumente që mundësojnë mënjanimin e mungesës së veprimit nga ana e përfaqësuesve ose balancimin e kësaj mungese. Dispozitat e Kushtetutës lejojnë ushtrimin e sovranitetit të popullit nëpërmjet referendumeve, përderisa kjo nuk bie në kundërshtim me sistemin e procesit ligjvënës. Pra, edhe referendumit, si një nga instrumentet e demokracisë direkte, nuk përben alternativë ndaj procesit ligjvënës të parlamentit. Ai nuk mundëson bërjen e ligjeve, funksion i cili u është ngarkuar ekskluzivisht ligjvënësve. Në këtë mënyrë, referendumit paraqitet si mjet për integrimin dhe stimulimin e procesit ligjvënës në parlament, në rastet kur nuk gjen zbatim parimi i përputhjes së vullnetit të shumicës parlamentare me shumicën e popullit në një çështje konkrete. Pra, bëhet fjalë për një instrument që mundëson transmetimin e mendimit të zgjedhësve në drejtim të instancave politike. Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 152 të Kushtetutës, duhet të shqyrtojë kushtetutshmërinë e kësaj kërkesë në linjat që u parashtruan më sipër.

2. Lidhur me kushtetutshmërinë e referendumit, Gjykata duhet të verifikojë nëse, në rastin në shqyrtim, janë të pranishëm ndalime të atij lloji që parashikon neni 151 paragrafi 2 i Kushtetutës, gjë që bën të nevojshme interpretimin e kësaj dispozite. Më konkretisht, Gjykata duhet të verifikojë, nëse ligji i kërkuar për t'u hedhur në referendum me qëllim shfuqizimi, është nga ajo kategori ligjesh, për të cilat Kushtetuta nuk lejon ndërmarrjen e një procedure të tillë referendare. Dispozita kushtetuese e mësipërme përmend "Çështjet që lidhen me ... buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, ...", por nuk specifikon ligjet konkrete, që rregullojnë këto çështje. Gjykata Kushtetuese vlerëson se kuadri ligjor i financave publike, është kompleks dhe përfshin ligjet e buxhetit, të taksave e të detyrimeve financiare të shtetit. Këto ligje, për karakterin e fushave që mbulojnë dhe efektet që prodhojnë kanë një lidhje të ngushtë midis tyre. Përveç këtyre ligjeve, për të cilët parashikohet ndalim i shprehur kushtetues për t'u paraqitur në referendum, jurisprudenca ka identifikuar edhe ligje të tjera të cilët, nisur nga natyra dhe efektet që prodhojnë, kanë një lidhje të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë me çështjet e buxhetit, të taksave dhe të detyrimeve financiare të shtetit, për shkak të pasojave të ngjashme me ato që prodhojnë këto të fundit ( ndalime të nënkuptuara). Gjykata Kushtetuese vlerëson, se këtij përjashtimi kushtetues i nënshtrohet edhe ligji për sigurimet shoqërore. Për natyrën e tij, sistemi i sigurimeve shoqërore është një sistem "i hapur", gjë që nënkupton se ndryshimet në të janë jo vetëm të pranueshme por edhe të pashmangshme. Për pasojë, iniciativa e ligjvënësit në këtë fushë mbetet veçanërisht e gjërë. Faktorët që i nxisin këto ndryshime mund të jenë çështje me interes publik, si: përpjekja për ta bërë sa më të drejtë sistemin për të dy palët, përfitues dhe kontribues, situata financiare e buxhetit si dhe faktorë socialë. Pra, ndërhyrja në sistemin e sigurimeve shoqërore është kompetencë ekskluzive e ligjvënësit, por duke iu përmbajtur kufijve të Kushtetutës për respektimin e të drejtave themelore të shtetasve. Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa për referendum, për shfuqizimin e rregullimeve të reja të sigurimeve shoqërore, duhet të vlerësohet jokushtetuese.

Duke shqyrtuar dispozitat e ligjit të 1993 "Për sigurimet shoqërore" si dhe të ligjit "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit", Gjykata Kushtetues konkludon se ligji "Për sigurimet shoqërore" ka lidhje të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë me ligjin "Për buxhetin e shtetit" sa që shfuqizimi i dispozitave të kundërshtuara do të prishte ekuilibrin financiar të sistemit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore dhe do të prekte drejtpërdrejt buxhetin e shtetit...

---

## Neni 152

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruarra për referendum sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3 edhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 brenda 60 ditëve.

2. Rëndësia e çështjeve të veçanta, të parashikuara në nenin 150 paragrafët 1 e 2 nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.

3. Data e referendumit caktohet nga Presidenti i Republikës brenda 45 ditëve pas shpalljes së vendimit pozitiv të Gjykatës Kushtetuese ose pas kalimit të afatit brenda të

cilit Gjykata Kushtetuese duhet të shprehej. Gjatë vitit referendumet zhvillohen vetëm në një ditë.

## PJESA E DYMBËDHJETË

### KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

#### Neni 153

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është një organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe me referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

#### Neni 154

1. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët zgjidhen për një mandat 7-vjeçar. Dy anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, 2 nga Presidenti i Republikës dhe 3 anëtarë të tjerë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

2. Përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përtërihet çdo tre vjet sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

3. Anëtarësia në Komision nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore dhe politike.

4. Subjektet elektorale caktojnë përfaqësuesit e tyre pranë Komisionit. Ata nuk kanë të drejtë vote.

5. Anëtari i Komisionit gëzon imunitetin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

6. Komisioni ka buxhetin e vet.

## PJESA E TREMBËDHJETË

### FINANCAT PUBLIKE

#### Neni 155

Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese.

#### Neni 156

Shteti mund të marrë e të garantojë hua dhe kredi financiare, kur autorizohet me ligj.

#### Neni 157

1. Sistemi buxhetor përbëhet nga buxheti i shtetit dhe nga buxhetet vendore.
2. Buxheti i shtetit krijohet nga të ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera financiare, si dhe nga të ardhura të tjera të ligjshme. Ai përfshin të gjitha shpenzimet e shtetit.
3. Organet vendore caktojnë dhe mbledhin taksa dhe detyrime të tjera siç përcaktohet me ligj.
4. Organet e pushtetit qendror dhe atij vendor janë të detyruara t'i bëjnë publike të ardhurat dhe shpenzimet.

#### Neni 158

1. Kryeministri, në emër të Këshillit të Ministrave, i paraqet Kuvendit projektligjin për buxhetin e shtetit gjatë sesionit të vjeshtës, i cili nuk mund të mbyllet pa e miratuar atë.
2. Në qoftë se projektligji nuk arrin të miratohet deri në fillim të vitit të ardhshëm financiar, Këshilli i Ministrave zbaton çdo muaj një të dymbëdhjetën e buxhetit të vitit paraardhës, derisa të miratohet buxheti i ri.
3. Kuvendi miraton buxhetin e ri brenda 3 muajve nga dita e mbarimit të vitit të kaluar financiar, përveçse në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme.
4. Këshilli i Ministrave është i detyruar t'i paraqesë raport Kuvendit lidhur me zbatimin e buxhetit dhe me borxhin shtetëror për vitin e kaluar.
5. Kuvendi vendos përfundimisht pasi dëgjon edhe raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

#### Neni 159

Parimet dhe procedurat për hartimin e projektbuxhetit, si dhe për zbatimin e buxhetit përcaktohen me ligj.

#### Neni 160

1. Gjatë vitit financiar Kuvendi mund të bëjë ndryshime në buxhet.
2. Ndryshimet në buxhet bëhen sipas procedurës së parashikuar për hartimin dhe miratimin e vetë buxhetit.
3. Shpenzimet e parashikuara me ligje të tjera nuk mund të ulen sa kohë që këto ligje janë në fuqi.

#### Neni 161

1. Banka Qendrore e shtetit është Banka e Shqipërisë. Ajo ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës shqiptare, të zbatimit të pavarur të politikës monetare dhe të mbajtjes e të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë drejtohet nga një këshill, i cili kryesohet nga Guvernatori. Guvernatori zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## PJESA E KATËRMBËDHJETË

### KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

#### Neni 162

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Ai qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

#### Neni 163

Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon:

- a) veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë;
- b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor;
- c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

#### Neni 164

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:
  - a) raport për zbatimin e buxhetit të shtetit;
  - b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi;
  - c) informacion për rezultatet e kontroleve sa herë që kërkohet nga Kuvendi.
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij.

#### Neni 165

1. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ftohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur shqyrtohen çështje që lidhen me funksionet e tij.
2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

## PJESA E PESËMBËDHJETË

### FORCAT E ARMATOSURA

#### Neni 166

1. Shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë, siç parashikohet në ligj.

2. Shtetasi që, për arsye ndërgjegjeje, nuk pranon shërbimin me armë në forcat e armatosura, është i detyruar të kryejë një shërbim alternativ, siç parashikohet në ligj.

#### Neni 167

1. Ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti ose në veprimtari politike.

2. Pjesëtarët e forcave të armatosura ose personat që kryejnë shërbim alternativ, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

#### Neni 168

1. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga forcat tokësore, detare dhe ajrore.

2. Presidenti i Republikës është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

3. Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillimor i Presidentit të Republikës.

#### Neni 169

1. Presidenti i Republikës, në kohë paqeje, ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes.

2. Presidenti i Republikës, në kohe lufte, emëron dhe shkarkon Komandantin e Forcave të Armatosura me propozim të Kryeministrit.

3. Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, emëron dhe shkarkon Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, emëron dhe shkarkon komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore.

4. Kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ato të Komandantit të Forcave të Armatosura dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj.

## PJESA E GJASHTËMBËDHJETË

## MASAT E JASHTËZAKONSHME

### Neni 170

1. Masat e jashtëzakonshme mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe zgjatin për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje.

2. Parimet e veprimtarisë së organeve publike dhe shkalla e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, përcaktohen me ligj.

3. Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme.

4. Aktet që ndërmerren si pasojë e marrjes së masave të jashtëzakonshme, duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e rrezikut dhe duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për funksionimin normal të shtetit.

5. Gjatë gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohet asnjë prej këtyre akteve: Kushtetuta, ligjet për zgjedhjet për Kuvendin dhe për organet e pushtetit vendor, si dhe ligjet për masat e jashtëzakonshme.

6. Gjatë periudhës së zbatimit të masave të jashtëzakonshme nuk mund të zhvillohen zgjedhje vendore, nuk mund të zhvillohet referendum, si dhe nuk mund të zgjidhet një President i ri i Republikës. Zgjedhjet vendore mund të bëhen vetëm aty ku nuk zbatohen masat e jashtëzakonshme.

### Neni 171

1. Në rast agresioni të armatosur kundër Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, shpall gjendjen e luftës.

2. Në rast kërcënimesh të jashtme ose kur detyrimi për mbrojtje të përbashkët buron nga një marrëveshje ndërkombëtare, Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës, shpall gjendjen e luftës, vendos gjendjen e mobilizimit dhe të çmobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm.

### Neni 172

1. Në rastin e nenit 171 paragrafi 1, Presidenti i Republikës i paraqet Kuvendit dekretin për vendosjen e gjendjes së luftës brenda 48 orëve nga nënshkrimi i tij, duke specifikuar të drejtat që kufizohen.

2. Kuvendi merr në shqyrtim menjëherë dhe vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve për dekretin e Presidentit.

### Neni 173

1. Në rast rreziku për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike, Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit gjendjen e jashtëzakonshme, e cila zgjat për aq kohë sa vazhdon rreziku, por jo më shumë se 60 ditë.

2. Me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme ndërhyrja e forcave të armatosura bëhet me vendim të Kuvendit dhe vetëm kur forcat e policisë nuk janë në gjendje të rivendosin rendin.

3. Zgjatja e afatit të gjendjes së jashtëzakonshme mund të bëhet vetëm me pëlqim të Kuvendit çdo 30 ditë, për një periudhë jo më shumë se 90 ditë.

#### Neni 174

1. Për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose aksidenti teknologjik, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit.

2. Zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të bëhet vetëm me pëlqimin e Kuvendit.

#### Neni 175

1. Gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 15, 18, 19, 20, 21, 24, 25, 29, 30, 31, 32, 34, 39 paragrafi 1, 41 paragrafët 1, 2, 3 dhe 5, 42, 43, 48, 54, 55.

2. Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51.

3. Aktet për shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose të gjendjes së fatkeqësisë natyrore duhet të cilësojnë të drejtat dhe liritë që kufizohen sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

#### Neni 176

Kur Kuvendi nuk mund të mblidhet gjatë gjendjes së luftës, Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Ministrave, ka të drejtë të nxjerrë akte që kanë fuqinë e ligjit, të cilat duhet të miratohen nga Kuvendi në mbledhjen e tij më të parë.

### PJESA E SHTATËMBËDHJETË

### RISHIKIMI I KUSHTETUTËS

#### Neni 177

1. Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga jo më pak se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit.



2. Asnjë rishikim i Kushtetutës nuk mund të ndërmerret gjatë kohës kur janë vendosur masat e jashtëzakonshme.

3. Projekti miratohet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

4. Kuvendi mund të vendosë, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, që projektamendamentet kushtetuese të votohen me referendum. Projektligji për rishikimin e Kushtetutës hyn në fuqi pas ratifikimit me referendum, i cili bëhet jo më vonë se 60 ditë nga miratimi i tij në Kuvend.

5. Amendamenti kushtetues i miratuar i nënshtrohet referendumit, kur këtë e kërkon një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

6. Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim ligjin e miratuar nga Kuvendi për rishikimin e Kushtetutës.

7. Ligji i miratuar në referendum shpallet nga Presidenti i Republikës dhe hyn në fuqi në datën e parashikuar në këtë ligj.

8. Rishikimi i Kushtetutës për të njëjtën çështje nuk mund të bëhet përpara se të ketë kaluar një vit nga dita e rrëzimit të projektligjit në Kuvend dhe jo më përpara se të kenë kaluar 3 vjet nga dita e rrëzimit të tij në referendum.

## PJESA E TETËMBËDHJETË

### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 178

1. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar.

2. Këshilli i Ministrave i paraqet Kuvendit projektligjet e nevojshme për vënien në zbatim të kësaj Kushtetute.

#### Neni 179

1. Mandati i organeve kushtetuese që do të ekzistojnë me hyrjen në fuqi të kësaj Kushtetute mbaron me afatet e parashikuara në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse.

2. Anëtarët e Gjykatës së Kasacionit vazhdojnë veprimtarinë e tyre si anëtarë të Gjykatës së Lartë, sipas mandatit të mëparshëm.

3. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga radhët e prokurorëve zëvendësohen me anëtarë të rinj të zgjedhur nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve.

4. Organet e pushtetit vendor vazhdojnë veprimtarinë deri në mbarim të mandatit të tyre.

#### Neni 180

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute konsiderohen të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute.

2. Këshilli i Ministrave i paraqet Gjykatës Kushtetuese marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat përmbajnë dispozita që vijnë në kundërshtim me këtë Kushtetutë.

## Neni 181

1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.

---

**VGJK 30/2005:** Gjykata Kushtetuese thekson se neni 181 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përbën një dispozitë kalimtare, që përcakton detyrimin e Kuvendit për të normuar rregullimin e drejtë të çështjeve që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera përpara miratimit të kësaj Kushtetute. Kjo dispozitë kushtetuese ka për qëllim t'i hapë rrugën ligjvënësit për të ndrequr në afate të arsyeshme kohorë dhe brenda të gjitha mundësive që ka shteti, një padrejtësi që i është bërë shtresës së ish-pronarëve. Nga kjo pikëpamje, norma kushtetuese e sipërcituar, e cila nuk mund të ketë fuqi prapavepruese, përbën një orientim për ligjvënësin që çështjet e shpronësimeve dhe të konfiskimeve, t'i rregullojë pa tejkalluar kufizimet e lejueshme dhe duke respektuar standardet kushtetuese. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në disa vendime të saj, si para, ashtu dhe pas miratimit të Kushtetutës, problemin e të drejtës së pronës si edhe atë të kthimit e kompensimit të saj i ka trajtuar si çështje të rëndësishme të jurisprudencës kushtetuese. Çështjeve të tilla u është kushtuar një vemendje e posaçme edhe nga jurisprudenca evropiane. Duke iu referuar kësaj jurisprudence konstatohet se ajo, në çdo rast, ka mbështetur qëndrimin se e drejta për pronë, në kuptimin kushtetues dhe të rregullave të së drejtës ndërkombëtare, nuk identifikohet me rikthimin e pronës të marrë nga ana e regjimeve totalitare. Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave në vendet e tranzicionit paskomunist nuk bazohet në të drejtën e pronës, por në parimin e ndershmërisë dhe të drejtësisë dhe, për më tepër, në parimin e shtetit social.<sup>1</sup> Këtij qëndrimi i është përmbajtur përgjithësisht praktika e të gjithë vendeve që janë ndeshur me të njëjtin fenomen. "Parimi i drejtësisë kërkon që të merren në konsideratë jo vetëm interesat e ish-pronarëve dhe të trashëgimtarëve të tyre, por gjithashtu edhe ato të anëtarëve të tjerë të shoqërisë, si edhe interesi publik në tërësi. Kështu, parimi i drejtësisë dhe ai i proporcionalitetit, nuk kërkojnë ... të kthejnë të drejtat e pronësisë për të gjithë ish-pronarët a trashëgimtarët e tyre apo t'i kompensojë ata me vlerën e plotë."<sup>2</sup> Objektivi i kthimit të të drejtave të pronës nuk është fshirja e të gjitha padrejtësive, por zvogëlimi i tyre. Kthimi i të drejtave të pronës nuk duhet të shkaktojë padrejtësi të tjera.<sup>3</sup> Nga kjo pikëpamje, rregullimi i kthimit dhe kompensimit të pronës në origjinën e vet, synon të korrigjojë, për aq sa është e mundur "brenda mundësive dhe kushteve ekonomiko-sociale të vendit", padrejtësitë e regjimit të kaluar, të kryera në dëm të pronës private nëpërmjet shtetëzimeve, shpronësimeve, konfiskimeve ose me çdo mënyrë tjetër të padrejtë.<sup>4</sup> Në të gjitha qëndrimet e mbajtura në jurisprudencën kushtetuese evropiane, duke përfshirë këtu edhe atë shqiptare, konstatohet se, në respektim të parimit të drejtësisë dhe të shtetit social, nuk mund të vendosen detyrime për kompensimin tërësor të pronës së shpronësuar apo të shtetëzuar nga regjimet që nuk kanë respektuar standardet minimale të të drejtave të njeriut dhe se "rivendosja e plotë e të drejtave të mëparshme të pronësisë do të ishte në kundërshtim me vet parimin e barazisë."<sup>5</sup> ... Mbështetur te referimi në jurisprudencën kushtetuese shqiptare, në kuptimin e nenit 181 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në kuptimin e përmbajtjes së legjislacionit të nxjerrë nga ligjvënësi, pavarësisht nga veprimet e padrejta ose arbitrare që i janë bërë të drejtës së pronës nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore ose vendimeve gjyqësore, nxirret konkluzioni se pronarëve u humbi e drejta e pronësisë. Ky konkluzion përbën arsyen që këta persona, duke mos gëzuar në vijimësi pronat e tyre në cilësinë e pronarit kërkojnë që, nëpërmjet procedurës së kthimit dhe kompensimit të pronës, të rifitojnë këtë cilësi. Gjykata Kushtetuese vëren se mbajtja e një qëndrimi të kundërt, që parakupton njohjen e të drejtës së pronës, si një njohje e vazhdueshme dhe e pandërprerë e ekzistencës së saj, megjithë ligjet që e kanë ndryshuar regjimin e kësaj pronësie, vë në dyshim si qëllimin ashtu edhe vetë vlefshmërinë e ligjeve që janë nxjerrë për çështjen e kthimit dhe të kompensimit të pronave.

---

## Neni 182

Ligji nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si dhe ligjet e tjera kushtetuese shfuqizohen ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

## Neni 183

Kjo Kushtetutë hyn në fuqi me shpalljen nga Presidenti i Republikës.

Nr. 8417, Datë: 21.10.1998

Shpallur me Dekretin nr. 2260, datw 28.11.1998, tw Presidentit tw Republikws sw Shqipwrisw, miratuar nga populli me referendumin e datws 22 Nwntor 1998.

**Ndryshuar me ligjin nr.9094, datë 21.4.2008 Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar**

LIGJ

Nr.8577, datë 10.2.2000

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 6, 81, 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj përcakton rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, statusin e gjyqtarit, paraqitjen e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre, parimet dhe rregullat e gjykimit kushtetues, marrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre.

2. Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.

Neni 2

Funksioni i Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.

### Neni 3

#### Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.
2. Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi të plotë organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të caktuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj.

### Neni 4

#### Selia e Gjykatës Kushtetuese

Selia e Gjykatës Kushtetuese është në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

### Neni 5

#### Simbolet që vendosen në Gjykatën Kushtetuese

1. Në sallën e Gjykatës Kushtetuese vendoset Stema e Republikës së Shqipërisë, Flamuri Kombëtar dhe një pamje e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.
2. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjatë zhvillimit të seancës plenare, mban një veshje të veçantë; përshkrimi dhe forma e së cilës përcaktohet nga Gjykata Kushtetuese.

### Neni 6

#### Mjetet financiare

1. Gjykata Kushtetuese administron buxhetin e saj, i cili si pjesë e buxhetit të shtetit, hartohet prej saj dhe i paraqitet për miratim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
2. Në mjetet financiare përfshihet edhe çdo e ardhur tjetër që nuk është e ndaluar me ligj.
3. Llogaritë financiare të Gjykatës Kushtetuese kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

## KREU II

### ORGANIZIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

#### Neni 7

##### Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.
2. Gjyqtarët emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi, nga radhët e juristëve me kualifikim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion.
3. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet në një të tretën e saj, sipas procedurës së caktuar në këtë ligj.
4. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emërohet nga radhët e anëtarëve të saj nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit, për një periudhë prej 3 vjetësh, me të drejtë riemërimi brenda mandatit të gjyqtarit.

#### Neni 8

##### Fillimi i detyrës

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
2. Formula e betimit është: “Betohe se gjatë kryerjes së detyrave të mia do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë”.
3. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese fillon nga data e betimit dhe mbaron në datën e njëjtë të atij muaji, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.
4. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij.

#### Neni 9

##### Mbarimi i mandatit

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur:
  - a) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

- b) nuk paraqitet pa arsye në detyrë për më shumë se 6 muaj;
- c) mbush moshën 70 vjeç;
- c) jep dorëheqjen;
- d) me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i paafte për të vepruar.

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Kërkesa për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit bëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit emëron një gjyqtar të ri brenda 1 muaji, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.

#### Neni 10

##### Shkarkimi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohet nga Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paafësi mendore apo fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Vendimi i Kuvendit shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila kur vërteton se ekziston një nga shkaqet e mësipërme, deklaron shkarkimin nga detyra të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

2. Procedura e shqyrtimit të Kuvendit për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, fillon me kërkesë të motivuar të jo më pak se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

#### Neni 11

##### Drejtimi i Gjykatës Kushtetuese

Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese drejtohet dhe organizohet nga Kryetari i saj dhe, në mungesë të tij, nga njëri prej gjyqtarëve të caktuar prej tij, me përgjegjësi të rasteve kur në këtë ligj është përcaktuar në kompetencë të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

#### Neni 12

##### Kompetencat e Kryetarit

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ka këto kompetenca:

- a) Përgatit, thërret e drejton seancat plenare të Gjykatës Kushtetuese.
- b) Përfaqëson Gjykatën Kushtetuese në marrëdhënie me të tretët.

- c) Bashkërendon punën midis gjyqtarëve.
- ç) Nënshkruan aktet e Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të vendimeve që nënshkruhen nga të gjithë gjyqtarët.
- d) Emëron dhe largon nga detyra personelin administrativ, si dhe merr masa disiplinore ndaj tij.

#### Neni 13

##### Kompetencat e Mbledhjes së Gjyqtarëve

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka këto kompetenca:

- a) Përcakton drejtimet kryesore të shpenzimeve të mjeteve buxhetore.
- b) Informohet çdo 6 muaj me raporte për shpenzimet buxhetore.
- c) Vendos për strukturën organizative të Gjykatës Kushtetuese.
- ç) Vendos për numrin e personelit dhe pagat e tyre.
- d) Miraton rregulloren e brendshme për veprimtarinë e administratës së Gjykatës Kushtetuese.

#### Neni 14

##### Nëpunësit civilë

1. Nëpunësi më i lartë civil në Gjykatën Kushtetuese është Sekretari i Përgjithshëm.
2. Shërbimet e tjera të nevojshme për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese kryhen nga nëpunës dhe punonjës të tjerë.
3. Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga radhët e juristëve me përvojë profesionale.
4. Sekretari i Përgjithshëm drejton veprimtarinë administrative të Gjykatës Kushtetuese, nën autoritetin e Kryetarit të saj.
5. Të drejtat dhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve e punonjësve të tjerë të shërbimeve përcaktohen nga ky ligj dhe Rregullorja e Brendshme.
6. Punonjësit e administratës së Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen rregullave të shërbimit civil dhe trajtohen financiarisht njëjloj si punonjësit e administratës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 15



## Garantimi i rendit

1. Për mbajtjen e rendit dhe ruajtjen e saj, Gjykata Kushtetuese ka të drejtën e disponimit të forcave policore që vihen në shërbim të saj.

2. Numri dhe detyrat e këtyre forcave policore miratohen nga Ministri i Rendit Publik me propozimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

## KREU III

### STATUSI I GJYQTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

#### Neni 16

##### Imuniteti

1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë paprekshmëri për gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk mbajnë përgjegjësi ligjore për mendimet ose votën e shprehur për çështje në shqyrtim.

2. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ndiqet penalisht pa pëlqimin e Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të ndalohet ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

3. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që merret me shumicën e votave, duhet të jetë i arsyetuar. Gjyqtari, për të cilin kërkohet pëlqimi, pasi dëgjohet, nuk merr pjesë në votim.

#### Neni 17

##### Paga

1. Paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

2. Paga e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese është 20 për qind më e lartë se paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

3. Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ulen dhe as të preken.

#### Neni 18

Të drejta të tjera të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet:

a) të kenë një mbrojtje të veçantë të vetes, familjes dhe pronës, kur një gjë të tillë e kërkojnë vetë për rrethana serioze ose çmohet se është e domosdoshme. Organet përkatëse, të ngarkuara me ruajtjen e personaliteteve të larta, janë të detyruara t'i përgjigjen çdo kërkesë të bërë në këtë drejtim;

b) të përfitojnë leje të pagueshme vjetore 40 ditë. Leja vjetore bëhet gjatë muajit gusht-shtator;

c) të përfitojnë falas Fletoren Zyrtare, gazeta dhe revista juridike;

ç) të përfitojnë në mënyrë të barabartë po ato të drejta që gëzojnë deputetët, sipas neneve 16 pika 1, 19, 20, 23, 25 dhe 26 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit".

2. Koha e qëndrimit në detyrë e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e përmendura në Kushtetutë dhe në këtë ligj.

3. Në përfundim të mandatit, me përjashtim të rastit kur shkarkohet nga detyra sipas procedurave të përcaktuara në ligj, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese caktohet në një detyrë tjetër të barabartë ose të përafërt, si dhe përfiton pagesë kalimtare dhe/ose pension suplementar, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 19

Marrëdhëniet protokollare

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e saj kanë status të veçantë protokollar.

2. Në marrëdhëniet protokollare Kryetari i Gjykatës Kushtetuese vjen menjëherë pas Kryeministrit, ndërsa gjyqtarët e saj barazohen në trajtimin protokollar me ministrin.

3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese ftohen të marrin pjesë në delegacionet zyrtare, ceremonitë, pritjet dhe veprimtaritë e ndryshme të karakterit kulturor, shoqëror dhe sportiv, sipas protokollit të përcaktuar në këtë nen.

KREU IV

PARIME TË GJYKIMIT KUSHTETUES

Neni 20

Shqyrtimi kolegjal

Shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese bëhet kolegjisht. Vendimi merret vetëm nga ata gjyqtarë që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes.

Neni 21

Procesi publik

1. Shqyrtimi i çështjeve në seancë plenare nga Gjykata Kushtetuese bëhet i hapur.
2. Gjykata Kushtetuese mund ta përjashtojë publikun nga seanca plenare ose një pjesë të tij, me arsyetimin e mbrojtjes së moralit publik, të rendit publik, të sigurisë kombëtare, të së drejtës së jetës private ose të së drejtave vetjake.

Neni 22

Përdorimi i gjuhës shqipe

1. Në shqyrtimin e çështjeve përdoret gjuha shqipe.
2. Pjesëmarrësit në gjykim, që nuk dinë gjuhën shqipe, përdorin gjuhën e tyre. Ata marrin dijeni për të gjithë zhvillimin e procesit me anë të përkthyesit, që si rregull sigurohet nga Gjykata Kushtetuese.

Neni 23

Procesi gojor

Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare bëhet gojarisht ose mbi bazë dokumentash, sipas natyrës së çështjes.

Neni 24

Mbrojtja në gjykimin kushtetues

Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues mbrohen vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit, në mënyrën e parashikuar në këtë ligj.

Neni 25

Paanësia në gjykimin kushtetues

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e çështjeve është i paanshëm dhe bazohet në kryerjen e detyrave të tij vetëm në Kushtetutë dhe në ligj.

2. Në veprimtarinë e tij, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese merr pjesë me cilësinë e tij vetjake dhe nuk përfaqëson asnjë organ shtetëror, organizatë shoqërore, parti ose shoqatë politike, grup etnik ose social.

Neni 26

Publikimi i vendimit përfundimtar

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare. Ato botohen në Fletoren Zyrtare dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit të saj. Kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e tij.

2. Organi që boton Fletoren Zyrtare detyrohet të bëjë botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 15 ditë nga ardhja për botim e tyre pranë atij organi.

3. Gjykata Kushtetuese çdo vit përgatit një përmbledhje të vendimeve të saj.

KREU V

PARAQITJA DHE SHQYRTIMI PARAPRAK I KËRKESËS

Neni 27

Regjistrimi i kërkesës

1. Kërkesa që drejtohet në Gjykatën Kushtetuese regjistrohet menjëherë në regjistrin e posaçëm që mban kryesekretaria e Gjykatës Kushtetuese.

2. Kërkesa i dorëzohet Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili cakton një relator që përgatit çështjen për shqyrtimin paraprak të saj.

Neni 28

Përmbajtja e kërkesës

1. Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese paraqitet në formë të shkruar në gjuhën shqipe, qartë e kuptueshëm, në aq kopje sa

janë pjesëmarrësit dhe duhet të përmbajë:

- a) emrin e gjykatës përpara të cilës paraqitet;
  - b) emrin, mbiemrin (emërtimin), vendbanimin ose vendqëndrimin e kërkuarit;
  - c) emrin, mbiemrin (emërtimin), vendbanimin ose vendqëndrimin e subjekteve të interesuara;
  - ç) objektin e kërkesës;
  - d) përmbajtjen e kërkesës dhe parashtrimin e shkaqeve;
  - dh) treguesin e dokumenteve dhe mjeteve të tjera provuese që shoqërojnë kërkesën;
  - e) nënshkrimin e kërkuarit ose të përfaqësuesit të tij.
2. Kërkesa u njoftohet palëve në gjykim.

Neni 29

Dokumente që i bashkëlidhen kërkesës

1. Sipas rastit, kërkesës i bashkëlidhen këto dokumente:
  - a) Akti i përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi.
  - b) Kopje të aktit që është objekt i kërkesës.
  - c) Dokumente origjinale ose të noterizuara, ose prova shkresore që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.
2. Kopje të aktit, të dokumentit ose të provave shkresore paraqiten në numër sa janë pjesëmarrësit në gjykim, që t'u njoftohen atyre.

Neni 30

Afati i paraqitjes së kërkesës

1. Për paraqitjen e kërkesës para Gjykatës Kushtetuese zbatohen afatet e përcaktuara në këtë ligj.
2. Kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes. Kur në bazë të ligjit individ mund t'i drejtohet një organi tjetër, ai mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në këtë rast, afati i paraqitjes së kërkesës është 2 vjet nga data e njoftimit të vendimit të organit përkatës shtetëror.

## Neni 31

### Shqyrtimi paraprak i kërkesës

1. Kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji i përbërë nga 3 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori.
2. Kur kërkesa, megjithëse është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, nuk është e plotë, kolegji ia kthen kërkesit për plotësim, duke treguar shkaqet e kthimit dhe afatin e plotësimit të saj. Pas kësaj, kur kërkesa paraqitet e plotësuar, kalon përsëri për shqyrtim paraprak në kolegji. Kërkesa e paplotësuar nuk merret në shqyrtim.
3. Kur kërkesa është paraqitur nga subjekti që legjitimohet dhe çështja është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, kolegji vendos kalimin e çështjes në seancë plenare, ndërsa kur ajo nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet ose çështja nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, kolegji vendos moskalimin e çështjes në seancë plenare. Në të gjitha rastet, kur ndonjë nga gjyqtarët e kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve, e cila vendos me shumicë votash për kalimin ose jo të çështjes në seancë plenare.
4. Në të gjitha rastet e mësipërme, kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve nuk shqyrton zgjidhjen në themel të çështjes.
5. Për ankesat, lutjet dhe çdo korrespondencë tjetër që nuk përmban elementet e kërkesës, në kuptim të nenit 28 të këtij ligji, veprohet administrativisht.

## KREU VI

### FUNKSIONIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

## Neni 32

### Shqyrtimi në seancë plenare

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton çështjen në seancë plenare.
2. Në seancë plenare marrin pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë rast jo më pak se dy të tretat e tyre.

## Neni 33

### Thirrja dhe drejtimi i seancës plenare

1. Seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese e thërret dhe e drejton Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.
2. Me miratimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, seancën plenare mund ta thërrasë dhe ta drejtojë një gjyqtar i saj.

#### Neni 34

Të drejtat e gjyqtarit në gjykimin kushtetues

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë:

- a) të marrë pjesë në shqyrtimin e çdo çështjeje, me përjashtim të rasteve kur ndalohej nga ligji;
- b) të njihet me përmbajtjen dhe gjithë materialet e çështjes në shqyrtim;
- c) gjatë shqyrtimit, t'u drejtojë pyetje e të kërkojë shpjegime nga pjesëmarrësit në gjykim, si dhe nga personat e thirrur si dëshmitarë ose ekspert;
- ç) të marrë pjesë në bisedimet përfundimtare dhe të shfaqë lirisht mendimin e tij për mënyrën e përfundimit të çështjes që shqyrtohet.

#### Neni 35

Detyrat e gjyqtarit në gjykimin kushtetues

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese duhet:

- a) të përgatisë çështjen për gjykim, si dhe të marrë masat e duhura për zhvillimin e seancës plenare;
- b) të votojë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes;
- c) të ruajë sekretin e diskutimeve dhe të votimit.

#### Neni 36

Heqja dorë nga shqyrtimi i çështjes

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese është i detyruar të heqë dorë nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete kur:

- a) ka marrë pjesë në hartimin e aktit objekt shqyrtimi;
- b) për shkak të lidhjeve fisnore apo lidhjeve të tjera me pjesëmarrësit në gjykim vihet në dyshim objektiviteti i tij;
- c) në çdo rast tjetër kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie.

2. Heqja dorë miratohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, derisa çështja nuk ka kaluar në seancë plenare. Më pas, heqja

dorë vendoset me shumicën e votave të gjyqtarëve pjesëmarrës në proces.

Neni 37

Përgjashtimi i gjyqtarit

1. Pjesëmarrësit në gjykim kanë të drejtë të kërkojnë përgjashtimin e gjyqtarit në çdo fazë të zhvillimit të gjykimit kur ekziston një nga rastet e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji dhe gjyqtari nuk heq dorë nga shqyrtimi i çështjes.

2. Për përgjashtimin e gjyqtarit vendos shumica e gjyqtarëve që marrin pjesë në shqyrtimin e çështjes. Gjyqtari, për të cilin kërkohet përgjashtimi, pasi dëgjohej nuk merr pjesë në votim. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, gjyqtari quhet i përgjashtuar.

Neni 38

Njoftimi dhe pjesëmarrja në seancë plenare

1. Për orën dhe datën e zhvillimit të seancës plenare duhet të njoftohet kërkuesi, subjekti i interesuar ose përfaqësuesit e tyre.

2. Njoftimi bëhet nga kryesekretaria e Gjykatës Kushtetuese të paktën 10 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare.

3. Njoftimi bëhet me shkresë zyrtare, me fletë-thirrje postare dhe në raste të ngutshme me telegram ose me faks, që i dorëzohen palëve ose anëtarëve madhorë të familjes. Kur ndonjë nga pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues nuk i dihet vendqëndrimi ose ndodhet me qëndrim të përhershëm jashtë shtetit, njoftimi bëhet me shpallje në selinë e Gjykatës Kushtetuese, të paktën 1 muaj përpara datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare.

4. Në seancë plenare marrin pjesë kërkuesi, subjekti i interesuar, përfaqësuesit e tyre dhe dëshmitarët ose ekspertët kur ka të tillë.

5. Mungesa e njoftimit shkakton shtyrjen e seancës plenare, duke caktuar një datë tjetër për zhvillimin e saj, si dhe duke bërë njoftimet përkatëse.

6. Kur kërkuesi, subjekti i interesuar ose përfaqësuesit e tyre, megjithëse janë njoftuar, nuk paraqiten në seancë plenare dhe për këtë nuk kanë paraqitur shkaqe të përligjura, seanca plenare zhvillohet në mungesë.

Neni 39

Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues

1. Pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë:

a) Subjekti që ka paraqitur kërkesën ose përfaqësuesi i tij.



b) Subjektet kundër të cilëve është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtëpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet.

c) Organi që ka nxjerrë aktin.

ç) Organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje për kompetencë.

2. Në rastet kur pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë organe shtetërore, ato përfaqësohen nga drejtuesit e tyre dhe në mungesë nga persona të autorizuar me shkrim.

3. Përfaqësues të pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues mund të jenë avokatët, të cilët pajisen me prokurë ose caktohen si të tillë me deklaram në seancë plenare.

4. Dhoma Kombëtare e Avokatisë cakton listën e avokatëve që mund të marrin pjesë në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 40

Thirrja e ekspertit

1. Me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të thërrasë me cilësinë e ekspertit persona që kanë njohuri të posaçme në fushën e shkencës, teknikës ose artit për konstatimin dhe sqarimin e fakteve që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.

2. Eksperti e jep mendimin e tij me shkrim, por mund të dëgjohet edhe në seancë plenare.

Neni 41

Thirrja e dëshmitarit

Kur shihet e domosdoshme për sqarimin e fakteve që lidhen me çështjen në shqyrtim, me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të thërrasë e të pyesë në seancë plenare persona me cilësinë e dëshmitarit.

Neni 42

Kërkimi i dokumenteve

1. Kur shihet e domosdoshme, me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të kërkojë dokumente të cilat kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.

2. Dokumentet e kërkuara administrohen në seancë plenare.

#### Neni 43

##### Zhvillimi i seancës plenare

Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare ndjek këto rregulla:

- a) Deklarohet çelja e seancës plenare nga kryesuesi i saj.
- b) Verifikohet paraqitja e pjesëmarrësve.
- c) Verifikohet legjitimiteti i pjesëmarrësve ose i përfaqësuesve të tyre.
- ç) Pyeten pjesëmarrësit nëse kanë kërkesa paraprake dhe vendoset për to.
- d) Lexohet kërkesa nga gjyqtari relator.
- dh) Ftohen pjesëmarrësit të parashetrojnë kërkesat dhe kundërshtimet, duke filluar nga subjekti që ka paraqitur kërkesën.
- e) Pjesëmarrësit në proces japin shpjegime ose bëjnë sqarime për pyetjet e gjyqtarëve.
- ë) Administrohen provat dhe ftohen pjesëmarrësit të japin mendime për përmbajtjen e tyre.
- f) Ftohen pjesëmarrësit të bëjnë kërkesat përfundimtare.
- g) Deklarohet nga kryesuesi mbyllja e seancës plenare dhe tërheqja për vendim.

#### Neni 44

##### Riçelja e seancës plenare

1. Nëse pas mbylljes të seancës plenare çmohet e domosdoshme sqarimi i rrethanave plotësuese, të cilat kanë rëndësi të veçantë për çështjen në shqyrtim, vendoset riçelja e saj.

2. Vendimi për riçeljen e seancës plenare merret me shumicë votash nga gjyqtarët që kanë qenë të pranishëm në seancën plenare.

3. Vendimi për riçeljen e seancës plenare u njoftohet pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në të dhe t'u jepet fjala nëse e kërkojnë, për të bërë shpjegime që i çmojnë në interes të tyre.

#### Neni 45

##### E drejta për pezullim

1. Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi.

2. Vendimi për masën e pezullimit i njoftohet organit përkatës që ka nxjerrë ligjin ose aktin, si dhe bëhet publikimi i tij.

3. Gjykata Kushtetuese në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes, me vendim në seancën plenare, mund të heqë masën e pezullimit.

4. Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet në vendimin përfundimtar për vazhdimësinë ose jo të masës së pezullimit.

Neni 46

Procesverbali i seancës plenare

Në seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese mbahet procesverbal, i cili, në përfundim të saj, nënshkruhet nga kryesuesi i seancës plenare dhe sekretari që e mban atë.

Neni 47

Afati i fillimit të shqyrtimit të çështjes

Shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën Kushtetuese duhet të fillojë jo më vonë se 2 muaj nga paraqitja e kërkesës.

Neni 48

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes

1. Kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të.

2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe akteve të tjera normative, vendos për çdo rast Gjykata Kushtetuese.

KREU VII

PROCEDURAT E VEÇANTA

Procedura për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjeve

ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën dhe

me marrëveshjet ndërkombëtare

Neni 49

1. Për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit, të jo më pak se një të pestës të deputetëve dhe të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Këtë të drejtë e kanë edhe Avokati i Popullit, organet e qeverisjes vendore, organet e bashkësive fetare, partitë politike, si dhe organizatat e tjera, vetëm kur argumentojnë se çështja lidhet me interesat e tyre.

Neni 50<sup>12</sup>

---

<sup>12</sup> **VGJK 29/2006:** Afati tre vjeçar i parashkrimit për të kërkuar kontrollin kushtetues të një ligji, që parashikohet në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH”, zbatohet në rastet kur subjektet përkatëse kanë kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit në kuptimin abstrakt. Çështja ndryshon kur dy organe kanë mosmarrëveshje për një kompetencë konkrete, e cila mund të lindë në çdo kohë. Me fjalë të tjera, nëse mosmarrëveshja e kompetencës buron nga ligji, kjo nuk do të thotë se vepron në mënyrë të vetvetishme parashkrimi tre vjeçar. Në mosmarrëveshjen me palë kundërshtare që pretendojnë të njëjtën kompetencë nuk mund të ketë parashkrim në raport me ligjin. Në të kundërt, do të pranohej se shteti është i pafuqishëm të zgjidhë konfliktet e brendshme dhe se ai nuk ka asnjë mundësi të shpëtojë nga funksionimi antikushtetues i tij. Ky lloj qëndrimi brenda shtetit, për shkak të kalimit të afatit, nuk mund të gjejë mbështetje kushtetuese. Arsyeja është sepse veprimtaria shtetërore nuk mund të lihet të devijojë në mënyrë antikushtetuese. Përndryshe, do të ndodheshim para situatave kur mosmarrëveshja e lindur për shkak të ligjit *de jure* do të parashkruhej brenda tre vjetëve nga miratimi i tij, ndërkohë që mosmarrëveshja e lindur *de facto* jo. Pikërisht për këtë arsye, në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, procedurat që parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës janë formuluar ndryshe nga procedurat e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Afati gjashtë mujor që parashikon neni 55 i këtij ligji lidhet me çastin e lindjes së konfliktit dhe jo me kohën e hyrjes në fuqi të ligjit burim konflikti. Prandaj, argumenti i subjektit të interesuar nuk mund të përbëjë kurrësi zgjidhje kushtetuese të çështjes.

Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre.

#### Neni 51

Gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49 e 50 të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese vlerëson:

përbajtjen e ligjeve dhe të akteve normative;

formën e ligjeve dhe të akteve normative;

c) procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre.

Procedurat mbi pajtueshmërinë e marrëveshjeve

ndërkombëtare me Kushtetutën

#### Neni 52

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit.

2. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje për shqyrtimin e këtyre çështjeve vetëm pasi bëhet kërkesë nga subjektet e parashikuara në nenin 134 shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç” të Kushtetutës, si dhe nga subjektet e parashikuara në shkronjat “dh”, “e”, “ë” e “f” të Kushtetutës, për çështje që lidhen me interesat e tyre.

3. Në rast se çështja ka kaluar në seancë plenare, pezullohen procedurat për ratifikimin e marrëveshjes. Shqyrtimi i kërkesës përfundon brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së saj.

4. Në rast se Gjykata Kushtetuese vendos papajtueshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare me Kushtetutën, ajo nuk mund të ratifikohet.

#### Neni 53

1. Marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe që janë të papajtueshme me të, mund të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese vetëm nga Këshilli i Ministrave.

2. Në rast se Gjykata Kushtetuese konstaton se marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar me ligj përmban dispozita që bien në kundërshtim me Kushtetutën, ajo vendos shfuqizimin e aktit të ratifikimit të saj.

Procedurat lidhur me mosmarrëveshjet e kompetencave

#### Neni 54

1. Në mbështetje të nenit 131 shkronja “ç” të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese shqyrton konfliktet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore dhe kur mosmarrëveshja ka lidhje të drejtëpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

2. Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim këto konflikte kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete dhe sipas rastit kanë nxjerrë aktet për rregullimin e saj ose kur subjektet nuk e kanë konsideruar veten kompetente të vendosin në raste të veçanta.

3. Kërkesa para Gjykatës Kushtetuese ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cënuara drejtëpërdrejt nga konflikti.

4. Çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore, që kanë çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre, përbëjnë bazat për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve.

#### Neni 55

Kërkesa për shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve paraqitet brenda 6 muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

#### Neni 56

1. Gjykata Kushtetuese vendos se cili organ i pushtetit ka në kompetencë të tij zgjidhjen e çështjes konkrete, për të cilën ka lindur mosmarrëveshja .

2. Kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes shqyrton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit.

Procedura për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së partive

dhe të organizatave të tjera politike

#### Neni 57

1. Për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit dhe të jo më pak se një të pestës së deputetëve.

2. Kërkesa mund të paraqitet në çdo kohë në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 58

Gjykata Kushtetuese shqyrton dhe vendos:

- a) nëse partia ose organizata politike është krijuar në përputhje me dispozitat kushtetuese;
- b) nëse veprimtaria e partisë ose e organizatës politike përputhet me Kushtetutën.

Neni 59

Kur Gjykata Kushtetuese çmon se ka të dhëna që veprimtaria e mëtejshme e një partie ose organizate politike cenon rendin kushtetues ose interesat shtetërorë apo publikë, sipas rastit, me vendim të veçantë të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare, mund të vendosë pezullimin e veprimtarisë së partisë ose të organizatës politike deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Neni 60

1. Kur Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se krijimi i një partie ose organizate politike vjen në kundërshtim me Kushtetutën, ajo shfuqizon aktin e krijimit.

2. Kur Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se veprimtaria e një partie ose organizate politike vjen në kundërshtim me Kushtetutën, ajo vendos sipas rastit ndalimin e kësaj veprimtarie ose urdhëron çregjistrimin e saj.

Procedurat për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës

dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij

Neni 61

1. Gjykata Kushtetuese për deklarimin e shkarkimit të Presidentit të Republikës vihet në lëvizje me vendimin e Kuvendit që ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra.

2. Vendimi i Kuvendit duhet të përmbajë një përshkrim të argumentuar të shkeljes së rëndë të Kushtetutës ose të krimit të rëndë, si dhe të shoqërohet me provat përkatëse.

3. Gjykata Kushtetuese, një kopje të vendimit të Kuvendit dhe të provave përkatëse, ia dërgon Presidentit të Republikës, i cili ka të drejtë të japë me shkrim sqarimet që i çmon të nevojshme.

Neni 62

1. Gjykata Kushtetuese për kalimin e çështjes në seancë plenare vendos me shumicën e anëtarëve të saj.
2. Në seancën plenare ka të drejtë të jetë i pranishëm Presidenti i Republikës ose një përfaqësues i tij.

#### Neni 63

1. Kur Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë Kushtetutën ose ka kryer një krim të rëndë, deklaron shkarkimin e tij nga detyra. Në të kundërt, Gjykata Kushtetuese shfuqizon vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

2. Rregullat e përcaktuar në nenin 61 pikat 1, 2 dhe 3 zbatohen edhe në rastin e vërtetimit përfundimisht të faktit të pamundësisë së ushtrimit të detyrës nga Presidenti i Republikës. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese vendos vërtetimin e faktit të pamundësisë për ushtrimin e detyrës ose rrëzon kërkesën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kur ajo nuk gjendet e bazuar.

Zgjedhshmëria dhe papajtueshmëria me ushtrimin

e funksioneve të Presidentit të Republikës

#### Neni 64

1. Për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë e Presidentit të Republikës dhe për papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të tij, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të jo më pak se një të pestës së deputetëve ose të partive politike.

2. Në rastin e zgjedhshmërisë, Gjykata Kushtetuese vendos shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ose rrëzimin e kërkesës.

3. Në rastin e papajtueshmërisë për ushtrimin e detyrës, Gjykata Kushtetuese vendos deklarimin e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës ose rrëzimin e kërkesës.

#### Neni 65

Kur Presidenti i Republikës jep dorëheqjen gjatë kohës që çështja për shkarkimin e tij është në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese ose mandati i tij përfundon, Gjykata Kushtetuese pushon procedimin e mëtejshëm. Gjykata Kushtetuese i rifillon procedurat kur kjo kërkohet nga Kuvendi ose nga ai vetë.

Procedura për shqyrtimin e zgjedhshmërisë

dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të deputetit



#### Neni 66

1. Për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës ose të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

2. Gjykata Kushtetuese verifikon zgjedhjen e deputetëve me kërkesë të partisë politike ose të kandidatit për deputet të pavarur, duke zbatuar në këtë rast edhe dispozitat ligjore për zgjedhjet e përgjithshme.

3. Kërkesa për papajtueshmëri mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese nga Kuvendi, përsa kohë vazhdon mandati i deputetit, ndërsa kërkesa për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve mund të paraqitet brenda 6 muajve nga konstatimi i faktit të pazgjedhshmërisë.

#### Neni 67

1. Në rastet kur Gjykata Kushtetuese verifikon zgjedhshmërinë e deputetëve, ajo vendos, sipas rastit, rrëzimin e kërkesës ose shfuqizimin e aktit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës për zgjedhshmërinë ose papajtueshmërinë e deputetit, Gjykata Kushtetuese, vendimin e saj ia dërgon Kuvendit.

Procedurat e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së ligjeve

të kërkuara nga gjykatat

#### Neni 68

1. Kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit.

2. Në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat konkrete ose parimet e tjera të Kushtetutës, të cilat ligji nuk i ka respektuar ose i ka cënuar, si dhe shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i tij.

#### Neni 69

1. Gjykata Kushtetuese, kur konstaton se çështja nuk është e plotë dhe në përputhje me nenin 68 të këtij ligji, ia kthen atë gjykatës që e ka dërguar. Kjo e fundit detyrohet të plotësojë materialet brenda 1 muaji nga data e mbërritjes.

2. Kur materialet e dosjes janë të plota dhe në përputhje me nenin 68, Gjykata Kushtetuese cakton datën e seancës për

shqyrtimin e çështjes, duke njoftuar gjykatën dhe thirrur subjektet e interesuara.

#### Neni 70

1. Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjeve të parashikuara në nenet 68 e 69 të këtij ligji dhe për arsye që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e një ligji konkret, publikon faktin se çështja është nën shqyrtimin e saj.

2. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes materialet, së bashku me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, i dërgohen gjykatës konkrete.

3. Në rastet kur Gjykata Kushtetuese e shfuqizon ligjin si antikushtetues, vendimin e saj ia njofton Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave.

#### Interpretimi i Kushtetutës

#### Neni 71

1. Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të paragrafit 1 të nenit 124 të Kushtetutës bën interpretimin përfundimtar të saj.

2. Kërkesën për interpretim të Kushtetutës kanë të drejtë ta paraqesin subjektet e përmendura në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të paragrafit 1 të nenit 134 të Kushtetutës, ndërsa subjektet e tjera që përmenden në shkronjat “dh”, “e”, “ë” dhe “f”, vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

3. Në kërkesën e paraqitur duhet të saktësohet se cila dispozitë apo pjesë e saj kërkohet të interpretohet.

4. Subjekti, që pretendohet se e ka interpretuar gabim Kushtetutën, është gjithashtu palë në gjykim.

5. Shqyrtimi i kërkesave të tilla mund të bëhet në seancë plenare edhe mbi shqyrtimin e dokumenteve.

### KREU VIII

#### VENDIMET E GJYKATES KUSHTETUESE

#### Neni 72

#### Marrja e vendimit dhe shpallja e tij

1. Bisedimet si dhe votimi i vendimit bëhen pa praninë e personave të tjerë.

2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Abstenimi nuk lejohet.

3. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në shqyrtimin e çështjes.
4. Për shpalljen e vendimit njoftohen pjesëmarrësit në proces. Mungesa e tyre nuk pengon shpalljen e tij.
5. Vendimi jepet “Në Emër të Republikës së Shqipërisë”.
6. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese shpallet i arsyetuar dhe lexohet nga kryesuesi i seancës ose nga një gjyqtar i caktuar prej tij.
7. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe është përfundimtar.
8. Gjyqtari që mbetet në pakicë ka të drejtë të arsyetojë mendimin e tij që i bashkohet vendimit dhe botohet bashkë me të.
9. Kopje të vendimit mund t’u jepen pjesëmarrësve në proces me kërkesën e tyre, kundrejt tarifës së caktuar.

#### Neni 73

##### Shtyrja e bisedimit dhe votimit

1. Kur ndonjëri prej gjyqtarëve që ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes mungon në bisedime ose në votim, Mbledhja e Gjyqtarëve nuk zhvillohet dhe shtyhet për një datë tjetër.
2. Në qoftë se edhe pas kësaj, pjesëmarrja e gjyqtarit nuk mund të sigurohet brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vendos përfundimisht për çështjen, kur formohet shumica absolute e anëtarëve të saj.
3. Në rast se kjo shumicë nuk formohet dhe ekziston mundësia për përfshirjen në këtë gjykim të gjyqtarëve të tjerë, që më parë nuk kanë marrë pjesë në të, seanca riçelet dhe shqyrtimi i çështjes fillon nga e para.

#### Neni 74

##### Refuzimi i kërkesës

Kur gjatë votimit votat ndahen në mënyrë të barabartë ose në atë mënyrë që asnjë përfundim i çështjes nuk votohet nga shumica e kërkuar, Gjykata Kushtetuese vendos refuzimin e kërkesës. Refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuesi të riparqesë kërkesën në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

#### Neni 75

##### Mosndryshimi i vendimit

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, pas votimit, konsiderohet i marrë dhe nuk mund të ndryshohet.

## Neni 76

### Efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi.

2. Vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm:

a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar;

b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë;

ç) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar.

## Neni 77

### Efektet juridike të vendimeve gjyqësore

Vendimet e gjykatave të çdo shkalle, të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike nga çasti i marrjes së tyre. Çështja i dërgohet për shqyrtim gjykatës, vendimi i të cilës është shfuqizuar.

## Neni 78

### Njoftimi i vendimit

Kur vendoset shfuqizimi i ligjit ose aktit dhe marrëdhëniet e lindura kërkojnë rregullim juridik, vendimi i Gjykatës Kushtetuese i njoftohet organeve përkatëse që të marrin masat e parashikuara në vendimin e saj.

## Neni 79

### Vendimi interpretues

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që bën interpretimin e Kushtetutës ka fuqi prapavepruese.

Neni 80

Interpretimi dhe plotësimi i vendimit

1. Gjykata Kushtetuese nuk mund të anultojë ose të ndryshojë vendimin e saj, por ajo ka të drejtë:
  - a) të interpretojë vendimin në rast dyshimi ose mosmarrëveshje për kuptimin e tij, pa ndryshuar në asnjë rast përmbajtjen;
  - b) të plotësojë vendimin ose të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit.
2. Shqyrtimi i çështjeve të mësipërme bëhet në seancë plenare, me pjesëmarrje të palëve.

Neni 81

Ekzekutimi i vendimeve

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim.
2. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore.
3. Gjykata Kushtetuese mund të caktojë vetë një organ tjetër që ngarkohet me zbatimin e vendimit të saj dhe, kur është e nevojshme, edhe mënyrën e ekzekutimit të tij.
4. Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose pengojnë zbatimin e tyre, kur veprimi nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë deri në 100 mijë lekë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 82

Mbarimi i mandatit dhe përtëritja

1. Mandati i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të zgjedhur në vitin 1992, mbaron në vitin 2001.
2. Gjyqtarët e tjerë zëvendësues, të zgjedhur sipas ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, do të qëndrojnë në detyrë 12 vjet nga data e zgjedhjes.

3. Përtëritja e Gjykatës Kushtetuese pas vitit 2001 do të bëhet sipas mbarimit të mandatit të secilit gjyqtar.

Neni 83

Përfshirja nga taksat dhe rregullimi i shërbimeve e shpenzimeve

1. Procedurat në Gjykatën Kushtetuese përjashtohen nga taksat.

2. Për shërbimet që kryhen, si dhe për shpenzimet e bëra gjatë gjykimit të çështjes, vendos Gjykata Kushtetuese.

Neni 84

Detyrimi për të dhënë dokumente

Çdo organ shtetëror, person fizik ose juridik, detyrohet t'i japë Gjykatës Kushtetuese dokumente, të dhëna e njoftime kur këto kërkohen e çmohen të nevojshme për shqyrtimin e çështjes.

Neni 85

Detyrimi për publikim i njoftimeve

Mjetet shtetërore të informimit janë të detyruara që të bëjnë publike njoftimet e dërguara nga Gjykata Kushtetuese për çështje që lidhen me veprimtarinë e saj.

Neni 86

Zbatimi i ligjit të ri

Për kërkesat dhe çështjet që janë në shqyrtim datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 87

Shfuqizimi i ligjit

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet ligji nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 88

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2561, datë 22.2.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani